

Walter
Mühlhausen

A sepia-toned portrait of Friedrich Ebert, a man with a mustache and goatee, wearing a dark suit and tie. He is looking slightly to the left. The background is a soft-focus outdoor scene with trees and foliage.

Friedrich Ebert

1871–1925

Një shtetar Socialdemokrat

25 vjet në Shqipëri

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



Walter Mühlhausen

Fridrih Ebert 1871–1925

Një shtetar socialdemokrat

Përktheu, Brenton Kotorri

2016

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



Botimi u mundësuar nga:

Fondacioni “Friedrich Ebert”

Zyra e Tiranës

Rruga „Abdi Toptani“, Torre Drin, Kati 3-të, Kutia Postare 1418

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 04 2250986 / 04 2273306; Fax: +355 04 22622067

www.fes-tirana.org

Viti i botimit: 2016

Përpunimi grafik dhe shtyp: Albdesign PSP

ISBN: 978-9928-215-02-4

Përktheu: Brenton Kotorri

Redaktoi: Prof. Dr. Bashkim Gjergji

Publikimet e Fondacionit „Friedrich Ebert“ nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim dhe shkrim.

Një falenderim i veçantë shkon për mbështetjen e ofruar nga shtëpia botuese „Dietz“ (Verlag J.H.W. Dietz Nachf.) për realizimin e botimit.

Përmbajtja

Hyrje

Një socialdemokrat bëhet kreu i shtetit 9

I Rrugëtimi i një udhëheqësi punëtorie (1871 – 1905) 11

1. Fëmijëria, rinia, dhe vitet e nxënësisë..... 11

2. Nga aktivisti i partisë në funksionar..... 14

II Lider i Partisë Socialdemokrate (1905 – 1918)..... 23

1. Organizues i partisë së masës..... 23

2. Lider i partisë gjatë Luftës së Parë Botërore..... 29

III Deputet i popullit gjatë revolucionit (1918/1919)..... 40

1. Një revolucionar kundër vullnetit të vet..... 40

2. Likujdues i Kajserrajhut dhe rojtari i pushtetit politik..... 45

3. Shtrimi i rrugës së demokracisë..... 51

IV Kreu i shtetit në Republikën e Vajmarit (1919 – 1925)..... 60

1. Një president për cilindo gjerman..... 60

2. Presidenti dhe qeveria..... 69

3. Përfaqësues i politikës së jashtme të Rajhut..... 76

4. Presidenti dhe kriza e republikës..... 84

5. Përfaqësues i republikës..... 95

6. Viktimë e përdhosjes..... 106

V Fridrih Eberti në memorjen politike dhe në kërkimin shkencor në histori..... 115

VI Shtojcë

Kohështrirja.....	124
Burimet dhe bibliografia.....	129
Burimet e imazheve.....	129




Foto: Fridrih Ebert (1871 – 1925)

Hyrje: Një socialdemokrat bëhet kreu i shtetit

Është data 11 shkurt 1919. Vendingjarja: Vajmar, në Turingi. Axhenda e Asamblesë Kombëtare (*Nationalversammlung*), parlamenti i parë të republikës, përfshin edhe zgjedhjen e presidentit. Besohet gjerësisht se Fridrih Eberti, kryetari i Partisë Social Demokrate të Gjermanisë (SPD), do ta fitojë garën dhe do të bëhet president i parë i Rajhut gjerman. Pas tridhjetë minutave, numërimi i votave konfirmon atë që pritet prej shumicës. Ebert, i cili në këtë moment kyç të fushatës ka epërsinë e një individi të rëndësishëm dhe serioz, bëhet president me 227 nga 379 vota.

Kështu, në rastin e Fridrih Ebertit, një socialdemokrat, që në Perandorinë Gjermane (*Kaiserreich*) dikur denigrohej si “armik i perandorisë”, bëhet gjermani i parë i zgjedhur demokratikisht si kreu i shtetit. Kjo ngjarje shpjegon edhe rendin politik kushtetues të epokës: pasardhësi i Perandorit do të ishte një përfaqësues i lëvizjes socialiste punëtore.

Ky ishte kulmi i karrierës politike për punëtorin e kualifikuar nga Heidelbergu. Në fjalimin e tij të pranimit të detyrës, socialdemokrati u shpjegoi delegatëve se çfarë do të thoshte për të kjo detyrë: “Unë kam ndërmend dhe do të veproj si përfaqësues i të gjithë kombit gjerman, dhe jo si lideri i një partie”. Ky dedikim ndaj paanshmërisë politike u bë edhe lajtmotivi i karrierës politike të të parit Reichspräsident. Por Eberti mbeti i lidhur fort me rrënjët e tij dhe interesat e lëvizjes punëtore, ndaj deklaronte:

“Unë megjithatë dëshmoj se jam bir i klasës punëtore, i rritur me mënyrën socialiste të të menduarit dhe nuk

do t'i mohoj kurrë as origjinën dhe as besimin tim”. Deri kur vdiq më 28 shkurt të 1925-ës, në moshën 54 vjeçare, Eberti qëndroi jo vetëm në mes të poleve të kundërta të interesave të shtetit dhe parimeve partiake, por gjithashtu në krye të një republike jo vetëm gjerësisht të papëlqyer, por edhe nën presionin e vazhdueshëm të të huajve.

I Rrugëtimi i një lideri punëtorësh (1871 – 1905)

1. Fëmijëria, rinia dhe vitet si nxënës në stazh

Ai u lind në një familje rrobaqepësish më 4 shkurt të 1871-shit, në një shtëpizë 50 metra katror në qendrën historike të Heidelbergut. Fridrihu ishte i shtati nga nëntë fëmijë dhe e kaloi një fëmijëri tipike në shtëpinë e një zanatçiu. Vetëm pak javë përpara se Perandoria Gjermane (*Kaiserreich*) të themelohej në qytetin francez të Versajës me shpalljen e mbretit Vilhelmi I i Prusisë si perandor i Perandorisë Gjermane, askush nuk do të mendonte se një njeri me sfondin familjar si të Fridrih Ebertit do të mund të bëhej kreu i parë i shtetit gjerman i zgjedhur në mënyrë demokratike, vetëm 48 vite pasi Vilhelmi I ishte kurorëzuar perandor. Kur u shpall perandoria më 18 janar 1871, lideri i famshëm socialdemokrat August Bebel u burgos. Eberti do të bëhej pasardhësi i atij drejtuesi karizmatik të Partisë Socialdemokrate më 1913-ën.

Fridrih Eberti e nisi karrierën politike gjatë shtegtimeve të tij si zanatçi i kualifikuar. Që prej asaj kohe nuk dihet shumë rreth jetës së tij, ashtu sikurse ndodh edhe me liderë të tjerë të lëvizjes punëtoare me sfond të ngjashëm familjar si ai i Ebertit, pasi ka shumë pak burime që flasin për ato kohë. Nuk dihet asgjë rreth shkollimit të Ebertit, apo sa ka ndikuar periudha e miturisë dhe e rinisë në jetën e tij të mëvonshme. Familja pati nëntë fëmijë, tre prej të cilëve vdiqën gjatë lindjes ose fare të vegjël. Ai dhe familja e tij jetonin në një apartament me tre dhoma në një pallat në rrugët e ngushta të qytetit të vjetër të Heidelbergut. Ky ishte mjedisi në të cilin u rrit Eberti, i ngushtë, por i sigurtë. Edhe pse gjërat që e rrethonin ishin proletare, shtëpia

e tij ishte gati e stilit të borgjezisë së vogël duke qenë se i ati i Ebertit ishte një prej zanatçinjve që fitonin më shumë në profesionin e tyre. Në rininë e tij, Eberti thuhet se nuk e përjetoi mungesën apo varfërinë. Sidoqoftë është shumë e mundshme që jetesa në një lagje proletare e vetëdijësoi atë për vuajtjet shoqërore.

Prej pashkëve të 1877-ës e deri në mars të 1885-ës, Eberti e kreu shkollën fillore me nota mesatare. Kur e mbaroi shkollën, iu vu të mësonte për të punuar si lëkurëpunues për shala kuajsh. Në fund të 1888-ës, ai nisi të rrugëtonte si zanatçi. Diçka që ishte e përhapur në atë kohë. Megjithëse u largua për fare nga shtëpia në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, Eberti mbeti shumë i lidhur me Heilderbergun deri në fund të jetës.

Karriera politike dhe zhvillimi shoqëror i Ebertit ishin ngushtësisht të lidhura me rritjen e Partisë Socialdemokrate në Kaiserrajhun vilhelmian. Partia e re dhe e vogël e punëtorëve donte të arrinte liri, barazi dhe drejtësi sociale. Ebert kishte rënë në kontakte me idetë socialdemokratike që prej fëmijërisë së hershme. Sidoqoftë, ishte kumbari i tij Vilhelm Strötz, një socialdemokrat nga Manhaimi, ai që do të kishte më shumë ndikim për kthimin e tij kah lëvizja punëtore socialdemokrate.

Për rrjedhojë, shalëpunuesi i ri nisi rrugëtimin e tij dy vjet e gjysmë në rrethinat e Manhaimit, që ishte edhe një bazë e lëvizjes socialiste. Pas disa ndalesave në Gjermaninë jugore, ai udhëtoi drejt veriut dhe u ndal në Hanover për rreth një vit, që ishte edhe koha më e gjatë që ai kaloi në një qytet të vetëm gjatë gjithë shtegtimeve që ndër morri. Vitet e rrugëtimit të tij përkuan edhe me fazën finale të ligjeve anti socialiste (1878 – 1890). Asokohe Fridrih Eberti u bë pjesë e sindikatës së shalëpunuesve dhe e Partisë Socialdemokrate. Kudo që do të ndalonte përgjatë rrugëtimeve të tij, ai angazhohej edhe në ngritjen e organizatave sindikali-



(Kanë mbetur vetëm katër fotografi të Fridrih Ebertit prej jetës së tij, para se të martohej në moshën 23 vjeçare. Këtu është shalëpunuesi i ri rreth moshës 20 vjeçare.)

ste dhe bënte thirrje për bashkim me kauzën socialiste. Në këtë angazhim, ai ndjeu impaktin e plotë të politikave të kancelarit Oto fon Bismark që synonin mbytyjen e lëvizjes punëtore, një tentativë që në fund dështoi.

Ai njohu drejtpërdrejtë situatën kur shoqëria i përjash-

tonte socialdemokratët si “njerëz pa atdhe” (*vaterlandslose Gesellen*). Fridrih-u përjetoi gjithashtu edhe fuqinë e solidaritetit brenda lëvizjes punëtore gjatë kohës që kaloi në Kasel, ku ai dhe kolegët e tij hynë në grevë dhe në fund ia arritën qëllimit me kërkesat politike ndaj punëdhënësit të tyre. Pas disa ndalesave të shkurtra në Brunsvik, Vesel, Barmen dhe Kuakenbryk, Eberti udhëtoi drejt Bremenit, ku mbërriti në maj të 1891-shit. Ky qytet verior gjerman ishte një prej qendresave të reja të lëvizjes punëtore. Këtu, Eberti qendroi për katërmbëdhjetë vjet. Katërmbëdhjetë vite që do ta formësonin atë për të gjithë pjesën e mbetur të jetës.

2. Nga aktivist i partisë në funksionar të partisë

Koha e kaluar në Bremen ishte me rëndësi për sa i përket vendosjes së shinave për jetën personale dhe politike të Ebertit. Kur mbërriti në Bremen më 1891-shin, ai ishte një rrugëtar shalëpunues beqar dhe një ushtar i zakonshëm e naiv i partisë socialiste të lëvizjes punëtore dhe kishte shumë pak aftësi organizative. Ai ishte gjithashtu edhe një agjikator i ri, i cili e kishte kaluar provën e zjarrit si orator publik dhe frymëzues me të folurën e vet publike, kishte përvojë në grevat punëtore dhe kishte përjetuar nga afër solidaritetin e lëvizjes socialiste.

Gjatë kohës në Bremen, Eberti fitoi aftësitë e nevojshme për një aktivist partie. Kur u largua nga qyteti më 1905-ën, ai ishte tashmë një figurë e njohur edhe jashtë kufinjve të rajonit lokal, si një prej udhëheqësve të lëvizjes socialdemokrate. Më pas Eberti iu drejtua Berlinit ku edhe u bë një anëtar i komitetit ekzekutiv të SPD-së, duke luajtur kështu një rol domethënës në formësimin e partisë politike më të madhe gjermane. Fillimisht ai pati punuar vullnetarisht dhe me shumë përkushtim për lëvizjen socialiste. Prej 1900-ës, ai shërbeu në parti si një politikan profesionist



(Fridrih Eberti, në të djathtë, bashkë me dy miq në një studio, 1894.)

dhe e nxorri jetesën prej politikës edhe pse e vazhdonte ndërkohë punën e tij vullnetare.

Koha që Eberti kaloi në Bremen solli edhe ndryshime në jetën e tij personale: në maj të vitit 1894 ai u martua me punëtoren 24 vjeçare Louise Rump. Ajo ishte rritur në varfëri të madhe dhe ishte përfshirë në lëvizjen e punëtorëve. Ajo për një kohë ishte edhe zëvendëskryetare e një bashkimi të vogël zdrukthtarësh me vetëm disa qindra

punëtorë. Për martesën nuk dihet shumë. Bashkëshortja e vet e mbështeti Ebertin; ajo qëndroi gjithnjë në sfond dhe u ngrit në lartësinë e roleve që merrte për shkak të detyrave dhe karrierës politike të të shoqit. Ajo më pas fitoi edhe respekt si zonja e presidentit të Rajhut. Pesë muaj pas martesës, lindi fëmija i tyre i parë Fridrih-u. “Mbërriti një revolucionar i vogël”, shkruajtën prindërit në njoftimin e publikuar në një gazetë lokale socialdemokrate, duke thumbuar faktin se në Kaiserrajhun villhelmjan socialdemokratët quheshin revolucionarë. Më pas erdhën tre djem dhe një vajzë: Georg (lindi më 1896-ën), Heinrich (lindi më 1897-ën), Karl (lindi më 1899-ën) dhe Amalie (lindi më 1900-ën). Më 1917-ëm, Georgu dhe Hainrich ranë gjatë betejave në Luftën e Parë Botërore.

Vetëm falë dedikimit të tij të palodhur, aftësisë së tij organizative dhe si orator publik, Eberti pati një karrierë të suksesshme në lëvizjen socialiste. Vetëm pas një kohe të shkurtër, në më pak se gjysmë viti prej kohës kur ai kishte mbërritur në Bremen, ishte bërë “agjitor i më i zellshëm socialdemokrat”, sikurse thuhej edhe në një raport të policisë së qytetit. Një orator i palodhur dhe gjuhëmprehtë, Eberti ishte një prej folësve më të spikatur. Ai u bë një-multi-funksionar për socialdemokratët. Mbajti disa poste në parti dhe në lëvizjen e bashkuar socialiste gjatë kohës së tij në Bremen. Së pari ai u bë kryetari i shoqatës së shalëpunuesve dhe, menjëherë pas kësaj, kryetari i komitetit ekzekutiv të bashkimit profesional. Nga 1894-a deri më 1896-ën, ai ishte lideri i Partisë Socialdemokrate. Në të njëjtën kohë, ai mbajti postin e kryetarit të Shoqatës së Fermerëve të Bremenit (*Verein der Bremer Wirté*). Nga 1897-a e në vazhdim, ai drejtoi komitetin e partisë për agjitacion (*Landagitations-Komitee*) dhe ishte anëtar edhe i disa organizatave të tjera socialiste. Shumësia e këtyre posteve flet për dedikimin dhe angazhimin e palodhur të



(Familja e re në 1898-ën: Fridrih Eberti me gruan dhe tre djemtë e vet. Nga e majta në të djathtë: Fridrihu, lindur në 1894-ën, Georgu, lindur në 1896-ën, dhe Hajnrih, lindur në 1897-ën. Më pas do të vinin edhe dy fëmijë të tjerë në jetë, Karli, në 1899-ën, dhe Amalie në 1900-ën).

Ebertit për kauzën socialiste. Në të njëjtën kohë, tregon për tranzicionin e lëvizjes punëtore socialdemokrate drejt një lëvizjeje masive që kërkonte më tepër sesa thjesht funksionarë vullnetarë. Sidoqoftë, gjithçka shkoi në vendin e vet dhe ushtari i palodhur i partisë Fridrih Ebert e ndeshi lëvizjen politike që rritej gjithnjë e më shumë, në një kohë kur ajo kishte nevojë për drejtues të lartë.

Si një shalëpunues, Eberti mezi gjeti një vend për të futur kokën. Përpjekjet e tij për të ngritur një biznes patën dështuar. Për disa muaj në 1893-shin, ai punoi si redaktor në "*Bremer Bürger-Zeitung*", gazetë socialdemokrate lokale. Më 1894-ën, ai mori me qira një birrari. Ky nuk ishte një punësim shumë i vlerësuar dhe me reputacion të lartë. Sidoqoftë, mes socialdemokratëve pronarët e pijetoreve shiheshin më pozitivisht për shkak të rolit që luanin ato si vende socializimi dhe agjitacioni brenda lëvizjes punëtore në prag të shekullit. Birraria ishte një pjesë integrale e kundërkulturës proletare. Pijetorja e Ebertit ("*Bierhalle*") u kthye në një vendtakim politik për lëvizjen politike në Bremen dhe një vendqëndrim për punëtorët që kërkonin këshillim. Pronari i pijetores, që kishte fituar në mënyrë autodidakte njohuri të gjera mbi politikën dhe ligjin social, u jepte punëtorëve këshillim ligjor falas, mbi të gjitha, rreth çështjeve që përfshinin ndryshimet e vazhdueshme të ligjeve për punën dhe sigurimet shoqërore. Për aq kohë sa Eberti ishte një pronar birarie, ai e bënte këtë vullnetarisht. Duke nisur që nga marsi i 1900-ës, ai punoi me kohë të plotë si sekretari i parë i punëtorëve (*Arbeitersekretär*) në Bremen.

Kjo ishte një ndihmesë e vogël dhe pa shumë bujë, por gjithsesi e rëndësishme për punëtorin e thjeshtë që gjente mbështetje te Eberti si një këshillues me eksperiencë. Sekretarët e punëtorisë kishin një rëndësi domethënëse për sa i takon ndikimit të tyre socio-politik. Si përfaqësues i klasës së shtypurve, Ebertit iu desh të njihej me disa fusha



(Fridrih Eberti, në qendër si një prej dy presidentëve të Konventës së SPD-së në shtator 1904 në Bremen.)

socio-politike, duke e pasuruar kështu më tej njohjen e tij të përgjithshme ligjore. Po ashtu, posti si sekretar i punëtorëve ishte një prej mundësive më të mira për karrierë brenda lëvizjes punëtore socialiste. Për shkak të njohjes së mirë të disa fushave të ndryshme ligjore nga ana e Ebertit, “avokati i njerëzve” vlerësohej shumë në rangun e vet.

Reputacioni profesional i Ebertit e bëri atë edhe më të njohur. Shumica e anëtarëve socialdemokratë në *Reichstag*, ose në parlamentet e mëvetme të landeve apo në këshillat bashkiake, ishin rekrutuar prej sekretarëve të punëtorisë. Ata gjithashtu përfaqësonin SPD-në dhe sindikatat si ekspertë të konsoliduar në komitete lokale. Kjo ndodhi edhe me Ebertin, i cili ishte anëtar i Bremen Bürgerschaft-it (parlamentit vendor të Bremen-it) nga 1900-a në 1905-ën, ku ai drejtoi edhe degën e socialdemokratëve.

Si një këshilltar social i klasës punëtore, Ebertit i duhej të përballej me të gjitha vështirësitë e ditëpasditshme të proletariatit. Ky angazhim i influenoi thellësisht pikëpamjet, që ai përqafoi në betejat ideologjike brenda partisë së tij mes reformistëve, revizionistëve dhe revolucionarëve. Eberti i braktisi debatet teorike dhe ndasitë ideologjike me arsyetimin se ato nuk ndihmonin për punën praktike. Eberti nuk iu dha kurrë diskutimeve ideologjike dhe atyre pro-

gramore atë rëndësi që këto gëzonin në kongresin vjetor të partisë. I bindur për saktësinë e themeleve teorike, sikurse ishin formuluar në programin themelor të partisë në Erfurt më 1891-shin, ai e konsideronte punën e përditshme praktike si qëllimin kryesor të Partisë Socialdemokrate. Në një fjalim që mbajti në 1902-shin, Ebert pragmatisti shprehu dëshirën e tij për ta arritur demokracinë dhe progresin social përmes reformës. “Ne kemi për qëllim që të shkatërrojmë çdo lloj shoqërie të bazuar tek sistemi i klasave dhe të kërkojmë barazi politike të plotë për të gjithë pa përjashtim”.

Sidoqoftë, në Bürgerschaft-in e Bremenit ai provoi se sa shumë punë e detajuar dhe e kujdesshme nevojitej për të rrëmbyer lëshime nga sistemi i vjetër vilhelmian. Kryetari i grupit parlamentar të SPD-së u shfaq këtu si një orator elokuent, i cili fillimisht u adresojë problemeve sociale dhe, duke e bërë vepruar në këtë mënyrë, u kthye te përvoja e vet si sekretar i punëtorisë. Megjithatë për-pjekjet e tij në Bürgerschaft nuk sollën shumë frute, Ebert e vazhdoi detyrën e tij. Parlamenti i shtetit ishte skena që paraqiste mundësinë ku ai mund të reklamonte qëllimet e veta politike dhe të tërhiqte vëmendjen drejt vuajtjeve sociale. Iniciativat e socialdemokratëve treguan më së miri se sistemi politik ishte në fakt i bazuar në një regjim klasor. Kjo ndikoi në forcimin e ndërgjegjes klasore dhe solidaritetit midis ndjekësve socialdemokratë.

Dedikimi i lartë i Ebertit ndaj lëvizjes punëtore e bëri liderin e SPD-së së Bremenit një lider politik, të mirënjohur edhe përtej kufijve rajonalë. Ai tërhoqi vëmendjen e drejtuesve të partisë në Berlin me aftësitë e veta organizative të treguara gjatë konventës vjetore të Partisë Socialdemokrate në Bremen më 1904-ën, që nuk ishte njësoj si kongreset e mëparshme, por ishte e mbushur me debate pragmatiste, Ky ishte kulmi i karrierës politike të Eber-

tit deri në atë kohë. Pas një viti, ai u zgjodh në komitetin ekzekutiv të SPD-së. Debatet teorike dhe strategjike brenda degës së partisë e kishin paralizuar punën politike në Bremen. Ndryshimet në personel e kishin dobësuar pozicionin reformist të Ebertit brenda organizatës lokale të partisë, që dukej se po dominohej më së shumti prej vizioneve radikale. Duke qenë reformist, ndryshimet në parti ndezën edhe dëshirën e tij për ndryshim personal. Megjithëse grupimet e ndryshme politike brenda partisë binin dakord për parimet bazë socialdemokrate, Eberti prapë nuk ndihej rehat politikisht në Bremen. Sikurse shkroi dhe vetë, ai ishte “plotësisht i fikur” mbi të gjitha prej frymës së armiqësisë, që përshkonte debatet. Ai shpresonte se “një ndryshim vendi do të ishte gjëja më e mire për t’i shpëtuar këtij ngërçi”.

Problemi u zgjidh vetëm disa muaj pasi i kishte shkruar këto rreshta. Më 24 shtator 1905, delegatët e SPD-së në Jena, një qyteti në Turingi, e zgjodhën Ebertin si sekretar të partisë, një pozicion i krijuar rishtazi brenda komitetit ekzekutiv të partisë. Zyrat qendrore të SPD-së në Berlin kishin nevojë për një ekspert të çështjeve me karakter administrativ. Eberti e kishte dëshmuar me vepra kompetencën e tij në këtë fushë. Ai kishte ngritur vetë sekretariatën e punëtorisë në Bremen dhe e kishte drejtuar atë me sukses për pesë vite. Personi që do të mbante këtë post të ri parashihej të punonte ekskluzivisht në zyrat qendrore të partisë, pa u ngarkuar me detyrime të tjera. E gjithë kjo ishte fiks për Ebertin. Me sa dukej ai kishte lënë përshtypje të forta si një organizator i aftë dhe njëlloj komod për të dy liderët e partive dhe delegatët nga e gjithë Gjermania, falë organizimit të konferencës së partisë në Bremen.

Kur Eberti iu drejtua Berlinit më 1905-ën, ai ishte bërë tashmë i famshëm kombëtarisht si një lider me aftësi të shumëfishta. Ai e kishte mësuar zanatin e punëve të partisë

duke nisur nga zeroja dhe e kishte ngjitur rrugëtimin e vet nga një pozicion vullnetari në një pozitë profesionisti falë dedikimit të tij të palodhur. Ai po ashtu kishte parë se debatet për kahun e drejtimit të partisë e kishin turbulluar punën praktike dhe se mes socialdemokratëve kishte një prirje për ta shqyer njëri – tjetrin në lidhje me çdo çështje programore. Politikisht, puna e tij e thjeshtë si pronar pub-i, të cilit i kërkonin shpesh këshilla dhe më pas si një sekretar punëtorie, e kishin influencuar atë thellësisht. Cillido që, ashtu si Eberti, do t'i kishte parë nga afër të gjitha problemet dhe pengesat e punëtorëve, do të përfizonte një kuptim të veçantë si për nevojën e progresit social, ashtu edhe për atë politik. Ai i nxiste përmirësimet praktike që do të lehtësonin jetesën e klasës punëtore, sado të vogla që të ishin ato, dhe nuk kërkonte që t'i frymëzonte ata me shpresën e një shoqërie utopike në të ardhmen e largët. Edhe pse Ebert e pranonte themelin marksist të programit të partisë, ai ishte mbi të gjitha një pragmatist i kithtë me teorinë, në kontrast me retorikën revolucionare të socialdemokracisë. Kjo nuk ndryshoi edhe me kalimin e viteve kur Eberti u bë anëtar i ekzekutivit të Partisë Socialdemokrate.

II Lider i Partisë Social Demokrate (1905 – 1918)

1. Organizuesi i partisë së masave

Fridrih Eberti ishte një prej përfaqësuesve të parë të brezit të dytë të liderëve në komitetin ekzekutiv të partisë. Ai dhe Herman Mülleri, i cili u zgjodh si lideri i partisë një vit pas Ebertit, ishin anëtarët më të rinj të ekzekutivit të vendosur në Lindenstraße në Berlin, ku punuan bashkë me kryetarin dhe baballarët themelues të lëvizjes punëtore August Babelin dhe Paul Singerin. Vitet që Eberti kaloi në komitetin ekzekutiv u karakterizuan prej nevojave të SPD-së që vinin gjithnjë e në rritje, ndëkohë që partia ishte rritur nga 380,000 anëtarë në 1095-ën, në më shumë së një milionë në 1914-ën. Detyra kryesore e Ebertit ishte të kontribuonte në riorganizimin e strukturës së partisë, në mënyrë që ta bënte atë edhe më efektive. Funkzionet e tij ishin kryesisht organizuese dhe administrative. Në punën e tij të përditshme ai duhet të merrej edhe me detaje të lodhshme, që gjithsesi ishin të domosdoshme për funksionimin e partisë si një organizatë. Eberti u siguroi që ato organizata dhe gazeta të partisë përgjatë gjithë vendit, që kishin pasur vështirësi financiare, të merrnin mbështetjen që iu duhej, që të porositet materiali reklamues dhe që fushatat e agjitacionit dhe protestat të mund të organizoheshin në mbarë vendin. Në shumicën e rasteve, komiteti ekzekutiv i partisë në Berlin merrte vendime edhe për stafin e redaktorëve të gazetave të partisë.

Jashtë partisë së tij, Eberti fitoi shpejt reputacionin e një burokrati, një koncept që përdorej shpesh kundër tij. Ky etiketim nuk i përfshinte detyrat kryesore që i ishin besuar atij. Për shembull, prej 1907-ës e mbrapa marrëdhëniet e

partisë me sindikatat e lira socialiste ranë mbi shpatullat e tij. Ai ishte ndërmjetësi midis komitetit ekzekutiv të partisë dhe komisionit të përgjithshëm të sindikatave. Ebert u bë gjithashtu kryetar i “Zyrës Qendrore për Rininë Punëtore të Gjermanisë” (*Zentralstelle für die arbeitende Jugend Deutschlands*), e themeluar prej SPD-së dhe sindikatave më 1908-ën. Kjo organizatë ishte shembull i kundërkulturës socialdemokrate ndaj borgjezisë. Organizata rinore ishte pjesë e një rrjeti social, që nga aspekti ideor do të shoqëronte çdo socialdemokrat “nga djepi deri në varr”.

Shpejt Eberti u përfshi gjithnjë e më shumë në përplasjet problemore dhe në betejat filozofike që e tronditën partinë e masave. Më 1908-ën, në konventën e partisë në Nurenberg, Eberti mbajti fjalën mbyllëse në emër të ekzekutivit të partisë lidhur me çështjen e diskutueshme të miratimit parlamentar të buxhetit prej kryetarit të sëmurë August Babel. Disa grupe parlamentare socialdemokrate të jugut të Gjermanisë kishin votuar pro buxheteve shtetërore. Duke vepruar në këtë mënyrë, ato kishin shkelur linjën zyrtare të partisë – “asnjë qindarkë dhe asnjë njeri për këtë sistem”. Në konventën e Nurembergut më 1908-ën, Eberti e shndërroi çështjen e aprovimit parlamentar të buxhetit në një çështje të parimeve të partisë dhe kërkoi njohjen e rezolutave të mëparshme. Veprimet politike duhet të bazoheshin në një front të bashkuar të përfaqësuar si unik nga partia. Eberti shpalli se:

“Uniteti i partisë është parakushti për suksesin tonë. Kjo kërkon që pakica t’i përkulet shumicës, dhe që cilido anëtar të respektojë dhe të pranojë vendimet e konventës. Nëse kjo nuk do të ndodhë [...] do ta gjymtojë efikasitetin politik të partisë dhe forcën e saj”.

Në debatet ideologjike rreth teorisë socialiste dhe rreth grevave masive si një armë politike, Eberti përkrahte gjithnjë ekzekutivin e partisë. Ai veproi kështu në disa konven-

ta dhe takime rajonale të partisë, ku merrte pjesë si orator në emër të ekzekutivit të partisë dhe kërkonte pranimin e vendimeve të partisë. Eberti, përfaqësues i qendrës së partisë, synonte pajtimin mes krahëve të ndryshëm të partisë. Ai la shenjë si ndërmjetës dhe moderues i përplasjeve programore dhe ideologjike, që gati sa nuk e kishin çuar partinë në përçarje në periudhën e para luftës. Një prej detyrave të tij kryesore ishte zhbërja e konflikteve në



Fotografi në grup me një grua: Komiteti Ekzekutiv i SPD-së në kongresin e partisë në Lajpcig në shtator 1909; në rreshtin e pasmë, nga e majta në të djathtë: Luise Zietz, Fridrih Ebert, Hermann Müller dhe Robert Wengels; në rreshtin e përparmë, nga e majta në të djathtë: Alwin Gerisch, Paul Singer, August Bebel, Wilhelm Pfannkuch, Hermann Molkenbuhr.

organizatat rajonale. Megjithatë, ishte e pashmangshme që puna e tij jo gjithmonë do të vlerësohej midis anëtarëve të një partie, që ishte tronditur prej debateve lidhur me rrugën që ajo do të duhej të ndiqte në të ardhmen.

Përpjekjet e tij nuk ishin gjithnjë të suksesshme. Në

Württemberg, për shembull, pozicionet kundërshtuese midis reformatorëve të moderuar dhe revolucionarëve radikalë në organizatën kombëtare të partisë ishin rritur dhe gati sa nuk e kishin ndarë më dysh SPD-në. Kur Eberti u përpoq të ndërmjetësonte atje në emër të drejtuesve të partisë, ai i inatosi të dyja krahët. Shumë reformatorë prej jugut të Gjermanisë e shihnin atë si nxitësin e vërtetë të trazirave midis anëtarëve të ekzekutivit të partisë në kryeqytetin e largët.

Ku qëndronte Eberti në spektrin e gjerë politik të Partisë Socialdemokrate të para luftës, nga revolucionarët radikalë e deri tek reformatorët pragmatistë? Ai ishte një prej pragmatistëve dhe anonte kah manifesti i partisë. Ai i përbuzte debatet teorike, që vazhdonin brenda lëvizjes punëtore. Në vizionin e tij, këto debate vetëm të shpërqendronin prej detyrave të vërteta dhe e rrezikonin forcën e partisë. Eberti mund të klasifikohet më mirë si përfaqësues i qendrës politike të partisë së tij. Për të, uniteti i lëvizjes socialdemokrate ishte qëllimi madhor si dhe themeli i forcës politike të nevojshme për reformimin e më pas tejkalimin e sistemit ekzistues. Tashmë, që prej kohës në Bremen, ai i kishte dënuar përplasjet në konventën vjetore të partisë, përplasje që ndonjëherë bëheshin personale. Debati rreth argumentit të revizionistëve mbi platformën e partisë u rindez në konventën e SPD-së në Dresden më 1903-shin. Ata kishin për qëllim që ta konvertonin manifestin revolucionar në një program reformator të partisë. Eberti i kundërshtonte këto përplasje: “Në të ardhmen, kur të na duhet të lajmë, do të duhet të shkojmë në lavanderi dhe jo t’i ndejmë të brendshmet tona në publik”. Në sytë e tij, konfliktet e brendshme ishin të pranueshme vetëm për aq kohë sa partia vazhonte të dukej e bashkuar në publik. Kjo ishte linja e tij.

Eberti u shndërrua në një prej funksionarëve të më të rëndësishëm të ekzekutivit të partisë. Ai ishte një takticien i

aftë për çështjet partiake apo administrative. Po ashtu, ai u dallua si një folës publik, organizues dhe agjikator me nivel të lartë energjie, eficiencë dhe eksperience. Ndërkohë që në Bremen konsiderohej një funksionar i diskutueshëm i partisë, për Socialdemokracinë Gjermane Fridrih Eberti u bë një prej figurave drejtuese dhe “njeriu i veprimit” në zyrën qendrore, pasi iu bashkua ekzekutivit të partisë si sekretar. Krahasuar me kolegët e tij të ekzekutivit, Eberti pa dyshim kishte përvojën më të madhe në punë praktike politike. Ai u dërgua në organizatat rajonale si një emisar i ekzekutivit, ku veproi si një mbrojtës i rezolutave të partisë dhe si një ndërmjetës për konfliktet. Eberti organizoi veprimtarinë e brendshme të zyrës së partisë dhe koordinoi fushata mbarëkombëtare, sikurse fushatat zgjedhore dhe demonstrata për të drejtën e votës. Të gjitha këto na shpjegojnë se përse ai, në konventën e partisë në Jena në 1911-ën, u nominua për të zëvendësuar liderin e partisë Paul Singerin, i cili kishte ndërruar jetë. Megjithëse Eberti qartësisht e refuzoi kandidimin, ai mori 102 vota. Hugo Haase, i cili u mbështet edhe prej kryesisë së partisë, u zgjodh me 283 vota. Duke mos kandiduar për postin, Eberti iu bind kryesisë së partisë në mënyrë që të shmangte debatet rreth drejtimit të partisë, gjë që do të kishte efekte të rënda për rezultatet e partisë në zgjedhjet e Rajhshtagut në janar të 1912-ës. Reagimi e tij ishte thelbësor në demonstrimin e unitetit të partisë. Kishte megjithatë edhe një arsye tjetër se pse Eberti e refuzoi postin më të lartë në parti kur e kishte në pëllëmbë të dorës: ai ende nuk kishte një karrige në Rajhshtag. Ai do ta fitonte atë vetëm pas disa muajsh.

Eberti kishte dështuar të fitonte një karrige në Rajhshtag tri herë: në 1898-ën, në 1903-shin, dhe në 1906-ën. Më në fund, në vitin 1912 ai ishte i suksesshëm në mandatin e Elberfeld-Barmen-it (që sot njihet si Wuppertal). Megjithëse Eberti nuk e arriti dot shumicën e

cilësuar në raundin e parë vetëm për pak vota, ai fitoi menjëherë në raundin e dytë kundër anëtarit të mëparshëm të parlamentit, një konservatori të lirë. Pas këtyre zgjedhjeve të fundit të Rajhshtagut të para luftës, Partia Socialdemokrate zotëronte një shumicë prej 110 vendesh nga 397, dhe ishte partia më e madhe e Rajhshtagut gjerman. Eberti iu adresua shumë rrallë parlamentin në kohën përpara Luftës së Parë Botërore, edhe pse mund të diskutohet ndonjë prej çështjeve më të mëdha të ditës. Ndryshe nga Filip Sheidman, bashkëanëtar i tij i ekzekutivit të partisë që prej 1911-ës, Eberti nuk e ngriti karrierën e tij përmes parlamentit, por përmes organizatës së partisë.

Fakti që Eberti supozohej të pasonte “perandorin e punëtorisë” (*Arbeiterkaiser*) August Bebelin pas vdekjes së tij, është provë për një nivel të lartë e të gjerë mirënjohjeje që zyrat e SPD-së kishin për punën e tij. Pas konventës së partisë në Jena më 20 shtator 1913, Eberti u zgjodh një prej drejtuesve të partisë bashkë me Hugo Haasen, duke fituar 433 vota prej 473. Ky ishte shpërblimi që mori për më shumë se njëzetë vite pune të palodhur për partinë. Ai e kishte fituar besimin e anëtarëve dhe të shumicës së funksionarëve edhe pse nuk e kishte ende mbështetjen e të majtës radikale të partisë për shkak të vizionit të tij reformator. Sidoqoftë, ai u pa i aftë mjaftueshëm për të mbajtur bashkë SPD-në pavarësisht ideve të kundërta dhe krahëve të ndryshëm që u zhvilluan brenda saj.

Eberti nuk kishte as vullnetin dhe as aftësinë për të qenë një Bebel i ri. Si një parti e masave, SPD-ja nuk kishte nevojë për një lider karizmatik, por për një organizator pragmatik dhe mbi të gjitha për një udhëheqje kolektive. Eberti ishte njeriu i duhur për këtë detyrë. Ai ishte përfaqësues i qendrës politike të partisë dhe fokusohej tek e mundshmja politike. Ai as nuk donte që të përfshihej në politikën vizionare dhe as nuk ëndërronte për “përplasjen

e madhe”, apo për thyerjen e papritur të sistemit ekzistues. Vizioni i tij politik bazohej në besimin tek ndryshimi përmes progresit. Këtu, lideri i ri i partisë ishte edhe përfaqësues i shumicës së partisë, edhe pse ajo dukej sikur ende dominohej prej radikalëve dhe sloganeve të tyre revolucionare. Megjithë radikalizmin e fjalëve, SPD-ja përpara Luftës së Parë Botërore nuk ishte një parti revolucionare, por një parti reformatore, anëtarët e së cilës besonin tek fuqia e votës dhe përqendroheshin te mendimet për përmirësimin e gjendjes së vendit, për demokracinë politike dhe për reforma sociale përmes mjeteve të ligjshme.

Fridrih Eberti kishte ngjitur shkallët e veta brenda një partie, e cila kishte lëvizur pa u ndalur nga njëra fitore zgjedhore tek tjetra. Ky zhvillim e kishte formësuar dhe konsoliduar besimin e Ebertit tek ndryshimi gradual. Si funksionar i partisë dhe si bashkëdrejtues me Hugo Haasen, për të ishte e rëndësishme që t’i jepte më shumë influencë socialdemokracisë në mënyrë që të përmbyseshin reformat e shtetit perandorak borgjez. Sidoqoftë, koha e shërbimit të tij si lider i partisë u parapri nga mjegulla e shkaktuar prej Luftës së Parë Botërore, që vetëm një vit më pas do të lëkundte deri në palcë gjithë botën, sikurse dhe socialdemokracinë gjermane.

2. Kryetar i partisë gjatë Luftës së Parë Botërore

MË 4 gusht 1914, pak ditë pas shpërthimit të luftës, grupi parlamentar i socialdemokratëve në Rajhshtag votoi buxhetin për shpenzimet e luftës. Kjo, për publikun ishte një surprizë, duke qenë se me këtë veprim partia po shkelte parimin e saj të hekurt për të mos i lejuar sistemit të merrte asnjë qindarkë dhe asnjë jetë njerëzore. Duke votuar buxhetin e luftës, socialdemokratët, të cilët i kishin shpallur luftë sistemit, mbështetën përpjekjet perandorake për luftë dhe

vulosën politikën e marrëveshjes qytetare (*Burgfrieden*). Me këtë marrëveshje ndërpartiake, ata u larguan prej opozitës së tyre të pakusht ndaj regjimit perandorak. Që prej fillimit, Eberti ishte një mbrojtës i fortë i politikës *Burgfrieden*.



Pushime në ishullin Rügen në Detin Baltik në korrik 1914. Eberti i ndërpreu pushimet dhe u kthye në Berlin në 28 korrik, për shkak të situatës së përkeqësuar ndërkombëtare të nxitur prej vrasjes së Franc Ferdinandit, trashëgimtarit të fronit Austro-Hungarez në 28 qershor në Sarajevë, ngjarje që do të çonte edhe drejt Luftës së Parë Botërore.

Kriza ndërkombëtare pas vrasjes në Sarajevë, e kapi gafil Partinë Socialdemokrate. Në atë kohë, Fridrih Eberti ishte me pushime në ishullin e Rügenit me gruan dhe dy fëmijët e tij. Më 28 korrik 1914, ai i ndërpreu pushimet për shkak të rrezikut të luftës dhe u kthye për në Berlin. Kryesia socialdemokrate vendosi që të çonte Ebertin dhe Otto Braunin - arkëmbajtësi i partisë, në Zvicër, në mënyrë që të siguroheshin fondet e partisë dhe që të ishte i mundur një organizim i saj nga jashtë në rast të një shypjeje të mundshme prej regjimit. Në fakt, qeveria gjermane nuk mori asnjë masë ndaj Partisë Socialdemokrate. Eberti u kthye në 4 gusht, në kohë për votën parlamentare

të buxhetit të shpenzimeve. Ai shkroi në ditarin e vet më 4 gusht 1914:

“Berlin, 2 p.m. Jam rrugës për në Rajhshtag, Scheidemann po më bën shkurt një përmbledhje rreth takimit të grupit parlamentar të një dite më parë. Thuhet se ka qenë një mbledhje e tensionuar më shumë se kurdoherë. Si përfundim grupi vendosi në favor të shpenzimeve të luftës me 14 vota. I thashë Scheidemannit se edhe unë do të kisha votuar sikurse shumica.”

Në fakt, Eberti dhe kolegu i tij në ekzekutivin e partisë Philipp Scheidemann, anonin që të dy kah shumica e SPD-së, duke shprehur mbështetjen e tyre për buxhetin e shpenzimeve të luftës. Gjatë ditëve të para të luftës, Eberti dhe shumë socialdemokratë besonin me ngulm se Rusia ishte agresori kryesorë përkundër së cilës Gjermanisë i duhej që të mbronte veten. Regjimi carist kishte qenë modeli tip i reaksionit dhe i shtypjes në sytë e shumë socialdemokratëve që përpara luftës. Besimi i SPD-së se Rusia ishte në fakt agresori, ishte i sinqertë, por i gabuar, duke qenë se Gjermania ishte përgjegjëse për shpërthimin e luftës në një nivel tejet të madh. Qeveria gjermane ishte e suksesshme që me hile ta portretizonte Carin si luftëshpallës. Frika ndaj sundimit despotik carist konfirmonte idenë e Ebertit dhe të shumicës së socialdemokratëve se Gjermania ishte e shtrënguar të ruante pavarësinë e vet kombëtare. Në këtë rast, Eberti besonte se ishte në përputhje të plotë me angazhimin e kurdohershëm politik të Partisë Socialdemokrate për sa i përkiste mbrojtjes kombëtare. Socialdemokratët kishin qenë gjithnjë të angazhuar ndaj mbrojtjes kombëtare, veçanërisht kur Ruasia cariste, simboli i shtypjes reaksionare, njihej si armiku luftëshpallës. Kryetari i mëparshëm i partisë August Bebeli, i vdekur më 1913-ën, nuk kishte lënë asnjë dyshim kur në vitin 1904 kishte shpallur në Rajhshtag se në rast lufte ose agresio-

ni, socialdemokratët do të “rrëmbenin pushkët dhe do të mbronin tokën e tyre gjermane, deri në burrin e fundit”.

Mbrojtja kombëtare ndaj një Rusie agresore ishte motivi kyç i Ebertit për miratimin nga ana e tij më 4 gusht të shpenzimeve për nevojat e luftës. Gjthashtu, Eberti shpreonte që qeveria do ta shpërblente këtë mbështetje dhe do të implementonte parlamentarizimin e shtetit dhe demokratizimin e shoqërisë, të dëshiruara prej kaq kohësh nga Partisë Socialdemokrate. Sidoqoftë, aprovimi i shpenzimeve të luftës nuk ishte një betim që mund të konvertohej në reforma të qenësishme Madje edhe në verën e 1916-ës, Eberti theksoi në parlament se Partia Socialdemokrate nuk do të kërkonte një *quid pro quo*¹ për vendimin e vet lidhur me çështjen e mbrojtjes kombëtare. Çështja nuk duhet të kthehej në një “objekt për pazare politike”. Pas pak kohe, ai fillimisht kërkoi shpërbërjen e sistemit prusian të votimit me tre klasa, i cili dukshëm i disavantazhonte punëtorët. Socialdemokratët e kishin luftuar këtë formë votimi pa sukses që prej fillimit të shekullit. Eberti i konsideronte “të drejtat e barabarta të qytetarëve në të gjitha fushat” si një qëllim politik që prej fillimit të luftës. Megjithatë, ai dhe shumica socialdemokrate nuk u angazhuan ndaj mbrojtjes kombëtare duke vënë kushte për reagimin e qeverisë, apo për ndonjë lëshim politik. Mbrojtja kombëtare mbetej tejet e rëndësishme në vetvete. Vendimi i 4 gushtit çoi drejt një përfshirjeje të pjesshme të socialdemokracisë në shtet. Miratimi i shpenzimeve të luftës shenjoi identifikimin e partisë me fatin e Rajhut. Burgfriedenit nuk ishte një ngjarje spektakli, por një gur kilometric në rrugën drejt qëllimit përfudfimtari të përfshirjes së SPD-së në shtet dhe reformimin e institucioneve drejt demokracisë. Sidoqoftë, jo të gjithë anëtarët e SPD-së ranë dakord me politikën e Burgfriedenit.

1 Këtu: rikompensim, shkëmbim nderesh apo shërbimesh. (shën.i red.)

Në përgjithësi, si partia ashtu edhe shumica e popullit gjerman prisnin një luftë të shkurtër dhe triumfatore. Kryesia e partisë kishte ndërmend që t'i shtynte të gjitha çështjet e debatueshme deri në përfundim të luftimeve. Gjithsesi ishte e pamundur në kohështrirje që të ruhej ekuilibri mes avokatëve dhe akuzuesve në lidhje me shpenzimet e luftës, për shkak se pritshmëria për një fitore të shpejtë rezultoi të ishte një iluzion. Shumë shpejt, luftimet shkuan drejt llogoreve rraskapitëse. Sa më shumë që po zgjaste lufta, aq më shumë grupimet brenda SPD-së po i shfaqnin hapur idetë e tyre politike.

Politikat e Burgfriedenit më në fund çuan në një krizë të thellë partiake, të cilën SPD-ja nuk mund ta përballonte. Eberti u përpoq të ruante unitetin e partisë ose “trashëgiminë e Bebelit”, sikurse e quante ai. Uniteti ishte udhërrëfyesi. Kjo merrte vlerë mbi të gjitha në kohë krizash, si për shembull gjatë Luftës së Parë Botërore, kur Eberti e deklaroi unitetin si imperativin e padiskutueshëm të partisë. Thirrja që ai i bëri partisë për të ruajtur unitetin, ishte e suksesshme vetëm për një kohë të shkurtër, duke mbajtur parasysh barrën e luftës.

Politika e Burgfriedenit brenda Partisë Socialdemokrate u shemb në dhjetor të 1914-ës kur u desh të votohej buxheti i dytë për luftën. Karl Liebknecht, i biri i themeluesit të partisë Wilhelm Liebknecht dhe përfaqësues i krahut të majtë të partisë, votoi kundër buxhetit për shpenzimet e luftës. Qëndrimi i Liebknechtit kundër buxhetit të dytë për shpenzimet e luftës në dhjetor të 1914-ës shënoi një standard opozitar ndaj luftës. Për hir të unitetit të partisë, Eberti e përballoi presionin e krahut të djathtë të partisë për një kohë të gjatë. Ata donin që t'i shpallnin kundërshtarët e politikave Burgfrieden si një grupim i bezdisshëm sa më shpejt të ishte e mundur. Eberti e mbështeti parimin e unitetit të partisë në publik,

pavarësisht vizioneve të kundërta ndër anëtarët e partisë. Vota e grupit parlamentar duhet të ishte unanime. Ata, që nuk donin të votonin në rresht me partinë, do të lejoheshin të abstenonin. Grupi parlamentar ra dakord me këtë procedurë në shkurt 1915. Për Ebertin, pakica duhet t'i përkulej vendimit të shumicës, përndryshe "struktura organizative e kësaj partie", sikurse thoshte ai, do të shpërbëhej. E kjo ishte pikërisht ajo që ndodhi.

Në dhjetor të vitit 1915 socialdemokratët kundërshtues të traktatit votuan kundër buxhetit të luftës në Rajshtag. Në sytë e Ebertit kjo ishte një thyerje e pajustifikueshme e disiplinës së partisë. Për të, pakica kishte shkatërruar bazën e përbashkët politike. Bashkëdrejtuesi i tij, Hugo Haase, i cili i përkiste pakicës kundërshtuese, dha dorëheqjen si kryetar i grupit parlamentar. Eberti u zgjodh një prej tre drejtuesve të grupit parlamentar në vend të tij.

Fill pas kësaj, u thellua dallimi mes grupeve kundërshtare. Kontestuesit brenda partisë ishin gjithnjë në rritje. Më në fund, ata themeluan grupin parlamentar dhe në prill të 1917-ës, partinë e tyre të njohur si Partia e Pavarur Social Demokrate e Gjermanisë (*Unabhängige Sozialdemokratische Partei Deutschlands*; USPD) me Hugo Haasen si kryetar. Si rezultat lindi një përçarje e përhershme e socialdemokracisë. Kjo "betejë mes vëllezërish", sikurse e përshkruante me shumë përpikmëri Eberti përplasjen mes partive socialdemokrate në prill 1917, e përthau energjinë e lëvizjes punëtore. Eberti u prek drejtpërdrejtë prej kësaj përplasjeje duke qenë se organizata lokale e partisë në zonën e tij në Elberfeld-Barmen simpatizonte kundërshtuesit për çështjen e buxhetit të shpenzimeve të luftës dhe në fund u bashkua me USPD-në.



Një portret familjar idilik. Shtator 1916, në përcjelljen e Hajnrihut (Hajnrihu gjysmë viti më vonë do të binte viktimë në luftë); nga e majta në të djathtë, Fridrih Ebert, Amalie, Hajnrih, Louise, Fridrih i riu, Karli. Djali që nuk është në fotografi, Georgu, do të binte në luftë në frontin perëndimor në maj 1917.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Partia e gjeti veten në krizën më të thellë që prej themelimit të vet. Ebertit iu desh të përballej me pengesa të tilla që për nga rëndësia dhe kohëzgjatja s'i kish përballuar asnjë asnjë lider tjetër që prej kohës së Ligjeve Anti-Socialiste të 1890-ës. Kësaj i duhet shtuar edhe merakut personal të Ebertit për fëmijët e tij Fridrihun, Georgin dhe Hajnrihun, të cilët ishin regjistruar në parti. Fridrihu, më i madhi, ishte plagosur rëndë në korrik të vitit 1916 dhe, pas një kohe të gjatë rekuperimi, u ishte ribashkuar trupave në front në fillim të 1917-ës. Hajnrih vdiq në shkurt të 2017-ës, kurse Georgu u vra më pak se tre muaj më vonë. “Duhet ta ngushëllojmë veten me të gjithë ata të tjerë që kanë humbur të dashurit e tyre”, shkroi Eberti pas vdekjes së Hajnrihut. Familja Ebert kishte përjetuar në fakt të njëjtën mënxyrë sikurse

miliona të tjerë që kishin humbur të afërmit e tyre.

Mund të hamendësojmë se këto goditje personale të fatit patën ndikim në politikën e Ebertit edhe pse nuk ka burime me të cilat mund ta vërtetojmë këtë lidhje. Lodhja fizike dhe emocionale për shkak të ngarkesë së punës gjatë kohës së luftës, është lehtësisht e kuptueshme. Kishte konferenca njëra pas tjetrës. Takimet e panumërta për çështjet e partisë dhe me përfaqësues të qeverisë e rritën nivelin e stresit tek Eberti dhe kolegët e tij, duke çuar edhe në plandosje fizike ose emocionale. Është e vështirë të thuhet se në çfarë përmasash e prekën Ebertin kjo tejlodhje dhe humbja e dy djemve të tij. Sidoqoftë, në korrik të 1917-ës, Eberti u ankua pa pushim për pasivitetin e qeverisë lidhur me reformat demokratike në “komitetin qendror” (*Hauptausschuss*), bordi më i rëndësishëm parlamentar ndër sesionet e Rajhshtagut:

“Pse na duhen gjithë sakrificat e dhembshme, nëse qeveria nuk denjon të na garantojë atë më të nevojshmen, më thelbësoren, më të natyrshmen në jetë, barazinë politike, apo nëse nuk është e përgatitur që të zhbëjë ligjet e pabarazisë politike dhe sistemin e votimit me tri klasa?”

Reformimi i sistemit të votimit prusian, zhbërja e sistemit jodemokratik të votimit me tri klasa u bë çështja kardinale e politikës së brendshme për Ebertin. Në mesin e vitit 1917, për të kishte ardhur koha kulmore e kësaj reforme. Ai nuk pranoi asnjë përpjekje për ta zbutur deri në përfundim të luftës. Ai deklaroi: “Premtimet e zakonshme nuk janë mjaftueshëm”. Që prej prillit 1916, ai kishte parashikuar se sapo ushtarët të linin llogoret dhe të ktheheshin në shtëpi, ata nuk do të pranonin “të shtyheshin drejt gardhit me gjemba të sistemit zgjedhor me tri klasa”. Por nuk ndodhi asnjë ndryshim. Në mars të vitit 1918, Eberti u ankua me të drejtë se “qeveria nuk bëri

agjë ashtu siç ishte rënë dakord. Qeveria na e ka bërë me hile!”. Liderët e Rajhut ndenjën pasivë.

Në korrik 1917 u themelua “Komiteti Ndërpartiak” (*Interfraktioneller Ausschuss*) me anëtarë nga SPD, Partia Katolike e Qendrës dhe nga Partia e Progresit të Majtë-Liberal. Pas vitesh përjashtimi, SPD-ja u bë partnere me partitë borgjeze. Për herë të parë socialdemokratët nuk ishin më të izoluar politikisht dhe pengesat shoqërore kishin rënë. Shumica e re për reformë, korrespondoi me Koalicionin e Vajmarit që ndodhi më pas e që do të ishte qeveria e parë republikane prej 1919-ës e në vazhdim. Veprimi i parë i dukshëm i Komitetit Ndërpartiak ishte rezoluta e paqes, që u kalua në Rajhshtag në 19 korrik 1917. Kjo rezolutë me fjalët “mirëkuptim për paqen” (*Verständigungsfrieden*) ishte në përputhje të gjerë me fjalorin socialdemokrat dhe ishte e kundërta e “paqes prej fitores” (*Siegfrieden*) që kërkonin konservatorët në mënyrë që të stabilizonin Gjermaninë si një fuqi botërore përmes aneksimëve territorial dhe hegjemonisë ekonomike. Sidoqoftë, rezoluta e Rajhshtagut nuk pati shumë impakt. Megjithëse Komiteti Ndërpartiak nuk ishte shumë i suksesshëm në fillim, Eberti u bë pjesë e këtij bashkëpunimi të parë ndërpartiak mes socialdemokratëve dhe partive borgjeze, në nivel kombëtar. Në sytë e tij, ky ishte një hap domethënës për SPD-në në rrugën drejt shndërrimit në një parti qeverisëse. Në përgjithësi, pozita e socialdemokracisë dhe e socialdemokratëve ndryshoi gradualisht brenda strukturës qeveritare. E përjashtuar prej pushtetit deri në 1914-ën, lufta i sollti socialdemokratët në kontakt gjithnjë në rritje me qeverinë, me agjencitë publike dhe me zyrtarët, veçanërisht në komitetet e shumta të Rajhshtagut.

Kërkesat e Ebertit për progres politik morën përgjigje përpara se lufta të humbej dhe Kaiserrajhut iu desh të dorëzohej tek disa reforma. Teksa humbja ushtarake ishte

e afërt, Eberti, duke shmangur kundërshtitë brenda radhëve, e udhëhoqi partinë e tij drejt qeverisë së parë legjitime parlamentare nën Kancelarin Max von Baden në fillim të tetorit 1918. Për Ebertin, ishte “detyra e drejtë e socialdemokratëve për të mbyllur çarjen” në mënyrë që të demokratizohet monarkia pas abdikimit të perandorit.

Eberti e ruajti opinionin e tij, kur drejtuesit ushtarakë duhej të pranonin disfatën më 2 tetor 1918, që deri në atë moment ishte konsideruar e pamundur. Edhe Eberti dukej sikur ishte thyer. Ai mezi i mbante lotët teksa njoftoi grupin e tij parlamentar për gjendjen menjëherë pasi drejtuesit ushtarakë kishin njoftuar përfaqësuesit e partiv rreth situatës. Në dritën e rrethanave të reja, gjithnjë e më shumë socialdemokratë në Rajhshtag u kthyen kundër pjesëmarrjes në qeverisje. Otto Wels iu përgjërua shokut të tij të partisë Ebert: “Ke luajtur mendsh, lëri ata që e bënë luftën dhe që janë përgjegjës për dorëzimin, që ta firmosin vetë traktatin e paqes”. Eberti në asnjë mënyrë nuk “kishte luajtur mendsh”. Sikurse thuhet në deklaratën e tij të ftohtë, ai kishte arritur në përfundimin se ishte e nevojshme për të mbyllur çarjen në mënyrë që të mbyllet lufta me kushte të pranueshme dhe të merrej e drejta për t’iu bashkuar qeverisë. Ai tregoi vendosmëri dhe në fund e fitoi mbështetjen e grupit parlamentar.

Kështu, përfaqësues të SPD-së Philip Scheidmann dhe Gustav Bauer u bënë anëtarë të qeverisë së parë parlamentare të udhëhequr prej Kancelarit Max von Baden. Eberti nuk ishte një prej tyre, por ai e mbajti partinë në rresht. Deri në vjeshtën e 1918-ës, partia e Ebertit sikurse edhe qarqet e tjera brenda qeverisë e kuptuan se kryetari i SPD-së ishte shndërruar në një prej personaliteteve më vendimtare për zhvillimin e mëtejshëm të qeverisjes. Në fund të tetorit 1918, u aprovua një reformë kushtetuese, që e fuqizonte pozitën e Rajhshtagut ndaj qeverisë dhe përfundi-

misht e ktheu monarkinë kushtetuese në një sistem parlamentar. Për Ebertin ky ishte një hap kyç drejt demokracisë që ai synonte të arrinte përmes evolucionit politik, në vend të rrëmujes revolucionare. Në fillim madje, ai deshi që ta ruante monarkinë me synim që ajo të konvertohej nëpërmjet reformave të mëtejshme deri në një sistem demokratik me Perandorin si kreun e shtetit, i cili do të luante thjesht një rol përfaqësues. Sistemi gjysmë-parlamentar vilhelmjan duhet të kthehej në një qeveri parlamentare . Ky qëllim mund të përmbushej edhe me një monark si kreun e shtetit dhe kjo nuk nënkuptonte medoemos një republikë. Sidoqoftë, sjellja kokëfortë e qeverisë e shtyu Ebertin drejt përfundimit se ishte e pamundur që ta reformoje monarkinë gjermane si institucion.

Megjithatë, reforma kushtetuese erdhi shumë vonë. Lëvizja revolucionare që kishte nisur në qytetet – port në brigjet e deteve të Veriut dhe atij Baltik dhe që ishte përqaftuar prej turmave luftë-kundërshtuese, i hoqi mënjandë shpresat e Ebertit për tranzicion gradual. Në ditët thelbësore të vjeshtës së 1918-ës, Eberti e identifikoi fatin e vet me atë të Rajhut, një qëndrim ky i përligjur nga etika e përgjegjësisë për partinë e tij dhe të tjerat. Këto ishin aspektet kryesore që e formësuan politikën e tij pas trazirave të 9 nëntorit 1918.

III Deputeti i njerëzve gjatë revolucionit (1918/19)

1. Një revolucionar kundër vullnetit të vet

9Nëntor 1918, pak pas orës 12.00. Kancelari Princ Max von Baden priti një delegacion nga SPD-ja në kancelarinë e Rajhut të drejtuar prej dy kryetarëve të partisë, Fridrih Ebertit dhe Filip Sheidemanit. Për shkak të situatës së dëshpëruar ushtarake dhe krizës revolucionare, që po fanitej, kancelari kishte shpallur në mënyrë arbitrare abdikimin e Perandorit Vilhelm II, duke përmbushur kështu një prej kërkesave kryesore të Partisë Socialdemokrate. Gjithsesi Fridrih Eberti insistonte që fuqia e qeverisë u duhej transferuar atyre që kanë “besimin e popullit” me vete, në mënyrë që të parandalohet që revolucioni të kthehet në kaos dhe gjakëderdhje. Ai kërkoi caktimin e një socialdemokrati si kancelar. Pas një konsultimi të shkurtër, Princi Max ia dorëzoi zyrën e kancelarisë Ebertit. Lideri socialdemokrat pranoi, duke thënë: “Është një post i vështirë, por unë do ta bëj”.

Në terma kushtetues ky ishte një veprim i dyshueshëm, por politikisht i paevitueshëm. Megjithatë shenjonte një kthesë historike. Kreu i qeverisë së Gjermanisë perandorake e kishte vendosur fatin e Rajhut që shpërbëhej në duart e liderit të socialdemokratëve, një parti e cila ishte luftuar shumë dhe ishte përjashtuar prej shoqërisë që prej themelimit të vet në 1860-ën. Sidoqoftë, Princi i Badenit ishte i bindur se pragmatisti socialdemokrat Fridrih Ebert nuk do të shkonte drejt një rruge radikale. Me marrjen e kancelarisë, ai do të çonte gjithashtu në likuidimin e Kajserrajhut.

Megjithëse i goditur nga rënja e Perandorisë Gjermane, Eberti e mbylli çarjen. Qëllimet kryesore të SPD-së u arritën: Rajhu u parlamentarizua, Perandori Vilhelmi II, i diskreti-

tuar plotësisht, kishte abdikuar dhe SPD-ja ishte bërë partia qeverisëse. Si shembëlltyrë e kësaj, Eberti fill pasi u emërua kancelar shpalli se “Gjermania e ka përmbushur revolucionin e vet”. Rruga e re ishte përcaktuar. Ai nuk ndërmori hapa të tjerë drejt zhvillimit të ndonjë strukture politike, apo institucionale. Deri më 9 nëntor, ai do të kishte rënë dakord për “një monarki me karakter social nën një sistem parlamentar” megjithëse jo me Vilhelmin II. Por, ngjarjet që pasuan do të ndryshonin gjithçka.

Ndërkohë që revolucioni, po përhapej shpejt në të gjithë vendin, ishte i nevojshëm një akt simbolik që do të tregonte se sistemi kishte ndryshuar. Dhe ky akt do të ishte dorëheqja e plotë nga pretendimi për fronin nga ana e Hohezollernëve dhe e princërve federalë gjermanë. Ata duhet t’i dorëzonin kurorat e tyre. Filip Sheidmani, bashkëkryetari i partisë me Ebertin që prej 1917-ës, ishte shumë më i ndërgjegjshëm për këtë sesa kolegu i tij. Në orën 2 të ditës, më 9 nëntor 1918, Sheidmani shpalli Republikën Gjermane nga ballkoni i ndërtesës së Rajhshtagut. Me këtë veprim, sipas Max von Badenit, ai “i dha një të shkundur të fundit monarkisë”. Eberti e kritikoi Sheidmanin që e shpalli Gjermaninë republikë përpara se asambleja kushtetuese të mblidhej: “Ti nuk ke asnjë të drejtë që të shpallësh republikën. Vetëm një asamble kushtetuese mund ta vendosë fatin e Gjermanisë, nëse ajo do të jetë republikë apo diçka tjetër”.

Megjithëse Fridrih Eberti e mbante postin e kancelarit vetëm prej një dite, ai nisi ta formësonte politikën nga ky moment e deri sa u mblodh Asambleja Kombëtare në shkurt 1919. Eberti dhe shumica e socialdemokratëve nuk e kishin dashur revolucionin. Sidoqoftë, ata ishin të përgatitur për ta udhëhequr lëvizjen në mënyrë që të shmangnin kaosin dhe anarkinë. Nga 9 nëntori ishte e nevojshme të veprime shpejt dhe të mbushej vakumi kushtetues. Eberti shfaqti një instikt të vendosur lideri dhe e mori nismën. Ai u

kërkoj kryetarëve të autoriteteve të Rajhut që të qëndronin në detyrë dhe i ftoi socialdemokratët e pavarur që të bashkoheshin në një qeveri koalicioni.




(“Kancelari i ri socialist” – Fridrih Eberti është lideri i padiskutueshëm i qeverisë së revolucionit).

Fillimisht Eberti kishte përkrahur një qeveri me bazë të gjerë, që do të përfshinte edhe partitë borgjeze të qendrës. Ky opsion ishte djegur për shkak se Sheidmani, teksa

shpalli Republikën Gjermane, kishte deklaruar gjithashtu se qeveria e re e Ebertit do të përbëhej vetëm prej dy partive socialiste, SPD-ja dhe USPD-ja. Të nesërmen, u përcaktua qeveria e revolucionit, “Këshilli i Deputetëve të Popullit”. Kjo ishte një qeveri e revolucionit, në të cilën merrnin pjesë tre anëtarë nga SPD dhe tre të tjerë nga USPD. Kryetarët borgjezë të departamenteve vazhduan të vepronin si zyrtarë administrativë nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve të të dyja partive socialdemokrate. Në mbremjen e 10 nëntorit, kjo qeveri e revolucionit u pranua edhe prej asamblesë së këshillave të punëtorëve dhe ushtarëve.

Anëtarët e kabinetit të revolucionit që Sheidmani një herë i quajti “Kancelari i Rajhut me gjashtë koka”, ishin të barabartë në numër sipas partive por jo për nga forca e tyre e impaktit. Eberti që ishte përgjegjës për politikën e brendshme dhe çështjet ushtarake, shtylla e këtij kabineti, ishte *primus inter pares*: ai e drejtonte kabinetin dhe adresojë si Kancelar sidomos prej burokracisë ministerale.

Si deputet i popullit, politikën e Fridrih Ebertit ishin nga njëra anë të përcaktuara prej trashëgimisë së Kajserajhut dhe impaktit të luftës së humbur, dhe, nga ana tjetër, prej vetëperceptimit të tij demokratik, që mbeti udha e tij për jetë. “Procesi i demokratizimit është një nevojë jetike për Rajhun dhe popullin e tij”, shkroi ai më 2 nëntor 1918. Prandaj duheshin adresuar dy probleme thelbësore. Së pari, duheshin cekur nevojat urgjente të popullit teksa kolapsi ekonomik po fanitej atypari. Së dyti, ishte e domosdoshme që të shtrohej rruga për demokracinë. Një besimtar i reformës dhe demokracisë, Eberti ishte kundër një regjimi diktatorial revolucionar, të cilin e synonin veçanërisht socialdemokratët e pavarur. Disa prej bashkëkohësve kujtonin sfondin e tij lokal si një arsye për të shpjeguar politikën e tij për tranzicion gradual. Një prej shokëve të partisë shkroi më vonë për Ebertin: “Duke qenë se u lind në Baden, idetë demokratike i kishte në gjak. Ai



(Qeveria e revolucionit, “Këshilli i Deputetëve të Popullit”, nga e djathta në të majtë, Philipp Scheidemann (SPD), Wilhelm Dittmann (USPD), Hugo Haase (USPD), Friedrich Ebert (SPD), Otto Landsberg (SPD) dhe Emil Barth (USPD).)

e refuzoi konceptin e revolucionit”. Duhet lënë e papërcaktuar nëse kjo sjellje anti – revolucionare ishte apo jo tipike për ndokënd në Baden. Në fakt, Eberti ishte një revolucionar kundër vullnetit të vet. Ai donte ta arrinte demokracinë përmes ndryshimit gradual. Duke favorizuar reformën, ai përfaqësonte shumicën e socialdemokratëve. SPD-ja e shihte veten si një parti revolucionare në teori, por jo në praktikë. Programi i partisë tingëllonte radikalisht revolucionar, mirëpo partia në vetvete ishte përkundër kësaj një reformiste në parim. Socialdemokratët nuk kishin ndonjë plan të gatshëm për të transformuar Rajhun. Megjithëse pushteti kishte rënë në duart e Ebertit në 9 nëntor 1918, ai kishte ndërmend që të luante sipas rregullave demokratike dhe të krijonte një konsensus të gjerë.

Për më tepër, qeveria e revolucionit nuk punoi në një vakum politik. I duhej të përballej me pasojat dhe pengesat e luftës së humbur dhe me fuqitë kërkuese që kishin fituar luftën. Kabineti revolucionar i Ebertit nuk ishte në pozitën

për të krijuar një prototip abstrakt të shtetit të ri duke mbajtur parasysh rrethanat. Mbi të gjitha, koha po kalonte. Kishin kaluar më shumë se katër vite luftë, në të cilën ishin mobilizuar të gjitha shtresat e shoqërisë. Kjo kishte sjellë deformimin e strukturës shoqërore dhe kishte thëlluar ndarjen klasore. Gjermania ishte shteruar dhe populli i vet demoralizuar. Në mënyrë që vendi të stabilizohej, duhej reduktuar tensioni midis klasave, që ishte rritur gjatë kohës së luftës, kurse shoqëria e përçarë duhej paqësuar së brendshmi. Gjermania, që kishte qenë një shoqëri tejet e industrializuar, kishte lëvizur tashmë nga gjysmë-parlamentarizmi duke implementuar reformat e tetorit dhe ishte gjerësisht demokratike në terma kushtetues. Tani vendi duhet ta transformonte gradualisht veten në një shtet kushtetues demokratik të stabilizuar. Qeveria e revolucionit duhet të përballej me një prej situatave më komplekse dhe të vështira në historinë moderne të Gjermanisë, apo për të përdorur fjalët e vetë Ebertit, “vështirësi me të cilat asnjë vend tjetër i zhvilluar nuk ishte përballur ndonjëherë në të gjithë historinë e njerëzimit”. Problemet urgjente kërkonin vendime të menjëhershme.

2. Likujduesi i Kajserrajhut dhe rojtari i pushtetit politik

“[...] Qeveria e përkohëshme u bë pjesë e një trashëgimie shumë djallëzore. Ne ishim në fakt likujduesi e regjimit të vjetër: Të gjitha stallat, të gjitha shitoret ishin bosh, po na mbaronin furnizimet, krediti ynë ishte dëmtuar, morali ishte zhytur. Ne [...] kemi përdorur të gjithë fuqinë tonë për të kaluar rreziqet dhe mjerimin e periudhës së tranzicionit. Ne nuk e kemi penguar Asamblenë Kombëtare. Sidoqoftë, duke qenë se koha dhe vështirësitë po rëndonin mbi ne, na u desh të provonim të përmbushnim kërkesat më urgjente të punëtorëve”.

Me këto konsiderata të parashtruara në seancën hapëse të Asamblesë Kombëtare të 6 shkurtit 1919 në Vajmar, Fridrih Eberti përshkroi problemet komplekse që ishin shfaqur që prej 9 nëntorit 1918 e në vazhdim. Ai e shihte qeverinë si likuiduesin e regjimit të vjetër dhe si një rojtare të pushtetit politik jo thjesht në emër të një klase, por në emër të të gjithë kombit. Ai shpalli: “Për aq kohë sa populli ynë nuk e ka në dorë zgjedhjen e qeverisë së vet, secila qeveri do të jetë e përkohshme”. Kjo ishte mënyra se si Eberti e përcaktoi qeverinë e revolucionit dhe përgjegjësinë e saj për të shtruar rrugën për një tranzicion të butë drejt një sistemi kushtetues demokratik. Në mënyrë që të arrihej ky synim, ishte e nevojshme të sigurohej mbështetje e gjerë edhe përtej lëvizjes punëtore.

Që më 9 nëntor, Eberti u pati bërë thirrje zyrtarëve administrativë dhe shërbyesve civilë që t’ia dedikonin veten shërbimit ndaj qeverisë në mënyrë që të tejkaloheshin problemet më shtrënguese sikurse ishin: “përmbyllja e një armiqësie dhe hyrja në negociata për paqen, sigurimi i furnizimeve me ushqime për popullin, mundësimi i bashkëlufëtareve që të ktheheshin sa më shpejt dhe sa më të sigurtë pranë familjeve dhe vendeve të tyre të punës”. Kjo fjali e vetme përfshinte problemet kryesore të vendit, pasoja të luftës, në të cilat edhe Eberti ishte i fokusuar veçanërisht.

Sigurimi i furnizimeve ushqimore ishte në krye të listës. Situata delikate e ushqimeve ishte një prej shkaqeve që i nxorën turmat në rrugë në nëntor 1918. Pas dy dimrave të uritur dhe me një të tretë në dukje me shumë viktima të pritshme, njerëzit kërkonin “bukë” bashkë me “paqen dhe lirinë”. Ndaj, Këshilli i Deputetëve të Popullit duhej ta furnizonte popullatën me “bukë”. Njerëzit do ta njihnin qeverinë e revolucionit vetëm nëse ajo do t’ia dilte të siguronte furnizimin me sasi të nevojshme ushqimore. Shqetësimi i Ebertit lidhur me ushqimin dhe energjinë, ishin kryefjalë e fjalimeve të tij gjatë atyre javëve.

Rrethanat bazike ishin tejet të këqija: aleatët vazhdonin të mbanin një bllokadë detare dhe të pengonin flotën gjermane të peshkimit që të nisej. Gjermania ishte në mëshirën e lëshimeve të aleatëve fitues. Vetëm importi i ushqimeve do të siguronte furnizimet për ppopullin. Që prej 1918/19-ës, Eberti e përshkroi situatën si një shkretëtirë dhe parashikoi shembjen e sistemit të dobët të furnizimeve. Sigurimi i ushqimit ishte i lidhur ngushtë me furnizimin me energji. “Mos e pengoni nxjerrjen e qymyrit në miniera”, paralajmëruan Eberti dhe Haase në një prej shpalljeve të para të qeverisë së revolucionit më 11 nëntor. Bllokimi i punës për nxjerrjen e qymyrit (pa folur për rritjen e prodhimit të tij, sikurse do të ishte e nevojshme) do të kishte një impakt negativ në prodhimin e ushqimeve.

Tranzicioni nga një ekonomi luftime në një ekonomi të paqes ishte një vështirësi tjetër që duhej përballuar. Tre milion punëtorë në industrinë e armatimeve u prekën. Gati 95 për qind e prodhimit industrial ishte kalibruar për t’i shërbyer nevojave të luftës, vërejt Eberti me shqetësim në ditarin e tij më 21 nëntor 1918. Tani ajo industri me shpejtësi duhej të prodhonte për një treg paqeje. Që prej atij momenti kishte nevojë për “tenxhere” dhe jo “grana-ta”. Më shumë se tetë milionë ushtarë, që ktheheshin nga teatri i luftës, duheshin punësuar dhe riintegruar në një ekonomi me ndryshime thelbësore. Të gjitha këto i përkeqësonin vështirësitë.

Situata e tendosur dhe këto probleme, që duheshin zgjidhur me urgjencë, ishin arsyeja kryesore se pse qeveria e revolucionit nguronte në çështjen e socializimit të korporatave të mëdha, që do të thoshte shndërrimin e tyre në pronë publike. Kjo kishte qenë një kërkesë kryesore e socialdemokratëve. Në 25 nëntor në Konferencën e Shteteve Gjermane (*Länderkonferenz*), Eberti listoi arsyet faktike kundër socializimit të mjeteve të prodhimit të shkaktu-

ara prej rrethanave: “[...] tani, burimet e prodhimit janë gati tërësisht të shtruara, gjë që e bën jashtëzakonisht të vështirë, madje të pamundur që ta vendosim [socializimin] në praktikë”. Veç kësaj, Eberti donte të krijonte një konsensus të gjerë në favor të socializimit përtej kampit socialdemokrat. Për të, parlamenti i ardhshëm duhej të vendoste lidhur me çështjen bazike të të drejtave të pronës dhe mbi ligjin e mbajtjes së pasurisë, sikurse ai u pati treguar bashkë-anëtarëve të tij të qeverisë në mes të nëntorit 1918: “Ne duam vetëm që të socializojmë korporata, që janë tashmë në rrugën e këtij procesi. Një komitet ekspertësh, me anëtarë që përfaqësojnë edhe partitë borgjeze, gjë që do t’u japë siguri të gjithëve, do ta vlerësojë situatën dhe do të vendosë për këtë çështje. Ne duam që të shmangim eksperimente të veçuara që do të mund të ishin shqetësuese për pasojat e tyre”. Eberti kishte dilema nëse ishte e mençur ta rrezikojë situatën e vështirë me ushqimet të varur prej furnizimit të qymyrit, duke i konvertuar të drejtat e pronësisë së industrisë së minierave të qymyrit, e cila ishte (ose të paktën kështu dukej) gati për t’u shtetëzuar. “Jo eksperimenteve” ishte politika e tij. Ai besonte se këto rrethana lejonin ose një pakt emergjence, ose një reformë strukturore, por jo të dyja bashkë. Buka dhe qymyri ishin të nevojshme me urgjencë në situatën ekzistuese, por reformat strukturore mund të prisnin edhe pak. Megjithëse Eberti nuk kishte ndërmend që t’i shtynte reformat për një kohë të pacaktuar, ato gjithsesi u shtynë.

Në këtë klimë të krizës ekonomike asgjë nuk ishte më pak e mirëpritur sesa grevat dhe ndëmarrrjet në fushën e industrisë. Kur sindikatat dhe shoqatat e sipërmarrësve nënshkruan të ashtuquajturin “Stinnes-Legien-Agreement” më 15 nëntor (të emërtuar sipas emrave të kryenegociatorëve si industrialisti Hugo Stinnes dhe drejtuesi i sindikatës Carl Legien), Eberti besoi se ky hap do të përcaktonte kursin e

rrugëtimit dhe do të mundësonte shumë mbështetje. Me “Marrëveshjen e Shoqatës Qendrore të Punës” (*Zentralarbeitsgemeinschaftsabkommen*) punëtorët pranuan të njihnin sindikatat si një partner (i barabartë) në marrëdhëniet e punës. Kjo uli tensionet mes punëdhënësve dhe të punësuarve, të paktën për kohën e mbetur.

Duke mbajtur parasysh problemet e grumbulluara në fund të luftës së humbur (që Eberti s’reshti kurrë së e përmenduri), nuk kishte shumë hapësirë për të ndryshuar personelin e administratës ekzistuese. Për të, thirrja e menjëherëshme për veprim në atë kohë krize e bënte të detyrueshme mbështetjen tek personeli me më shumë eksperiencë. Eberti theksoi në Konferencën e Shteteve Gjermane:

“Pasi morëm pushtetin politik, ne duhet të siguroheshim që makineria e shtetit të mos shembej [...], duhet të siguroheshim që makineria e shtetit do të vazhdonte të mirëmbante rezervat tona ushqimore dhe ekonominë tonë. [...] Dhe kjo nuk qe e lehtë. Me përpjekjet më të mëdha, ne kemi punuar ditë e natë në mënyrë që të parandalonim shembjen dhe rënien. [...] Ishte e pamundur për të gjashtë ne burrat që ta bënim gjithë këtë të vetëm. Neve na duhej mbështetja e ekspertëve të ditur.”

Duke marrë parasysh situatën e brendshme dhe pritshmëritë e jashtme, Eberti besonte se i duhej të varej tek aparati shtetëror tradicional civil dhe ushtarak i para revolucionit. Kështu, më 10 nëntor 1918, Eberti foli në telefon me gjeneralin Wilhelm Groener - gjeneral i parë i Komandës Supreme të Ushtrisë (*Oberste Heeresleitung*; OHL), qendra më e lartë ushtarake. Ata arritën të mirëkuptohen për të bashkëpunuar. Groeneri, një figurë kyçe në OHL bashkë me Komandantin Suprem Paul von Hindenburg, garantuan mbështetjen e qendrës së komandës ushtarake për qeverinë e re. Në këmbim, OHL-ja priste që të ruhej hierarkia e komandës. Eberti e mirëpriti vullnetin e OHL-



(Përfaqësuesi i popullit Fridrih Ebert, në qendër, përtej tij Filip Sheidemani, në të djathtë të tij Hugo Haase, në funeralin e viktimave të revolucionit të 20 nëntorit. Fytyrat e tyre tregojnë shqetësimin e grumbulluar javëve të fundit të luftës, për shkak të firmosjes së traktatit dhe revolucionit.)

së për të bashkëpunuar në këtë situatë të veçantë, e për më tepër pa bërë ndënjë lëshim politik. Marrëveshja nuk ishte ndonjë “pakt” konspiracioni midis Ebertit dhe fuqive tradicionale ushtarake, sikurse u përfol më vonë. Marrëveshja ndërmjet lidërshpit politik dhe atij ushtarak nuk ishte asgjë më tepër sesa një akt me leverdi politike dhe do të përdorej për të stabilizuar përgjegjësinë qeverisëse që Eberti sapo kishte marrë përsipër. Sipas kushteve të traktatit të armiqësisë të 11 nëntorit, trupat gjermane që kishin mbetur ende thellë në territorin armik, duhet të ktheheshin në Rajh brenda 15 ditëve. Eberti besonte se kjo kërkonte një organizim ushtarak efikas.

Këshilli i Deputetëve të Popullit, nuk bëri asnjë përpjekje për një rifillim të ri në lidhje me personelin, as për bashkëpunimin e elitës së vjetër ushtarake dhe as në fusha të tjera. Nuk mori parasysh se zëvendësimi i grupeve më të kompromentuara në pozita kyç me personel të ri, do të kishte pasur një karakter simbolik. Do të ishte dhënë një sinjal i qartë për ndarjen nga administrata e së shkuarës. Këshilli i Deputetëve të Popullit nuk bëri ndryshime në personel, pasi ishte i shqetësuar për mirëfunksionimin e shtetit si dhe për konsolidimin ekonomik dhe social. “Një dështim organizimi [...] do ta kthente Gjermaninë në anarki dhe mjerim të tmerrshëm”, kishte paralajmëruar kancelari i ri Ebert në 9 nëntor. Kjo ishte arsyeja se pse qeveria socialdemokrate nuk pranoi që ta ndryshonte personelin e autoriteteve supreme, por u bëri thirrje zyrtarëve të dikurshëm perandorakë, që ta vendosnin veten e tyre në shërbim të demokracisë dhe të qeverisë së re.

3. Shtrimi i rrugës për demokracinë

Duke mos u përqendruar vetëm tek çështja e një administratë funksionale në përshtatje me kohën, qeveria e revolucionit pati sukses në ndërmarrjen e disa reformave të

jashtëzakonshme. Në 12 nëntor, deputetët përfshinë disa kërkesa socialdemokrate në një shpallje publike. Ky dokument kushtetues, që u fut në histori si “Magna Carta e Revolucionit Gjerman”, garantonte të drejtat themelore si për shembull të drejtën për grumbullime dhe takime si dhe të drejtat për lirinë e shprehjes dhe të besimit fetar. Disa masa të tjera politike u iniciuan si shtesa ndaj disa amendamenteve rregulluese, sikurse ishte abrogimi i gjendjes së jashtëzakonshme të shtetrrrethimit, që i kufizonte të drejtat dhe liritë civile. Gjithashtu u amnistuan sulmet politike dhe u riaktivizuan rregullat për mbrojtjen e punëtorëve, që ishin hequr në fillim të luftës. Kjo përfshinte edhe shpalljen me ligj të ditës tetë orëshe të punës më 1 janar 1919, kërkesë politike kryesore e lëvizjes punëtore të para-luftës. Qeveria e revolucionit prezantoi po ashtu edhe të drejtën e votës për femrat dhe hodhi themelet për barazinë politike midis burrave dhe grave, që ishte një gur kilometrik historik për socialdemokratët. Që prej këtij momenti, vota e barabartë, e fshehtë dhe e drejtëpërdrejtë do të aplikohet për cilindo qytetar mbi 20 vjeç. Në të njëjtën kohë, u prezantua një sistem përfaqësimi proporcional, në vend të sistemit zgjedhor të mazhorancës absolute, që e kishte vendosur SPD-në në disavantazh gjatë Kajserrajhut.

Këto reforma mbresëlënëse shtruan rrugën për demokracinë, që supozohej të aktivizohej sa më shpejt që të qe e mundur. Qëllimi i menjëhershëm i Ebertit ishte Asambleja Kombëtare. Ai e quajti si “detyrën më të shenjtë” krijimin e bazës kushtetuese për një republikë të re dhe thirrjen e një Asambleje Kombëtare sa më herët të ishte e mundur: “Jam i bindur, Asambleja Legjislative është një nevojë e dukshme për Gjermaninë”. Në fund të nëntorit, ai do t’i drejtohej kabinetit të revolucionit me bindjen se shumica dërrmuese e popullit kërkonte Asamblenë Kushtetuese. Teksa SPD-ja, e udhëhequr prej Ebertit drejtonte



(Fridrih Eberti mirëpret trupat, që kthehen nga fronti i luftës në shtëpi, në emër të qeverisë së revolucionit në Portën e Brandenburgut, Berlin më 10 dhjetor 1918)

implementimin e parlamentit të ri kombëtar me shpejtësi, USPD-ja kishte rezerva të forta në lidhje me datën e afërt të zgjedhjeve. Socialdemokratët e pavarur donin që më parë të ndërmerrnin reforma të mëtjeshme dhe pastaj t'i linin njerëzit të vendosnin. Eberti, nga ana tjetër, kishte një besim të palëkundur tek vota. Kështu, ai donte që Asambleja Kombëtare të merrte vendimet bazike lidhur me çështjet kushtetuese dhe politikat sociale.

Si përfaqësues i socialdemokratëve që kishin qenë të përjashtuar gjatë Kajserrajhut, Eberti nuk aspironte për një sundim të ri klasor. “I gjithë pushteti tek këshillat” - kjo metodë e një grupimi të përbërë nga një pakicë revolucio-

narësh rreth e qark Ligës Spartane radikale të udhëhequr prej Rosa Luxemburg-ut dhe Karl Liebknecht-it, nuk përputhej me bindjet demokratike të Ebertit. Ndryshe nga Kajserrajhu, që ishte zhbërë prej revolucionit, republika e re pritej të ofronte pjesëmarrje politike për të gjitha segmentet e popullsisë. Ky ishte kuptimi që Eberti kishte për demokracinë. Për të, standardi ishte barazia për të gjithë njerëzit, “koncepti i idealit të madh të demokracisë”, sikurse e përcaktoi ai në fjalimin e tij prezantues në Konferencën e Parë të Përgjithshme të Këshillave të Punëtorëve dhe Ushtarëve të Gjermanisë në 16 dhjetor 1918:

“Ligji, në kohëzgjatje mund të ketë vetëm një burim në Gjermani: vullnetin e të gjithë popullit gjerman. Ky ishte qëllimi i revolucionit. [...] Proletariati fitues nuk zbaton sundim klasor. E tejkalon sistemin e vjetër të sundimit klasor, si në terma politik ashtu edhe në terma ekonomikë dhe vendos barazinë e të gjitha qenieve me fytyrë njerëzore. Kjo është ideja e madhe e demokracisë”.

Kongresi Qendror i Këshillave të Punëtorëve dhe Ushtarëve, i mbajtur në Berlin nga 16 deri në 21 dhjetor 1918, duhet të vendoste datën e zgjedhjeve për Asamblenë Kombëtare. Në sfondin e këtyre zhvillimeve, ishte bërë e qartë se një sistem politik sikurse Republika Sovjetike apo Diktatura Sovjetike nuk ishte në axhendën e këtyre këshillave. Shumica e gjerë e këshillave të punëtorëve dhe ushtarëve, të themeluara gjatë nëntorit të 1918-ës, e konsideronin veten si një trupë ekzekutive e qeverisë së revolucionit dhe mbështesnin programin politik të shumicës socialdemokrate, e cila bënte thirrje për demokraci parlamentare dhe zgjedhje sa më të shpejta për Asamblenë Kombëtare. Me shumicë dërrmuese, me rreth 400 vota pro dhe vetëm 50 kundër, delegatët vendosën që zgjedhjet për Asamblenë Kombëtare të mbaheshin më 19 janar 1919, një vendim ky që mbështetej nga Eberti.

Në anën tjetër, thirrja e radikalëve për të ruajtur sistemin e këshillave si themelin e kushtetutës së ardhshme gjermane nuk u pranua në konferencë. 344 delegatë votuan kundër kësaj thirrjeje dhe vetëm 98 votuan pro. Kësisoj, dukej se asgjë nuk e pengonte rrugën e zgjedhjeve të para të përgjithshme.

Sidoqoftë, situata e brendshme u përkeqësua. Konflikti politik u derdh rrugëve pasi socialdemokratët e pavarur u tërhoqën nga Këshilli i Deputetëve të Popullit në fund të dhjetorit 1918. Ata e bënë këtë si protestë ndaj vendimit të Ebertit për të çuar trupa ushtarake që t'i jepnin fund kryengritjes të ashtuquajturit *Volksmarinedivision*, që kishte rrëmbyer Otto Welsin (SPD), komandantin ushtarak të qytetit në Berlin, si dhe kishte uzurpuar kështjellën dhe godinat mbretërore. Për tre Deputetët e Pavarur të Popullit, kursi i veprimeve të Ebertit ishte vetëm një pretekst për të dalë nga qeveria. Shkaku i vërtetë i kësaj daljeje qëndronte tek vështirësitë në rritje për një sërë çështjesh të politikave ushtarake, midis SPD-së dhe USPD-së, duke qenë se kjo e fundit ishte nën presion të vazhdueshëm prej së majtës radikale.

Vendimi i socialdemokratëve të pavarur për t'u tërhequr nga qeveria e revolucionit, që prej këtij çasti përbëhet vetëm prej përfaqësuesve të SPD-së, çoi menjëherë në problemet e janarit që u njohën gjerësisht si rebelimi Spartacist (*Spartakus-Aufstand*). Kjo ishte një përpjekje prej së majtës radikale për të rrëzuar "qeverinë Ebert-Scheidman". Ata u organizuan nga Partia e re Komuniste e Gjermanisë (*Kommunistische Partei Deutschlands - KPD*), e cila ishte themeluar në 1 janar 1919 dhe udhëhiqej nga Karl Liebknecht. Në atë kohë, Deputeti i ri i Popullit Gustav Noske (SPD) mori drejtimin e komandës supreme të ushtrisë. Në kursin e konflikteve gjithnjë e më shumë në rritje, u bë e qartë se qeveria e revolucionit kishte bërë gabim duke mos e dre-

jtuar angazhimin e ushtrisë ndaj rendit të ri demokratik. Këshillat e Punëtorëve dhe Ushtarëve kishin paraqitur një program për reforma ushtarake në Kongresin e Rajhut, të cilin, sidoqoftë, qeveria e revolucionit nuk e zbatoi kurrë. Fillimisht Eberti pati propozuar instalimin e një milicie vullnetare, por Komanda Supreme e Ushtrisë (OHL), së cilës iu besua ngritja e kësaj strukture, nuk e vazhdoi punën pas miratimit të një ligji për këtë çështje më 6 dhjetor 1918. Ngjarjet i përmbysën planet.

Përballë vështirësive të skajshme, qeveria socialdemokrate e revolucionit u mbështet tek elitat ushtarake tradicionale dhe e çimentoi rolin e Komandës Supreme të Ushtrisë si një forcë politike. Liderhipi ushtarak në fillim dislokoi trupa milicie të krahut të djathtë politik (të ashtuquajturit *Freikorps*), të përbërë kryesisht prej ushtarësh të çmobilizuar, të cilët e kundërshtonin demokracinë. Freikorpsët ishin grumbulluar për të mbrojtur kufirin lindor prej sulmeve polake. Ata e qetësuan trazirën brenda pak ditësh. Megjithëse kursi i veprimeve të trupave të qeverisë kundër puçistëve u përball me kritikë të ashpër e me vend, mbetej i pamohueshëm fakti se qeveria duhet të ndërmerre veprime ushtarake ndaj kryengritësve në mënyrë që të mbante hapur derën për një sistem republikan. Radikalët kërcënuan se do ta shkatërronin rrugën e zgjedhjeve të lira dhe po ashtu të demokracisë parlamentare, që, me fjalë të tjera, ishte ajo për çka Eberti kishte luftuar gjatë gjithë jetës së tij. Kryengritja e janarit, shtypja e saj prej Freikorpsëve dhe vrasja brutale e Rosa Luxemburgut dhe e Karl Liebknechtit, që të dy liderë të Partisë Komuniste, nga dora e anëtarëve të Divizionit të Këmbësorisë së Pushkëtarëve të Gardës (*Garde-Schützen-Kavallerie-Division*) vetëm dy ditë pas përfundimit të luftimeve, e thelloi ndasinë brenda lëvizjes punëtore. Këto ngjarje si dhe dështimi i ndërmarrjes së reformave socialdemokratike,

ndikuan në radikalizimin e punëtorisë. Vendi u paralizua prej grevave dhe trazirave të ngjashme me ato të një lufte civile në pranverën e 1919-ës. Vala e dytë e revolucionit u bë shumë më e dhunshme sesa e para, që kishte filluar në 9 nëntor 1918. Sërish Noske, i mbështetur prej Ebertit, tregoi se ishte një politikan me grusht hekuri.

Pavarësisht ngjarjeve të muajve të revolucionit, për Fridrih Ebertin duhet të ketë qenë një kënaqësi shumë e madhe hapja më 6 shkurt 1919 e parlamentit të parë në historinë e Gjermanisë, pas një procesi zgjedhjesh të përgjithshme të lira dhe të fshehta, në Vajmar - qyteti ku qeveria kishte vendosur Asamblenë Kombëtare për shkak të trazirave në kryeqytetin e Rajhut gati 90 ditë pas rënies së regjimit të vjetër dhe marrjes së pushtetit prej Ebertit si kancelar. Nëse do ta kishte vlerësuar siç duhej situatën në shkurt të 1919-ës, Fridrih Ebert do të kishte dëshmuar më shumë gjëra pozitive sesa negative. Po afrohej jo vetëm një luftë civile, por po fanitej edhe mundësia e pushtimit prej Fuqive Aleate fituese. Kthimi i trupave në shtëpi dhe procesi i çmobilizimit të tyre ishte po aq i suksesshëm sa edhe riintegrimi i tyre në prodhimin industrial. Furnizimi me ushqim për popullatën mund të vazhdonte, megjithë mundësitë e kufizuara. Makinaria shtetërore funksiononte dhe integriteti territorial i Rajhut ruhej, megjithë rrymat separatiste që shfaqeshin herë pas here.

Fakti që Eberti dhe partia e tij (shumica) socialdemokrate nuk bënë ndonjë përpjekje për të demokratizuar administratën, ekonominë dhe ushtrinë ishte një prej kompromiseve kryesore që historianët e sotëm i gjykojnë si një lëshim më të tepruar nga ç' duhej. Sipas kësaj qasjeje, Eberti dhe qeveria e revolucionit nuk e përdorën mundësinë për të instaluar një rend të ri të nevojshëm dhe bazik. Në thelb të debatit të historianëve qëndron dyshimi nëse kemi të bëjmë me një rast të humbur për të instaluar themelet e një republike të re.

Kritikët e gjykojnë Ebertin për mosshfrytëzimin e mundësive që ofronte potenciali demokratizues në gjirin e këshillave të punëtorëve dhe të ushtarëve, dhe mosshndërrimin e kësaj në një mjet për ndërmarrjen e reformave strukturore dhe ndryshimin e personelit. Në fakt, Eberti nuk i konsideronte këshillat e punëtorëve dhe të ushtarëve si një faktor pushteti në skakierën e forcave politike. Përkundrazi, ai i shihte ato më shumë si një lloj pengese për zgjidhjen e problemeve konkrete dhe ankohej për “intrigat dhe ndërhyrjen e tyre”. Ai i pranonte këshillat e punëtorëve dhe të ushtarëve si njësi ndihmëse të përkohshme për periudhën e tranzicionit, megjithëse ato do të shpërbëheshin sapo qeveritë demokratike federale dhe shtetërore të stabilizoheshin.

Kritikët zakonisht theksojnë mundësitë e humbura. Megjithatë, kjo qasje injoron arritjet e vetëm pak javëve pas ndryshimeve të 9 nëntorit 1918 dhe - po me kaq rëndësi – edhe ato gjëra që ishin shmangur. Nuk kishte vetëm shanse të humbura (të supozuara), por kishte edhe parandalime tragjeshme. I takojnë Ebertit arritjet e qeverisë së revolucionit për realizimin e një demokracie parlamentare në një kohë shumë të shkurtër dhe në sfondin e rrethanave, kushteve bazike dhe të një sërë problemeve, që ishin shfaqur. Eberti dhe SPD-ja u mbajtën fort pas objektivit të tyre kryesor politik: parlamentarizimi dhe liberalizimi permanent i Gjermanisë. Ata u përpoqën për të arritur një konsensus të gjerë në shoqëri duke përfshirë edhe partitë borgjeze me orientim kah reformat.

Kur vlerësohen politikat e Ebertit dhe të qeverisë së revolucionit, duhet marrë në konsideratë edhe presioni i tejskajshëm i kohës. Për më tepër, vendimmarrësit duhet të përballëshin me lodhje të madhe fizike dhe emocionale. Skena politike ishte kthyer në një kazan që zjente dhe kushdo, që futej aty, duhet të kishte “lëkurë rinoceronti”, siç thoshte Filip Sheidmani. Sigurisht që Eberti kishte lëkurë të trashë. Megjithatë, edhe ai madje duhej të

ndruhej për jetën e vet gjatë atyre ditëve. E majta revolucionare i mobilizoi gjithnjë e më shumë mbështetësit e vet dhe radikalizmi i tyre verbal ishte në prag të kthimit në veprim. Kjo me siguri e prekte Ebertin. Ai besonte se rruga e demokracisë po kërcënohej. Pa dyshim, ai e mbivlerësoi “kërcënimin bolshevik” që paraqiste e majta radikale. Sidoqoftë, ishte e mundur që edhe minoritetet ta merrnin pushtetin. Zhvillimet e ngjarjeve në Rusi ishin për Ebertin një mësim për të pasur kujdes. Atje bolshevikët e paktë e kishin neutralizuar shumicën. Kjo kishte shkaktuar një luftë civile me pasoja shkatërrimtare si uri, vdekje të kudondodhura dhe kaos ekonomik, që e shqyen vendin. Gjermanisë i duhej kursyer një situatë e tillë.

Me mjetet e revolucionit, Eberti e kishte arritur objektivin e vet kryesor: implementimin e demokracisë parlamentare. Çdo gjë tjetër sipas tij do të ishte jodemokratike, pasi nuk do të bazohej në vendimin e elektoratit. Ideja se nuk kishte ndërmarrë disa reforma të caktuara nuk e brengoste demokratin e bindur Ebert, i cili i konsideronte ato të nevojshme për një demokraci jetëgjatë, por realizimin e tyre si detyrë për parlamentin e ardhshëm. Mund të argumentohet gjerë e gjatë nëse politikat e Ebertit ishin të drejta apo të gabuara, por në asnjë rast ato nuk ishin jodemokratike, apo një tradhëtim i parimeve të partisë së tij. Ndonëse parimi politik udhëheqës i Ebertit ishte vullneti i elektoratit, ai besonte fort se republika mund të mbijetonte vetëm mbi bazën e një kompromisi klasor midis lëvizjes punëtore socialdemokrate dhe borgjezisë demokratike. Ai nuk mundi që të adoptonte ndonjë kurs që të ishte thelbësisht i ndryshëm prej atij që ishte adoptuar në tre muajt e parë pas revolucionit të 9 nëntorit 1918. Nuk kishte asnjë alternativë demokratike për politikat e Ebertit dhe të (shumicës) socialdemokratëve. Themeli për një riorganizim politik

u shtrua dhe republika u themelua. Prej atij momenti e në vazhdim, ishte detyrë e Asamblesë Kombëtare kushtetuese që të zhvillonte dhe të siguronte një demokraci parlamentare. Prej atij momenti e në vazhdim, shqetësimi kryesor i Fridrih Ebertit u bë gdhendja e arritjeve të revolucionit në një kushtetutë demokratike, që do ta vendoste të gjithë pushtetin në duart e popullit. Populli, sovrani më i lartë në një sistem demokratik, e kishte dhënë verdiktin e vet më 19 janar 1919. Parlamenti i parë demokratik në Gjermani duhej të vendoste për zhvillimet e mëtejshme. Ky ishte parimi themelor ndaj të cilit Eberti u angazhua edhe përtej periudhës revolucionare.

IV Kreu i shtetit në Republikën e Vajmarit (1919-1925)

1. Një president për çdo gjerman

Në vitin 1919 presidenti i Rajhut të Parë Fridrih Eberti shpalli misionin e tij për detyrën që mbante në samitin e Republikës së Parë Gjermane: “Nisur prej besimit tim të patundur tek populli gjerman, dua t’ia dedikoj gjithçka që kam, mbrojtjes së demokracisë dhe rindërtimit të ekonomisë sonë”. Politika e Ebertit gjatë revolucionit ishte e orientuar kah kompromisit, qoftë me lëvizjen punëtore socialdemokrate qoftë me borgjezinë demokratike; ai iu përmbajt gjithashtu si riorganizimit, edhe ruajtjes së gjendjes, si shtetit federal, edhe pjesëve përbërës. Ky ishte objektivi i tij edhe kur u zgjodh president.

Eberti e pati synuar zyrën më të lartë publike edhe përpara zgjedhjeve të Asamblesë Kombëtare. Në vizionin e tij, kreu i shtetit duhej të luante një rol më përfshirës dhe

aktiv. Ai madje e konsideronte vërtetë potencialin e madh të rolit të tij për të bërë integrimin e të gjitha grupeve në popull. Kur qeveria e revolucionit, Këshilli i Deputetëve të Popullit, diskutoi draftin e kushtetutës, Eberti kritikoi push-tetin e zgjeruar të presidentit të ardhshëm të Rajhut, pse vërtetë ai do të zgjidhej në këtë post prej njerëzve, por më pas do të ishte e vështirë për t'u mbërritur tek ai. Sidoqoftë, Eberti përfundimisht e pranoi postin dhe përgjegjësitë e tij. Si një politikan i kthjellët dhe racional, ai nuk kishte ndonjë dyshim se “disa pushtete të caktuara” ishin thelbësore për “një lidhshmëri të bashkuar dhe të fuqishme për vendin”, sikurse theksoi gjatë një takimi të kabinetit të revolucionit në mes të janarit 1919.

Si president, Eberti donte që ta shfrytëzonte mundësinë për një aleancë mes lëvizjes punëtore socialdemokrate dhe borgjezëve demokrate si dhe të tejkalonte ndasitë sociale mes “*Reichstreunen*”-ve (besnikëve të perandorisë së rënë) dhe “*vaterlandslose Gesellen*” (“njerëzve pa atdhe”), që e kishin karakterizuar Kajserrajhun. Gjatë negociatave për krijimin e qeverisë së parë republikane, ai u mbështet tek i ashtuquajturi Koalicioni i Vajmarit i përbërë prej SPD-së, Partisë Katolike të Qendrës (*Zentrum*, Z) dhe liberalëve të majtë DDP (*Deutsche Demokratische Partei*; Partia Demokratike Gjermane). Një koalicion me USPD-në ishte i pamendueshëm për Ebertin pas përvojës së tij të hidhur gjatë periudhës revolucionare. Për më tepër, dy partitë socialdemokrate nuk e kishin shumicën në Asamblenë Kombëtare. Aleanca e SPD-së me dy partitë republikane borgjeze e realizuar prej Filip Sheidmanit, bashkë drejtuesit të SPD-së, zotëronte një shumicë të rehatshme prej 3/4-ave. Duke krijuar një koalicion kaq të gjerë për një president socialdemokrat, në fakt ishte mbërritur te një lidhshmëri shteti vërtetë i fuqishëm. Sidoqoftë, ky koalicion dështoi vetëm pas disa muajsh. U shkri në qershor të 1919-ës për shkak të diferen-



Një “urra” për të parin kre shteti të zgjedhur në mënyrë demokratike, përpara teatrit të Vajmarit, pas zgjedhjes së Fridrih Ebertit si president më 11 shkurt 1919.

cave, që u shfaqën lidhur me traktatin e paqes. Megjithëse aleanca u ribë në tetor 1919, ajo nuk e fitoi dot forcën për të cilën Eberti kishte shpresuar.

Këto ngjarje ishin ende duke u zhvilluar, teksa Eberti u zgjodh president. Në 6 shkurt 1919, ai e inauguroi Asamblenë Kombëtare duke thënë: “Populli gjerman është i lirë, do të qendrojë i lirë dhe do të qeveriset vetëm prej vetvetes”. Pak ditë më vonë, parlamenti e zgjodhi socialdemokratit Ebert si kreun e parë demokratik të shtetit në historinë e Gjermanisë me 177 nga 379 vota. Rezultati nuk ishte aq i fortë sa ç’ pritej, duke qenë se më shumë se pesëdhjetë përfaqësues të koalicionit të ardhshëm të Vajmarit nuk votuan për Ebertin, ndonëse ky e kishte shtruar rrugën e mbështetjes gjatë negociatave për ndërtimin e qeverisë së re. Sidoqoftë, zgjedhja e socialdemokratit Fridrih Ebert në zyrën më të lartë të republikës së re, ndërsa dikur

përrjashtoj si armik i Rajhut, ishte një shenjë e dukshme e një fillimi të ri kushtetues.

Pas zgjedhjes së tij, Eberti u betua se do të përfaqësonte të gjithë popullin gjerman dhe se nuk do të sillej thjesht si “lideri i një partie të vetme”. Ky dedikim ndaj mos-partizanizmit mbeti parimi i tij udhërrëfyes gjatë mandatit në krye të shtetit. Ai premtoi gjithashtu se “do të mbroj lirinë e të gjithë gjermanëve me të gjithë pushtetin dhe dedikimin tim. Kjo është besa që unë jap në këtë moment dhe që e vendos në duart e Asamblesë Kombëtare”. Ndërkohë që interesat e shtetit dhe ato të partisë e çonin Ebertin në drejtime të ndryshme, ai shërbeu për gjashtë vite si kreu i shtetit në një republikë që nuk shihej me sy të mirë dhe që ishte e kalbur nga poshtë si dhe së brendshmi, në trazim të vazhdueshëm me vetveten.

Ai u dëshmuar ta përdorte vazhdimisht fuqinë që i jepte zyra. Ligji “*Mbi Pushtetin Aktual të Rajhut*” (*Gesetz über die vorläufige Reichsgewalt*), që prej 10 shkurtit 1919 ishte zëvendësuar prej kushtetutës së tranzicionit, i kishte shfaqur tashmë linjat e pushtetit të ardhshëm presidencial. Ky pushtet ishte kodifikuar përfundimisht në kushtetutën kombëtare të votuar prej Asamblesë Kombëtare në fund të korrikut 1919. Sipas kushtetutës së Vajmarit, presidenti duhet të zgjidhej direkt nga populli për një mandat shtatë vjeçar. Ky fakt i jepte zyrës më shumë pushtet, sesa cilido institucion tjetër i republikës. Sidoqoftë, Eberti nuk u zgjodh kurrë prej popullit. Megjithëse ai kishte bërë thirrje gjithnjë për mbajtjen e zgjedhjeve popullore, qeveria e tij hezitonte. Më në fund, më 24 tetor 1922, Rajhshtagu e shtyu mandatin e tij në zyrë deri në 30 qershorin e 1925-ës me një amendament kushtetues. Pavarësisht faktit që nuk u zgjodh kurrë direkt prej popullit, gjë që dha shkas për sulme ofenduese duke e quajtur “Fridrih i përkohshmi”, Eberti e shihte veten si një president me krahë të ngrohta.

Kushtetuta kishte krijuar një kre shteti me pushtet të konsiderueshëm. Presidenti kishte të drejtën që të emëronte kancelarin, mund të shpërndante Rajhshtagun dhe mund të prodhonte dekrete sipas nevojës së qeverisë, pa miratimin e parlamentit. Më tej, ai ishte përfaqësuesi i politikës së jashtme të Rajhut dhe komandanti suprem i forcave të armatosura. Krahasuar me qeverinë dhe parlamentin, pozita e tij ishte tejet e fuqishme, të paktën sipas teorisë kushtetuese. Megjithatë, përkundër vizionit të hartuesve të kushtetutës dhe konceptit të tyre për një president të fuqishëm, të cilin e zgjidhte populli drejtëdrejtë si një kundërpeshë ndaj parlamentit dhe kabinetit, kreu i parë republikan i shtetit e shihte veten gjithnjë si pjesë të qeverisë dhe jo si armik i saj. Uniteti i qeverisë ishte për Ebertin një rregull i pashkelshtëm. Duke marrë parasysh situatën e krizës së vazhdueshme, ai, në një mbledhje të kabinetit më 1921-shin paralajmëroi se “leadershipi duhet mbajtur fort në duart e qeverisë”. Konfliktet duheshin zgjidhur së brendshmi. Ky ishte parimi i parë politik i Ebertit, një bindje që e kishte origjinën që përpara Luftës së Parë Botërore, kur socialdemokratët e humbën shumicën e forcës së tyre duke bërë debate filozofike në publik. Sipas bindjes së tij, çështjet me kundërshti të hapur duhen biseduar me dyer të mbyllura, dhe pasi të ishte arritur një kompromis, të gjitha palët e përfshira duhet ta mbronin konsensusin njëzëri. Ai e ndoqi këtë parim gjatë kohës që shërbeu si kryetar i partisë dhe madje më shumë gjatë kohës si president.

Megjithatë kjo nuk do të thoshte patjetër se presidenti dhe qeveria ishin në harmoni perfekte me njëri – tjetrin. Presidenti nuk tërhiqej prej përplasjeve me qeverinë dhe këmbëngulte tek të drejtat e veta. Në kabinet, Eberti e vërtetoi të ishte një anëtar bashkëpunues skuadre, i cili dinte se kur ta mbronin terrenin e tij dhe kur të pranonte mendimin e shumicës. Në disa raste ai do të kishte bërë më mirë nëse



Fridrih dhe Louise Ebert gjatë pushimeve të tyre në Schwarzburg, 1919

do të kishte këmbëngulur më fort në vizionin e vet. Për shembull, ai nuk donte që ta aprovonte vendimin jashtëzakonisht të zbutur të Gjykatës Ushtarake ndaj vrasësve të Rosa Luxemburg-ut dhe Karl Liebknecht-it, që shumë njerëz e konsideronin një vendim skandaloz, ndërkohë që qëllimi i Ebertit ishte rihapja e procesit. Sidoqoftë ai u bashkua me shumicën e kabinetit. Fill pas kësaj, Gustav Noske (SPD), ministri i përgjegjshëm i mbrojtjes, konfirmoi verdiktet, duke e zbehur mundësinë për të dhënë drejtësi.

Në mënyrë të ngjashme, Eberti dështoi në ndërmarrjen e një fushate për shqyrtimin me ndershmëri të çështjes së fajit të luftës. Ai vetë kishte kërkuar që ajo fushatë të realizohej. Kjo do ta kishte lehtësuar barrën për qeverinë republikane, nëse përmes hetimit mbi ngjarjet e 1914ës do të provohej se regjimi i vjetër perandorak kishte qenë parësisht përgjegjës për shpërthimin e luftës. Eberti ishte i bindur se Gjermania duhet të merrte hisen e luanit për fajin. Sidoqoftë, ai nuk e pranoi idenë se Gjermania ishte përgjegjësjë e vetme për

luftën, sikurse ishte shkruar në Traktatin e Versajës. Vendimmarrësi i ri, duke pranuar përgjegjësinë e Gjermanisë për shpërthimin e luftës, do të tregonte shkëputjen e plotë të republikës së re me Kajserrajhun dhe do të dënonte kështu politikën monarkiste për zgjerimin e pushtetit. Eberti e kishte parë këtë mundësi. Megjithatë, ai nuk këmbënguli as publikisht që të damkosej politika e jashtme villhelmjane, apo ndonjë pjesëz e qeverisë demokratike. Në këtë pikë ai ndoqi shumicën në vend të bindjes së vet.

Eberti, që gjithmonë mezi priste që të arrinte një konsensus, veprimi si ndërmjetës dhe moderues, si një njeri i kompromisit dhe balancës në çdo debat. Ata që e takuan presidentin personalisht, ose që patën ndonjë bisedë me të, teksa ai shijonte cigaret e tij të zakonshme të mëngjesit në zyrën plot tym në Berlin Palais, 73, Wilhelmstraße, e njohën sjelljen e tij modeste dhe të ngrohtë. Të nesërmen e zgjedhjes së Ebertit në detyrë, publicist Theodor Wolff shkroi në "*Berliner Tageblatt*":

"Në rininë e tij si shalëpunues, Fritz Eberti po ngjitet në fron [...] Duhet pranuar se Eberti nuk përfaqëson as formën më të lartë të rafinimit kulturor, dhe as shtetarinë politik më të mirë. Megjithatë, ai zotëron cilësi ëndëse dhe të paçmueshme, mbi të gjitha, një ngrohtësi me këmbë në tokë dhe një ndershmëri të thellë. Ai nuk është një gjeni rrëzëllues [...] por ai personifikon atë që mund të quhet një gjykim i mprehtë".

Asnjëherë nuk pati ndonjë opinion të gjithëpranuar lidhur me Ebertin, as si njeri, e as si politikan. Kjo mbetet e vërtetë jo vetëm në popullin gjerman, por edhe për diplomatët që e takuan presidentin e parë. I dërguari amerikan Ellis Lorinf Dresel shkruante se Eberti, të cilin ai e pati takuar duke udhëtuar nëpër Gjermani në fund të 1918-ës, ishte një burrë "me sinqeritet dhe ndershmëri të madhe". Që prej ditëve të para të revolucionit, amerikanët e kon-

sideronin Ebertin si “plotësisht të sinqertë dhe të vërtetë”. Ambasadori amerikan Alanson B. Houghton, i cili ishte emëruar në 1922-shin, vërente në ditarin e tij më 1925-ën: “Eberti është me të vërtetë një figurë mbresëlënëse. Për mua ai është gjermani më i fortë dhe i aftë që unë kam takuar”.

Sir Edgar Vincent Baron D’Abernon, ambasadori britanik në Gjermani që prej 1920-ës, përdorte një ton pak më të ndryshëm sesa ai i homologut të vet amerikan, që ishte një industrialist nga Corning i New Yorkut. D’Abernon, një njeri me histori shoqërore shumë të largët prej asaj të Ebertit, oficer i Madhërisë së Tij dhe përfaqësues prej shumë mandatesh në Dhomën e Komunëve, nuk mund të gjente dot shumë bazë të përbashkët me Ebertin, ndaj dhe e shfaqti këtë diferencë shoqërore në këtë vlerësim:

“Presidenti i Rajhut, Eberti, ishte aty dhe unë pata pak bisedë me të pas darkës. Nuk e sheh dot në sy pa menduar nëse ai në fakt është ndonjë kryebashkiak i një qyteti të vogël francez pranë Besançonit. Ka pak gjermanik tek ai; nuk ka asgjë socialiste dhe edhe më pak shalëpunues. Ai duket sikur ka shijuar një biznes të vogël borgjez që prej ditës kur ka lindur. Ata që e takojnë nga afër thonë se ai është i ndjeshëm, por i kthjellët, mirëpo unë nuk kam krijuar ndonjë pëlqim të veçantë për të”.

Megjithatë, ai e gjeti me vend që ta zgjeronte mendimin e tij, edhe pse nuk donte që ta distancoje veten prej opinionit të shprehur më parë. Pas një pritjeje në 1924-ën, ai shkroi:

“Duke marrë parasysh se ai ka qenë një shalëpunues dhe që ajo (gruaja e Ebertit) e ka nisur jetën në rrethana shumë të përlulura, është mahnitëse të vëresh se me çfarë dinjiteti dhe rezervimi sillen ata. Askush nuk mund të flasë si të dojë me Ebertin; edhe nëse do të takonte princin më aristokrat ai do vazhdonte të ruante vetëpërmbytjen. Nuk mund të thuhet se ai është i dakordësueshëm, mirëpo ai

fjalos lehtë dhe me një dashamirësi të madhe. Asgjë origjinale, por asgjë false ama”.

Negociatori i kujdesshëm Ebert thirrej gjithnjë për ndihmë kur situata dukej e pashpresë. Shpesh ai ishte i aftë që ta thyente akullin. Sido që zakonisht barazpeshonte diferencat e interesave, ai mund të zemërohej shpejt. Kancelari Joseph Wirth e përshkroi atë më vonë si “të acarueshëm lehtësisht, tipike për dikë që vjen nga Palatinati (rajon i Renit në jugperëndimin gjerman)”. A kishte shans që Wirthi, anëtar i Partisë së Qendrës i lindur në Baden, të mund të identifikonte me të vërtetë një veçori palatine? Në çdo ngjarje, raportohet se Eberti i lindur në Heidelberg, mund të reagoonte shpesh herë ashpër.

Ai sidoqoftë ishte i aftë që të dëgjonte arsyetime dhe argumente, e më pas ta ndryshonte mendimin e tij nëse ato të kundërta e bindnin. Ai nuk ishte aspak dogmatik apo i vetëkënaqur. Nga ana tjetër, ai nuk u bë kurrë ankonjë e qeverisë. Mbi të gjitha, ai ishte tejet i përfshirë në politikë, në një shkallë edhe më të gjerë nga sa njihej publikisht dhe e përmbushte detyrën e vet në mënyrëshumë të përpiktë. Ai nuk kishte as vullnet e as aftësi që të vepronte si një zëvendës i perandorit duke ndërhyrë së tepërmi në politikë. Ai e shihte rolin e vet si mbrojtës të kushtetutës dhe rojtari i rendit demokratik. Fridrih Eberti e përdori pushtetin e presidentit në maksimum dhe duke vepruar kështu, ai e ngriti atë në nivelin e zyrës më të lartë publike për të cilën nuk ekzistonte asnjë shembull i mëparshëm, e shndërroi në një institucion të fuqishëm në skakierën e brendshme politike të republikës së re. Në asnjë mënyrë, ai nuk u shndërrua në një dordolec me funksion thjesht përfaqësues. Eberti ishte dhe mbeti një president aktiv. Të gjitha veprimet e tij punuan drejt synimit për të siguruar një sistem parlamentar funksional.

2. Presidenti dhe qeveria

Një prej detyrave kryesore të presidentit të Rajhut ishte edhe caktimi i kancelarit (*Reichskanzeler*). Eberti nuk e shihte këtë thjesht si një procedurë formale, por si një shans për pjesëmarrje. Gjatë diskutimeve lidhur me formimin e qeverisë, ai reagoi me bindjen se stabiliteti i qendrueshëm do të ishte i mundur vetëm nëse sistemi i ri demokratik do të ishte i aftë që të shtendoste tensionet midis klasave dhe të paqësonte shoqërinë e përçarë. Këtë bindje ai e ushqente duke mbajtur parasysh trazirat sociale për shkak të pasojave të luftës. Sipas këtij vizioni, republika ishte e mundur të funksiononte vetëm përmes bashkëpunimit të klasës punëtore me borgjezisë. Në mënyrë që të tejkalohet pengesa e krijuar prej detyrimeve të mëdha që iu ngarkuan Gjermanisë nga fuqitë fituese si dhe për të qetësuar zemërimin e brendshëm të shkaktuar prej kësaj barre, Eberti e konsideroi të nevojshme që të përfshinte interesat industrialiste tek i sipërpërmenduri bashkëpunim midis klasave. Kjo barrë duhej mbajtur nga shumë njerëz. Mbi bazën e këtij vlerësimi, Eberti i bëri thirrje partisë së tij që të futej në një aleancë qeveritare me partitë kushtetuese borgjeze, jo vetëm një herë. Kjo përfshinte edhe Partinë e djathtë liberale të Popullit Gjerman (*Deutsche Volkspartei - DVP*), që drejtohej nga Gustav Stresemanni, i cili e kishte ndryshuar krahun dhe ishte bërë një “republikan racional” (të ashtuquajturit Vernunftrepublikaner) në mes të 1920-ës. Fridrih Eberti kërkonte një qeveri sa më të gjerë që të qe e mundur në mënyrë që të funksiononte për një kohë të gjatë. Por kjo ishte vetëm një dëshirë e pamenduar.

Eberti në fillim bëri thirrje për një koalicion të gjerë mes SPD-së, Partisë së Qendrës, DDP-së dhe DVP-së pas zgjedhjeve të Rajhshtagut në qershor 1920, kur Koalicioni i Vajmarit e humbi shumicën dhe socialdemokratët humbën një sasi të madhe votash.



Pritja përkujtimore për 10-vjetorin e shpërthimit të Luftës së Parë Botërore në 3 gusht 1924 është më së shumti një shfaqje thjesht zyrtare për Fridrih Ebertin, i cili kishte humbur dy prej djemve të tij në fushëbetejë. Fotografia tregon Fridrih Ebertin me tre kancelarë: atë që ishte në detyrë asokohe Wilhelm Marxin, (i dyti nga e majta), paraardhësin e tij Gustav Stresemann, i (gjashti nga e djathta) dhe Hans Lutherin, në të majtë të Ebertit, i cili më vonë u bë kreu i qeverisë në janar 1925.

Në nëntor të vitit 1922 ai iu dretjua përfaqësuesve të partive duke thënë: “Nuk e kam mbajtur ndonjëherë veten si përkrahës të një koalicioni të gjerë, ndoshta ky ka lindur prej nevojës, por është për të mirën e shtetit”. Ai e përhap vizionin e tij se kompromisi ndërmjet grupeve të interesit dhe partive ishte një pjesë integrale e demokracisë parlamentare dhe se situata aktuale e tendosur kërkonte veçanërisht zgjidhje me një konsens të gjerë. Sidoqoftë, partitë në shumicën e rasteve nuk ishin të përgatitura që ta ndiqnin këtë parim, për shkak se atyre u mungonte vullneti për të bërë kompromise në mënyrë që të kombinoheshin interesat e ndryshme. Eberti, nga ana tjetër, e mendonte të mundur tejkalimin e pengesave ideologjike dhe programore midis partive. Ai gjithnjë kishte

pritshmërinë se partitë do t'ia nënshtonin qëllimet e tyre taktike nocionit abstrakt të “të mirës së shtetit”, ndaj predikoi vazhdimisht arsyen, përkrahu unitetin dhe krijimin e një “falange” kohezive në mënyrë që të mund të përballoheshin pasojat e Traktatit të Versajës. Kjo gjithsesi u pengua prej segmentimit të kampit politik në shumë parti. Për më tepër, mungesa e përvojës në qeverisje nën rëndesën e vazhdueshme të një koalicioni, pasojë kjo e përjashtimit të partive të dikurshme prej pjesëmarrjes në Kajserrajh, ishte një tjetër pengesë për përpjekjet e Ebertit drejt unitetit parlamentar. Ata nuk kishin mësuar askund se si të mund të formonin një qeveri parlamentare. Partitë preferuan të ktheheshin tek karriget e tyre të rehatshme opozitare. Nuk pati ndonjë ndikim as fakti që votuesit në Vajmar i ndëshkonin partitë sa herë që ato merrnin pjesë në qeverisje.

Kështu, SPD-ja reagoi ndaj rezultatit të dobët në zgjedhjet e Rajhshtagun e qershorit 1920 (21.7 për qind, krahasuar me 37.9 për qind që ishin fituar në zgjedhjet për Asamblenë Kombëtare në janar 1919) duke dalë në opozitë. Pasi u çlirua nga përgjegjësia, partia synonte të fitonte fuqi dhe t'i rimerrte votat që kishin kaluar te rivalët në të majtë të tyre, socialdemokratët e pavarur. Eberti, me siguri që e kuptoi arsyetimin e partisë së tij. Nga një këndvështrim politik kombëtar, ai sidoqoftë nuk e mirëpriti dorëzimin e pushtetit dhe si një politikan i fortë nuk e miratonte opsionin e një qeverie për të hedhur peshqirin në ring. Detyrimet e mëdha ndaj aleatëve dhe vendimet e rëndësishme që kjo çështje kërkonte, kishin detyruar shumë politikanë të *jepnin* dorëheqjen. Eberti duhet të ketë qenë shumë i bezdisur kur Constantin Fehrenbach-u i Partisë së Qendrës dha dorëheqjen në maj 1921, vetëm disa javë përpara skadimit të ultimatimit të Aleatëve – ultimatumi i Londrës - që kërkonte pranimin nga ana e Gjermanisë të reparacioneve të luftës. Ishin dashur disa javë negociata

derisa të gjitha partitë kishin rënë dakord për të zgjedhur Fehrenbach-un si kancelar në fund të qershorit 1920. Duke u dorëhequr, Fehrenbach shkaktoi një krizë qeverisjeje, më të keqen e të gjitha kohërave.

Në vitin 1922 Eberti u tregoi disa miqve të partisë në Dessau se socialdemokratet kishin mësuar që “të ishin prezent kur kërkoheshin”. Ai vepronte mbi këtë parim dhe priste që edhe të tjerët në partinë e tij të bënë po kështu. Ai ishte i impresionuar prej kancelarit të ri Joseph Wirth-i i Partisë së Qendrës, i cili në mënyrë të vendosur trajtoi disa çështje delikate në maj të 1921-shit dhe kaloi një krizë politike në tetor 1921, në prag të vendimit të aleatëve për të ndarë Silezinë e Sipërme, duke krijuar me shpejtësi një kabinet të ri.

Shumë përpjekje për të krijuar një qeveri përfunduan me një situatë pa rrugëdalje për shkak se partitë hezitohnin dhe nuk kërkonin me shumë vendosmëri të merrnin pushtetin sikurse në janar 1920. Eberti i bëri presion të vazhdueshëm Partisë së Qendrës derisa e bindi Constantin Fehrenbach-un që të pranonte zyrën e kancelarit. Disa kandidatë të cilët Eberti i kishte favorizuar në fillim, kishin dështuar në hapat e parë të negociatave për shkak të sjelljes kokëfortë të partive të përfshira. Disa politikanë të nxitur prej Ebertit për të kandiduar, ranë pre e luftës së krahëve kundërshtarë brenda vetë partive të tyre.

Presidenti e pati të vështirë që të gjente kandidatë të përshtatshëm, të cilët do të ishin të vullnetshëm dhe të aftë për të ndërtuar një qeveri të qëndrueshme për shkak të zakonit të politikanëve për t’iu shmangur përgjegjësisë. Revista satirike “Simplicissimus” publikoi në 1923-shin një karikaturë me Ebertin që kollitej pa pushim në shtrat, me diçiturën: “Krizë pa mbarim e kancelarit” dhe e shoqëruar me një thënie të poetit Hajnrih Hajne të vitit 1843: “Të mendosh për Gjermaninë natën, kjo t’i çon të

gjitha mendimet për të fjetur në arrati”. Në fakt ka shumë gjasa që çështja e kancelarisë ta ketë munduar gjumin e Ebertit herë pas here. Atij i duhej që të ushtronte një presion të madh mbi kandidatin që pëlqente, shpesh edhe duke e kërcënuar me dorëheqjen e vet, në mënyrë që ta bindte politikanin në fjalë që ta merrte në dorë qeverinë. Disa përpjekje për të krijuar qeverinë u kthyen në një ecejake të vështirë mbi gjemba. Ato dominoheshin prej manovrave taktike, që Eberti nuk i pëlqente. Në mendjen e tij, manovra të tilla shmangëse dëmtonin reputacionin e demokracisë parlamentare. Në disa situata pa krye, presidenti nuk hezitoi të përdorte edhe metoda jokonvencionale. Në 1924-ën ai e shpërndau dy herë Rajhshtagun në marrëveshje me qeverinë dhe pjesë të mëdha të parlamentit, sepse ishte e pamundur të vazhdohej të qeverisje prej pozicioneve në llogore. Sidoqoftë, pas zgjedhjeve, sërish nuk kishte ndonjë shumicë të dukshme. Prapë u desh një kohë e gjatë derisa u formua qeveria.

Në nëntor të vitit 1922, kur qeveria e Wirthit dështoi, partitë nuk bënë ndonjë përpjekje për të emëruar ndonjë kancelar tjetër apo për t’u futur në qeveri. Në këtë situatë ngërçi politik, Eberti caktoi Wilhelm Cuno-n, një konservator pa përkatësi partiake dhe drejtor i kompanisë detare “Hapag” me qendër në Hamburg, si kreun e të ashtuquajturit “*Geschäftsministerium*”, një kabinet jopartiak i përbërë prej ekspertësh të pavarur. Caktimi i Cuno-s si kancelar ilustronte më së miri krizën e shtetit të partive parlamentare. Më vonë, kjo përzgjedhje rezultoi të ishte një gabim, për shkak se Cuno, ndonëse ekspert ekonomie i respektuar, bashkë me skuadrën e vet u treguan të paaftë për të menaxhuar situatat e brendshme dhe të jashtme, që sa vinin e përkeqësoheshin në prag të pushtimit franko-belg të Rurit, si dhe inflacionin me rritje dramatike.

Kabineti i dëshiruar prej Ebertit u formua në verën e

1923-shit, pikërisht kur Gjermania ishte në skaj të kolapsit. Megjithatë, “Koalicioni i Madh” që niste nga DVP-ja deri tek SPD-ja, nën kancelarin Gustav Stresemann (DVP) nuk zgjati as tre muaj, sa edhe mërzitja e Ebertit. Më në fund, pas disa thirrjeve të forta, ai e bindi Wilhelm Marx-in e Partisë së Qendrës, i cili fillimisht kishte hezitur, që të merrte në dorë kancelarinë. Ky ishte një moment tjetër në të cilin presidenti e influenoi thellësisht përzgjedhjen e kancelarit pasardhës, sikurse kishte bërë edhe në fillim të ardhjes së tij në pushtet. Në qershor 1919, Eberti kishte caktuar mikun e tij Gustav Bauer (SPD) si kreun e qeverisë përkundër dëshirës së grupit parlamentar të SPD-së, që parapëlqente liderin e partisë Herman Müller-in i cili në fakt e pasou Bauerin në mars 1920.

Në fund të 1924-ës Eberti kuptoi se, influenza e presidentit në negociatat për formimin e qeverisë do të ishte e limituar nëse partitë do të vijonin secila me kokën e vet. Për shembull, ai luftoi shumë fort kundër pjesëmarrjes së anti-republikanëve të DNVP-së në qeveri, luftë që u pasua prej Stresemannit në vjeshtën e vitit 1924. Në fillim të 1925-ës, pas disa muajve përplasje, Ebertit iu desh të dorëzohej dhe ta pushonte Marx-in, të cilin kishte dashur ta mbante fort me çdo kusht, në mënyrë që të parandalonte një kthesë të fortë djathtas. Antirepublikanët e DVNP-së, të cilët i kishin shpallur një luftë politike republikës, u futën për herë të parë në qeveri në kabinetin e kancelarit të pavarur Hans Luther. Midis tyre kishte një ministër, i cili kishte refuzuar që të bënte betimin ndaj kushtetutës në 1920-ën. Eberti e konsideronte një anormalitet faktin që, prej të gjithë politikanëve të mundshëm, duhej të ishte pikërisht një anëtar i DNVP-së ai që të merrte në dorë ministrinë e brendshme dhe të ishte përgjegjës për departamentin e çështjeve kushtetuese. Megjithëse kjo nuk shkante me planet e Ebertit, ai nuk e pengonte dot atë çka po ndodhte. Influenca e



Miq të vjetër, të lidhur prej një shoqërie të ngushtë: Fridrih dhe Louise Ebert në Shwarzburg, Turingi, me Gustav Bauerin, i cili ishte caktuar kancelar në qershor 1919, dhe me gruan e tij Hedwig.

presidentit për zgjedhjen e kancelarit dhe formimin e koalicionit qeverisës ishte e limituar nëse partitë ishin aktive. Megjithatë, ata shpesh hezitnin të merrnin përgjegjësi.

Gjatë gjashtë viteve të mandatit të tij, presidenti nuk pa më pak se nëntë kancelarë dhe mbi 12 kabinete, shumica e të cilave nuk mbanin as shumicën në parlament. Mesatarja e kohëzgjatjes së një qeverie nuk ishte më shumë sesa gjashtë muaj. Krahasuar me këto ngjarje, gjashtë vitet e mandatit të Ebertit në zyrë ishin të mrekullueshme. Deri në 1925-ën, ai ishte në shumë kuptime i fundmi i Mohikanëve prej atyre që kishin ardhur në pushtet që prej 1918/19-ës dhe ende e mbanin postin. Shpesh vetë Eberti dëshironte që ta zhvishte

veten prej barrës së zyrës pasi përjetonte situatat e forta të krizës së vazhdueshme të viteve të para të republikës së Vajmarit, që u shfaq pikërisht kur atij iu desh të vendoste nëse do ta pranonte traktatin e paqes.

3. Përfaqësues i politikës së jashtme të Rajhut

Firmosja e Traktatit të Versajës ishte sfida e parë e politikës së jashtme të republikës së re. Drafti i parë i traktatit, i publikuar prej Aleatëve në maj të 1919-ës, ishte gati një shpërthim për Rajhun e mposhtur gjerman. Përpara se kushtet e traktatit të publikoheshin, Eberti kishte shpresuar për një “paqe mirëkuptimi dhe pajtimi”. Kjo pritshmëri rezultoi të ishte një iluzion. Pasi traktati i shkruar prej Aleatëve u publikua, shpresat për një paqe të përbalueshme u shuan dhe i hapën rrugën indinjatës. Përveç dorëzimit të një të shtatës së territorit të Rajhut, humbjes së kolonive dhe reduktimit drastik të forcave të armatosura, zemëratën më të madhe e shkakttoi së pari e mbi të gjitha artikulli 231 (*Schmachartikel*). Traktati përcaktonte, megjithëse jo në mënyrë precize, pagesat e reparacioneve, të cilat prej fuqive fituese justifikoheshin mbi bazën e përgjegjësisë së plotë dhe vetëm të Gjermanisë për shkaktimin e luftës. Filip Sheidmani e përmbledhi humorin e përgjithshëm të popullit në fjalimin e tij në Asamblenë Kombëtare më 12 maj: “Cila dorë nuk do të këputej prej nesh, nën këta zinxhirë prangosës?”. Eberti u prek prej fjalëve shprehëse të Sheidmanit. Pak ditë më vonë ai gdhendi fjalinë: “Ne nuk do të kishim as nder e as dinjitet, nëse ne nuk do ta përdornim të gjithë fuqinë tonë kundër turpërimit që po na kërcënon”.

Nga njëra anë, mund të protestojë pa kufi e me inat të pandalur, por, nga ana tjetër, duheshin analizuar mundësitë e shmangies dhe këto mundësi ishin tejet të pakta. Në fund, Eberti arriti ta çonte veten deri tek firmosja e traktatit. Nuk

kishte asnjë alternativë ndaj pranimit të traktatit të paqes të diktuar prej fuqive fituese, për aq kohë sa Gjermania nuk do të donte një konflikt tjetër të armatosur, pa pasur asnjë mundësi të arsyeshme për fitore kundër aleantëve, të cilët ishin në një pozicion ushtarak superior. Për të perifrazuar Ebertin, “forca” e tyre nuk ishte aq e madhe sa për të luftuar “turpërimin”. Duke mbajtur parasysh faktin se aleatët kërcënuan se do të vazhdonin sulmet, Asambleja Kombëtare nuk kishte asnjë zgjedhje tjetër përveçse të pranonte traktatin, gjë të cilën e bëri menjëherë pas dorëheqjes së Sheidmanit nga kabineti në 23 qershor 1919. Eberti bëri gjithçka kishte në dorë që të grumbullonte një shumicë në favor të pranimit të traktatit përpara se të skadonte ultimatumit i Aleatëve. Në fund ia doli.

Përballë detyrimit të vështirë për të marrë vendim, Eberti, sikurse edhe shumë politikanë të tjerë gjatë atyre ditëve dramatike të qershorit 1919, qëndronte në skaj të një kolapsi fizik dhe emocional. Ai e mendoj edhe largimin prej postit, që ishte e njëjta praktikë me atë të dorëheqjes së qeverisë së Filip Sheidmanit si reagim kundërshtues ndaj Traktatit të Versajës. Eberti nga ana tjetër, udhëhiqej nga besimi se dorëheqja e tij do të shkaktonte një krizë kombëtare me pasoja të paparashikueshme për ekzistencën e Rajhut. Kështu që ai vendosi të tregonte nivelin më të lartë të etikës dhe përgjegjësisë që e karakterizonin atë si president. Aftësia e tij për t’i përballuar gjërat ishte edhe më domethënëse duke mbajtur në mendje se politikanë të tjerë e kishin zhveshur përgjegjësinë duke u larguar prej posteve të tyre. Në vetvete, ishte një reagim i kuptueshëm nga aspekti i perspektivës së tyre personale, megjithëse shkaktonte pasoja shkatërruese në aspektin e politikave kombëtare.

Traktati i paqes dhe shqetësimi i brendshëm nationalist kundër “paqes së turpshme të Versajës” (*Schandfrieden*) u bënë një barrë e rëndë për Republikën e Vajmarit. Eberti



Fridrih përshëndet presidentin e zgjedhur meksikan Plutarco Elias Calles në Berlin, një prej ngjarjeve të pakta diplomatike me rëndësi nsërkombëtare për shkak të izolimit të Gjermanisë.

ishte i bindur se mundësitë e mira mund të arriheshin vetëm përmes negociatave këmbëngulëse me fuqitë perëndimore. Objektivi i tij ishte që të përdorte hapësirën ekzistuese për manovrim në politikën e jashtme, edhe pse kjo ishte e vogël. Mbi bazën e kësaj ideje, ai mbështeti të ashtuquajturën “politikë e përmbushjes” (Erfüllungspolitik), sipas së cilës, Gjermania do të përpiqej që t’i përmbushte kërkesat e fuqive të mëdha vetëm që të vërtetonte se ato ishin të pamundura për t’u realizuar. Berlini shpresonte se kjo gjë do të nxiste disa lëshime nga ana e Aleatëve.

Duke mbajtur parasysh rolin e rëndësishëm të politikës së jashtme, Eberti donte që të merrte pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e koncepteve politike. Ai e dinte se vendimet e politikës së jashtme ndikonin në çështjet e brendshme të vendit, e sidomos në ato financiare. Eberti i hoqi të gjitha dyshimet nëse ai do ta mbante lart rolin e përfaqësuesit të Rajhut në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe sikurse i garantohej atij prej nenit 45 të kushtetutës. Përtej

Wir wollen nicht mehr, nicht mehr!
Wir wollen nicht mehr diesen Prozess!
Ständpunkt dieser jetzt nicht in
Zukunft für uns nicht
Spenden mit demselben
Freiheit ist, nicht Freiheit
die Handlungsmenge mit Hand-
lungsmenge, die die Ständige
Wille im Sinne der
Menschen immer für alle
Wille zu sein.

Teitel

Shënim i shkruar me dorë nga Fridrih Eberti në 1919-ën: shpresë për një “paqe mirëkuptimi dhe pajtimi”.

përfaqësimit formal të Republikës Gjermane vis-à-vis me shtete të tjera të huaja, kushtetuta i garantonte atij një autoritet faktik për të marrë pjesë në procesin vendimmarrës. Përveç përfshirjes në çështjet e politikës së jashtme, Eberti ndërhyri gjithashtu edhe tek personeli dhe organizimi, si përshebull në riorganizimin e Ministrisë së Jashtme (*Ausëartiges Amt*) dhe të shërbimit diplomatik. Sipas nenit 46 të kushtetutës së Rajhut, presidenti nuk ishte vetëm

përfaqësuesi i politikës së jashtme të Rajhut, por kishte gjithashtu edhe të drejtën për të emëruar nëpunësit civilë dhe të hartonte politikat për personelin. Bazuar po në këtë nen, Eberti ushtronte autoritetin për të bashkëvendosur për caktimin e një ministri të jashtëm, tek i cili ai mund të besonte. Kancelari nuk mund të caktonte një ministër të jashtëm pa presidentin, ose në kundërshtim me të. Caktimi i disa prej tetë ministrave të jashtëm gjatë mandatit të Ebertit ishte iniciuar prej atij vetë.

Zgjedhja e Ebertit për personelin diplomatik, për ambasadorët dhe të dërguarit e shtetit, bazohej në paramendimin për të dhënë një sinjal të dukshëm të ndryshimeve kushtetuese prej Kajserrajhut në republikë. Shumica e nëpunësve civilë në shërbimin e jashtëm gjerman, kishin shërbyer edhe më parë gjatë Kajserrajhut dhe nuk ishin plotësisht të gatshëm që të shkëputeshin prej traditës së vjetër, megjithëse një pjesë e mirë e tyre ishin pajtuar me sistemin e ri. Për më tepër, Eberti thoshte se disa prej tyre po bënë një punë të shkëlqyer. Kështu që, një ndryshim substancial në personelin e shërbimit të jashtëm, sipas tij, nuk ishte i këshillueshëm. Për postet në ambasadat gjermane ai u përpoq që të caktonte individë, që vinin prej përtej sferës së burokracisë administore dhe diplomatike. Gjatë mandatit të tij, shërbimi diplomatik ndryshoi në mënyrë domethënëse dhe u bë i hapur për njerëz që vinin prej sfondeve të ndryshme profesionale.

Eberti ndërhyri si në personelin, ashtu edhe në çështjet e përfaqësimit të politikës së jashtme, ndonëse në këtë pikë aktiviteti i presidentit mbetet i kufizuar. Ai nuk ndërmoi udhëtime jashtë vendit për shkak të izolimit ndërkom-bëtar të Gjermanisë. Shumë pak të ftuar shtetërorë e vizituan Rajhun, ndaj dhe qeveria u jepte shumë rëndësi edhe ngjarjeve më të vogla diplomatike. Për shembull, Eberti priti presidentin e zgjedhur, por ende të pa inauguruar,

meksikan Plutarco Elías Calles, sikurse do të priste cilindo kre tjetër shteti. Ai vizitoi gjithashtu edhe një luftanije stërvitore argjentinase, për shkak se Ministria e Jashtme synonte rritje të prestigjit ndërkombëtar. Detyra e presidentit si përfaqësues i politikës së jashtme ishte përgjithësisht e kufizuar tek pritja e ambasadorëve gjatë akreditimit të tyre dhe mbajtja e pritjes së Vitit të Ri për trupën diplomatike, ku ai mbante fjalime të spikatura. Gjithsesi, Ebert gjykonte se mbështetja për Ministrinë e Jashtme vetëm në këto çështje ishte e pamjaftueshme.

Mosmarrëveshjet me Ministrinë e Jashtme lidhur me rolin e tij si përfaqësues i politikës së jashtme ishin të vogla krahasuar me diferencën thelbësore për sa i përket drejtimit të përgjithshëm të politikës së jashtme. Zvogëlimi i pagesave të reparacioneve dhe riintegrimi i Gjermanisë në komunitetin e kombeve të barabartë mbeti objektivi kryesor i Ebertit gjatë negociimeve të vazhdueshme me Aleatët Perëndimorë. Për ta ruajtur këtë përparim duhej rezistencë dhe durim. Me shpresën për lëshime nga ana e fituesve, Eberti u zhgënjye disa herë, kohë pas kohe. “Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm [...] se na duhet ta mbajmë kryqin të vetëm dhe ta pjmë kupën e trishtimit plotësisht”, tha në nëntor të 1920-ës presidenti që ishte në prag të dorëheqjes.

Kur Aleatët përcaktuan kushtet e reparacioneve në janar 1921, sipas së cilave Gjermania duhet të paguante 226 miliardë marka ari, vetëbesimi i Ebertit u shua plotësisht. Kupa që duhet të pinte Gjermania ishte më shumë sesa plot. Sikurse edhe shumë herë të tjera më parë, Eberti thirri në ndihmë “dorën e përhershme të fatit” për popullit gjerman. Megjithatë kabineti i kancelarit Fehrenbach u dorëhoq duke e lënë qeverinë e re të kancelarit Wirth pa ndonjë mundësi tjetër përveçse të pranonte Kalendarin e Pagesave të Londrës dhe kushtet e tij të ashpra.

Gati një vit më pas, shpërthimi i dytë erdhi me vendimin

e Aleatëve lidhur me Silezinë e Sipërme. Sikurse kërkohej nga Traktati i Paqes, në mars 1921 u mbajt një referendum për kufirin. Megjithëse shumica e popullit votoi për të qëndruar brenda Gjermanisë, Aleatët vendosën që ta ndanin provincën prusiane midis Polonisë dhe Gjermanisë. Pala gjermane, përfshi edhe Ebertin, ishte jashtëzakonisht e zhgënjyer. Sikurse kujton më vonë kancelari Wirth, “Unë nuk e kisha parë kurrë Ebertin më të shkatërruar”.

Në prill 1922 ishte kancerei Joseph Wirth dhe ministri i tij i jashtëm Walther Rathenau (DDP) ata, që shkaktuan zhgënjimin e radhës për Ebertin duke nënshkruar traktatin e Rapallos mes Gjermanisë dhe Ruisë Sovjetike. Përfundimi i traktatit në qytetin verior italian e kapi presidentin në befasi. Wirthi kishte bërë çmos për të ruajtur sekretin e përgatitjeve prej Ebertit, duke e ditur orientimin e këtij të fundit kah Aleatëve Perëndimorë dhe mosbesimin e tij ndaj sovjetikëve. Presidenti nuk donte të negocionte me Moskën pasi nuk i konsideronte bolshevikët të besueshëm. Mirëpo edhe Eberti nuk e përjashtonte mundësinë për t’iu qasur Ruisë Sovjetike nëse do të lindte nevoja. Ai ishte mjaftueshëm realist në politikë sa për ta mbajtur syrin hapur për interesat gjermane në Lindje. Sidoqoftë, Traktati i Rapallos në sytë e tij ishte një tour de force i keqkoordinuar dhe i panevojshëm.

Traktati, që stabilizonte marrëdhëniet diplomatike midis Gjermanisë dhe Ruisë Sovjetike, e tëhuajsoi Ebertin për një kohë të gjatë për shkak të bindjes së tij se orientimi i ri drejt Lindjes do ta dëmtonte thellë politikën ndaj Perëndimit dhe marrëdhëniet e Gjermanisë me fuqitë perëndimore. Ai, si president, me të drejtat që i garantonte kushtetuta si përfaqësues i politikës së jashtme, u ndje i befasuar dhe i lënë mënjane prej asaj që ai e quajti një traktat i parakohshëm. Ministria e Jashtme, në politikën e veta ndaj Lindjes, e kishte anashkaluar atë edhe një herë tjetër. Në maj 1821, qeveria

kishte firmosur dy traktate me Rusinë Sovjetike me metodën coup de main. Eberti e mësoi lajmin për këtë firmë të nxituar të traktateve vetëm prej gazetave. Joseph Wirthi, që asokohe ishte ministër i financave, e kishte shpejtuar mbylljen e këtyre traktateve duke e vënë në gjumë kreun e shtetit. E njëjta gjë ndodhi edhe një vit më vonë kur sërish Wirthi shërbente si figurë kyç, por këtë radhë si kreu i qeverisë.

Eberti ishte shumë i mërzitur për këtë veprim mënjanes të kancelarit dhe të ministrit të jashtëm në Rapallo. Ai i refuzoi të gjitha përpjekjet për ta qetësuar që vinin prej të tjerëve. Megjithatë, edhe pse ky coup kishte shkaktuar një skizmë të pariparueshme midis Ebertit në një anë dhe Wirthit dhe Rathenaut në anën tjetër, presidenti nuk donte që të shkaktonte një krizë qeverisëse. Ai nuk i ushqeu idetë se uniteti i qeverisë duhej mburrur në publik. Në këtë mënyrë ai veproi sipas vetëkonceptimit të tij si një



Fridrih Eberti viziton anijen argjentinase “Presidente Sarmiento” në Hamburg me të dërguarin argjentinase në Gjermani Louis Molina, në të djathtë, korrik 1923.

shtyllë e qeverisë. Duke treguar unitet, sikurse ishte edhe maksima mbi të cilën vepronte, ai nuk e shfaqti zhgënjimin e vet. Në shtyp ai e mbante traktatin si të nevojshëm dhe thelbësor, përkundër bindjes së vet.

Sidoqoftë, marrëdhënia mes presidentit dhe kancelarit u dëmtua rëndë, gjë që nuk ishte pa pasoja edhe për dëshkrimin e mëvonshëm të Wirthit. Për shkak të traktatit të Rapallos dhe veprimeve të tjera mënjane, Wirthi e kishte humbur të gjithë besimin në sytë e presidentit. Në nëntor 1922, pasi kancelari kishte udhëhequr pa sukses negociatat e gjata një javore për zgjerimin e koalicionit me DVP-në e Stresemannit, Eberti nuk bëri asgjë për ta ndihmuar politikanin e paaftë të Partisë së Qendrës. Për një kohë të gjatë presidenti i Rajhut e kishte çmuar Wirthin si një politikan të fortë në vendimmarrje. Sidoqoftë, në 1922-shin dështimi i Wirthit nuk ishte shqetësim për Ebertin. Rapallo kishte qenë një dëm i madh.

Sado që traktati ishte në fakt një sukses për Gjermaninë e izoluar në arenën ndërkombëtare, ai, ashtu sikurse druhej Eberti, kishte shkaktuar acarim tek fuqitë perëndimore. Franca pushtoi zonën e Rurit në janar 1923, çka u pasua prej krizës më të rëndë të republikës. Në këtë situatë emergjence, ashtu sikurse edhe në të tjera më parë, presidenti nevojitej më shumë se kurrë.

4. Presidenti dhe kriza e republikës

Vitet e para të republikës u karakterizuan prej trazirave të brendshme, që shpërthenin kohë pas kohe. Puçi Kapp-Lüttwitz i marsit 1920 ishte përpjekja e parë në nivel kombëtar për ta rrëzuar republikën e re. U nxit prej çmobilizimit drastik të ushtrisë në detyrë, e cila kishte ende 500,000 ushtarë në atë kohë, por do të reduktohej në 100,000 sipas Traktatit të Versajës. Eberti, si komandant i përgjithshëm, ishte shumë

i përfshirë në çështjet që lidheshin me personelin ushtarak, madje më shumë nga ç' mendohej. Shumicën e kohës ai mbështetej tek ekspertiza e ofruar prej oficerëve të lartë ushtarakë dhe politikanëve përgjegjës për politikat ushtarake. Eberti sidoqoftë nuk u kthye kurrë në një ndjekës të bindur të këshillave të të tjerëve. Ai ndoqi vetëm ato politika ushtarake, që i konsideronte të nevojshme dhe të realizueshme. Gjatë periudhës revolucionare nuk ishin iniciuar as reforma strukturore dhe as ndryshime të mëdha në personel. Eberti i mori vendimet e para për të ardhmen e ushtrisë me ndihmën e elitave ekzistuese.

Si president i Rajhut, Eberti ndoqi politikën e vet ushtarake. Ai kishte si synim që gradualisht të ndërtonte një marrëdhënie besimi mes ushtrisë dhe presidentit të Rajhut, pa ndryshime të mëdha në personel apo strukturë. Ishte qëllimi i tij që të integronte ata oficerë ushtarakë, të cilët e kishin nisur karrierën e tyre nën Kajserrajhun dhe kishin kaluar më pas në republikë. Kjo do t'u ofronte atyre mundësinë që të binin dakord me sistemin demokratik. Megjithatë, trupa e oficerëve nuk jepte garanci për besimin, që ai u jepte atyre. Gjatë çmobilizimit të detyruar të Reichswehrut në përputhje me Traktatin e Versajës, brigada e marinës "Ehrhardt", trupa më efektive e Rajhut të asaj kohe, ishte një prej njërive që duhej shkrirë në mars 1920. Gjenerali Walter von Lüttwitz i bëri thirrje Ebertit që ta tërhiqte direktivën, duke lëshuar kështu një ultimatum. Eberti refuzoi. Kjo ishte shenja që prisnin një grup konspirator i krahut të djathtë politiko-ushtarak, që qëndronin rreth oficerëve të lartë Wolfgang Kapp dhe gjeneralit Lüttwitz, për të nisur grushtin e tyre të shtetit.

Gjatë orëve të para të puçit në 13 mars 1920, fati i qeverisë legjitime varej në radhë të parë nga reagimi i liderëve ushtarakë të republikës. Shumica e oficerëve të ngarkuar për mbrojtjen e republikës nuk ishin të gatshëm që ta pengonin brigadën "Ehrhardt", që po shkonte drejt Berlinit, pasi, si-



Me Ministrin e Mbrojtjes Gustav Noske, në të majtë, dhe gjeneralin Wilhelm Groener, në të djathtë në Shwarzburg në fund të korrikut 1919, duke diskutuar për politikat ushtarake

kurse thanë ata vetë, trupat ishin të paaftë që të përballeshin me efektin emocional të të shtënit mbi shokët e tyre. Ata besonin tek slogani “Reichswehr nuk shtie kurrë mbi një Reichswehr”. Walter Reinhardt, komandant i përgjithshëm i ushtrisë dhe kryeoficeri ushtarak i Rajhut, ishte avokati i vetëm i përdorimit të forcës ndaj puçistëve.

Pasi u braktis prej forcave të armatosura, zgjedhja e vetme e qeverisë mbeti arratisja. Eberti, i shoqëruar nga disa prej ministrave të tij, shkoi nga Berlini në Dresden, kryeqyteti i Saksonisë. Trupat puçistë marshuan në zyrat qendrore të qeverisë vetëm disa minuta më pas. Në Dresden Eberti dhe qeveria hartuan kundërpërgjigjen e parë. Por shumë shpejt Saksonia u bë e rrezikshme për ta, ndaj e vazhduan udhëtimin drejt jugut të Gjermanisë derisa mbërritën në Shtuttgart në Württemberg. Sapo mbërriti aty, Eberti refuzoi që t'u bënte lëshime puçistëve: "Nuk ka negociata me Kappin dhe shokët e tij". Pas disa ditësh gjithçka mori fund. Mbi të gjitha, përpjekjen e puçit e rrëzoi greva e lëvizjes punëtore pasi "të gjitha ingranazhet u ndalën". Në momentin që qeveria e kishte lënë Berlinin, u bë thirrje për një grevë të përgjithshme, e cila u mbështet prej ministrave të SPD-së dhe prej vetë Ebertit. Në fund, greva e përgjithshme e uli grushtin e shtetit në gjuhë. Të ndërgjegjshëm plotësisht për suksesin e tyre, shumë ndjekës të SPD-së dhe të sindikatave kërkuan largimin e Gustav Noskes, ministrit të mbrojtjes (Reichswehrminister), të cilin ata e konsideronin përgjegjës për politikën e dështuara ushtarake të republikës. Eberti gjithsesi e mbrojt ministrin kontroversal socialdemokrat. Ai ishte i bindur se Noske ishte i vetmi person i aftë për ta mbajtur Reichswehri nën kontroll. Po ashtu, ai kishte firkë se SPD-ja do ta humbte ministrinë nëse Noske do të dorëhiqej. Gjithsesi Eberti u detyrua në fund që t'i përkulej presionit të radhëve të veta. Duke qenë se nuk kishte asnjë socialdemokrat për postin në fjalë, partia e humbi këtë bastion kyç. Eberti e kishte parashikuar saktë këtë, ashtu sikurse kishte parashikuar gjithashtu edhe humbjen e shanseve për ta kthyer Reichswehri në një instrument fuqie pro-republikan. Për solidaritet ndaj Noskes, edhe Reinhardti paraqiti dorëheqjen e vet përfundimtare. Eberti e liroi atë nga detyra, por i besoi të tjera funksione. Ajo që mbeti, sikurse i shkruante edhe Eberti Reinhardtit në 1921-

shin, ishte respekti reciprok: “Ka qenë një rrugë kaq e gjatë dhe e vështirë saqë kjo shoqëri do të ketë një lidhje të gjatë e të fortë”. Bashkëpunimi i ngushtë mes Ebertit dhe Reinhardtit kishte nisur që prej kohës së krizës në revolucion e sipër.

Dorëheqja e Noskes paralajmëroi edhe fundin e qeverisë së kancelarit Gustav Bauer (SPD). Pasuesi i tij do të ishte Herman Mülleri, drejtuesi i Partisë Social Demokrate. Ai qëndroi në detyrë deri në zgjedhjet e Rajhshtagut në qershor 1920. Sindikatat nuk ishin të kënaqura me ndryshimet e personelit. Ato e vazhduan grevën e përgjithshme edhe pas përfundimit të puçit Kapp-Lüttwitz, duke kërkuar reforma rrënjësore (edhe përtej sferës së politikave ushtarake) dhe pjesëmarrje në formimin e qeverisë së re. Eberti i refuzoi pretendimet e tyre duke theksuar se këto ishin jo-kushtetuese. Vetëm parlamenti i zgjedhur kishte të drejtën kushtetuese që të ndërmernte reforma, ky ishte standardi.

Fridrih Eberti vazhdonte t’i shihte partitë ekstremiste si një rrezik për republikën, sikurse shkruante ai në një letër drejtuar kryeministrit suedez Hjalmar Branting në prill 1920:

“Duhet ta mbrojmë republikën demokratike për të cilën kemi luftuar prej dekadash, jo vetëm prej së djathtës, por edhe prej së majtës. Kur luftojmë kundër grushteve të shtetit ushtarake dhe kundër puçeve komuniste ne jemi duke luftuar për sigurinë e republikës. Nuk përjashtohet mundësia që një ditë puçistët prej së majtës e prej së djathtës do të qëndrojnë përkundër nesh në një front të bashkuar [...] Mbi të gjitha, ne duhet të largojmë menjëherë oficerët reaksionarë nga ushtria. Kjo nuk është e lehtë po të mbajmë parasysh mungesën e dukshme të oficerëve republikane. Sidoqoftë duhet bërë. E njëjta procedurë duhet ndërmarrë edhe ndaj administratës. Edhe këtu, krahu i përshtatshëm i punës është në mungesë.”

Për ministrin e ri të mbrojtjes Otto Gesslerin (DDP), ruajtja e republikës nuk ishte shqetësimi kryesor. Ai e quante veten një “republikan racional” (*Vernunftrepublikaner*). Ai dhe gjenerali Hans von Seeckt, të cilin Eberti e kishte caktuar komandantin e përgjithshëm të ushtrisë, e mbajtën Reichswehri larg prej të gjitha partive politike dhe anasjelltas. Si rezultat Reichswehri u izolua prej republikës dhe ruajti distancën e vet politike prej rendit republikan. Presidenti nuk veproi mjaftueshëm për ta penguar këtë zhvillim.

Në prag të puçit, Eberti kishte për synim që të ndëshkonte dhe shkarkonte të gjithë anti-republikanët, që ende ishin në uniformë. Shumë oficerë ishin bashkuar me konspiratorët, ndërsa të tjerët hapur nuk e mbështesnin qeverinë legjitime dhe demokratike. Eberti punoi për përjashtimin e puçistëve dhe të ndjekësve të tyre nga Reichswehri, megjithëse prej insistimit të tij nuk erdhi asgjë sepse Rajhshtagu e amnistoi puçin me votë. U shkarkuan vetëm 172 oficerë, e midis tyre gjashtë gjeneralë. Nuk shkoi në burg asnjë anëtar i vetëm i Reichswehrit për pjesëmarrje në puç dhe ky ishte një vendim përfundimtar i parlamentit.

Ndryshimi i thellë strukturor dhe kontrolli më i ashpër demokratik mbi ushtrinë, sikurse kërkonin disa socialdemokratë vazhdimisht, nuk ishin në përputhje me politikën ushtarake të Ebertit. Ligji i fundit për ushtrinë në mars 1921 (*Wehrgesetz*) e neutralizoi politikisht ushtrinë. Për pasojë, Reichswehr nuk u bë dot një pjesë integrale e demokracisë, por u shndërrua në një shtet brenda shtetit. Ai mbeti një element i huaj dhe lidërshipi i tij e konsideronte veten të betuar vetëm ndaj shtetit abstrakt dhe jo domosdoshmërisht si një institucion i dedikuar ndaj demokracisë. Ky zhvillim do të kishte implikime të mëdha për të ardhmen.

Deri përpara puçit Kapp-Lüttwitz, si presidenti ashtu edhe qeveria e konsideronin të dukshme nevojën për ta thirrur Reichswehri në çdo rast kur duhej siguruar ligji

dhe rendi. Pas ngjarjeve të marsit 1920, forcat e armatosura u liruan nga kjo detyrë. Në mars 1921, ishte *Preußische Schutzpolizei* (Policia e Armatosur Prusiane e Shtetit) ajo që e shtypi revoltën komuniste në rajonin industrial të Gjermanisë Qendrore duke marrë kështu pagëzimin si ruajtësja e paqes në kohë krizash. Por në 1923-shin ushtria e rimori këtë funksion.

Viti 1923 solli me vete edhe krizën më të rëndë që prej revolucionit, duke nisur me pushtimin franko-belg të Rurit më 11 janar. Si kundërpërgjigje, qeveria gjermane bëri thirrje për “rezistencë pasive”, duke kërkuar që popullsia e zonës në fjalë të mos bashkëpunonte me pushtuesit. Sidoqoftë, refuzimi i punës i imponuar dhe i financuar nga qeveria, shkaktoi një inflacion astronomik. Gjatë kursit të krizës ekonomike dhe financiare, elementet ekstremiste si



Në kufirin e luginës së Rurit, të pushtuar nga Franca që prej janarit të 1923-shit, Eberti konfirmon solidaritetin ndaj republikës në takimin me përfaqësuesit e territorit të pushtuar në Hamm në mars 1923. Ai bën thirrje për unitet, duke shpallur edhe një herë moton e hershme të lëvizjes punëtore “Të gjithë për një, dhe një për të gjithë”.)

në falangat e majta ashtu edhe në ato të djathta të spektrit politik, lulëzuan sikurse ndodhi me komunistët në të majtë dhe me nacionalsocialistët dhe grupet e tjera nacionaliste gjermane në të djathtë. U zhvilluan edhe dy konflikte të mëtejshme, të cilat e rrezikuan unitetin kombëtar.

Së pari, mosmarrëveshjet mes Rajhut dhe qeverisë bavareze po rriteshin. Së dyti, socialdemokratët e Gjermanisë qendrore hynë në koalicione në Saksoni dhe Turingi me anti-demokratët e KPD-së. Për më tepër, e djathta politike po përvijonte rrugën drejt instalimit të një diktature. Brenda dymbëdhjetë muajve e provuan fatin jo më pak se pesë qeveri të ndryshme. Në vjeshtën e 1923-shit, rënia e Republikës së Vajmarit dukej e sigurtë. Megjithatë, si për mrekulli, shteti i ri do të mbijetonte.

Ky vit krize nisi me qeverinë Cuno, e cila rezultoi të ishte e paaftë për ta marrë në dorë situatën. Për një kohë të gjatë Eberti e mbështeti kancelarin “e tij”, i cili megjithatë u dorëhoq përballë opozitës që rritej. Menjëherë pasoi krijimi i Koalicionit të Gjerë i përbërë prej DVP-së, DDP-së, Partisë së Qendrës dhe SPD-së dhe që në krye do të kishte Gustav Stresemannin, liderin e liberalëve të djathtë të DVP-së. E mbështetur fort prej Ebertit kjo qeveri mundi të kalonte krizën ekzistenciale kombëtare. Së pari, kabineti e pezulloi politikën e vet të rezistencës pasive në Rur, që e kishte rrënuar vendin financiarisht. Eberti e mbështeti grevën e përgjithshme të financuar nga shteti deri në fundin e hidhur, por pastaj edhe atij iu desh që të pranonte se nuk mund të vazhdonin të ecnin në atë rrugë. Fundi i rezistencës pasive ishte parakushti për rregullimin e monedhës, gjë që u arrit më në fund prej prezantimit të të ashtuquajturës Rentenmark. Si rezultat, inflacioni mund të përkulej dhe në këtë sfond mund të riniste konsolidimi i ekonomisë. Në mënyrë që të kontrollohej kriza, presidenti ishte i përgatitur që të lëshonte fuqi dekretuese për

kancelarin e ri Stresemann në përputhje me nenin e diskutueshëm 48 të kushtetutës, sikurse kishte bërë më parë edhe me Cunon.

Gjatë mandatit të tij, Eberti nënshkroi 136 rregullore mbi bazën e nenit 48 të kushtetutës. Fillimisht presidenti e përdori këtë të drejtë ekskluzivisht për të rivendosur qetësinë dhe rendin sipas besimit të tij politik. Ky kurs veprimi ishte në përputhje me Kushtetutën e Vajmarit. Duke përdorur nenin 48 për të justifikuar dekretet e emergjencës në mënyrë që të shmangej një situatë dramatike e krizës ekonomike dhe financiare, kushtetuta u tendos në limite, duke sjellë një precedent thellësisht të dyshueshëm në aspektin e ligjit kushtetues. Si qeveria ashtu edhe presidenti ishin të bindur se problemet therëse do të mund t'i kalonin duke përdorur nenin 48. Rrjedha e veprimeve të Ebertit udhëhiqej prej shqetësimit të tij për të stabilizuar republikën e trazuar, ndërkohë që njëkohësisht duhej ruajtur dhe përfaqësuar pavarësia dhe të drejtat e Rajhshtagut. Në krahun tjetër, Paul von Hindenburgu, pasuesi i tij në krye të shtetit dhe dikur gjeneral perandorak i ushtrisë, ishte i përgatitur që t'i përdorte fuqitë dhe hapësirat që i ofronte neni 48 të kombinuara me fuqi të mëtejshme presidenciale kundër Rajhshtagut, që do të thotë kundër republikës. Ruajtja e rendit parlamentar ishte gjithmonë prioriteti kryesor i Ebertit.

Ai e kiste deklaruar këmbënguljen e tij për të mbrojtur republikën prej armiqve të saj në një fjalim të mbajtur pas zgjedhjes së tij si president i Rajhut, përpara Asamblesë Kombëtare në janar 1919:

“Liria dhe ligji janë binjakë. Liria mund të marrë formë vetëm brenda një rendi të vendosur shtetëror. Mbrojtja dhe rivendosja e këtij rendi kudo që ai është dhunuar duhet të jetë prioriteti më i madh për të gjithë ata që e duan lirinë. Ne do ta luftojmë tiraninë, qoftë nëse

vjen kjo prej së majtës, apo qoftë prej së djathtës, me të gjitha mënyrat që do të mundemi.”

Sidoqoftë, metodat e Ebertit provokuan kundërshti, së pari në vjeshtë të 1923-shit edhe prej radhëve të vet socialdemokratëve. Shumica e kritikave u përqendruan tek fakti që Eberti i kishte lejuar kancelarit Stresemann që në tetor ta zhbënte qeverinë lokale saksone të përbërë prej socialdemokratëve dhe komunistëve, që kishin refuzuar të betoheshin për aleancë ndaj Rajhut. KPD-ja saksone në qeverinë lokale ishte duke marrë vrull për një konflikt të hapur me republikën. Stresemanni kishte për qëllim që ta shpallte hapur konfliktin me Saksoninë, që ishte zvarritur për muaj me radhë, ndaj paraprakisht ai i shfuqizoi ministrat lokalë socialdemokratë. Ky proces shkaktoi qasje të hidhura nga ana e socialdemokratëve, që nuk i drejttoheshin vetëm Stresemannit, por edhe presidentit. Sikurse tha edhe një anëtar i Rajhshtagut: “Për mendimin tim Eberti ka marrë fund. Si mund ta firmosë ai një ligj si ky?”.

Për zhgënjim të Ebertit, socialdemokratët, të inatosur për rrjedhën e nxituar dhe ndoshta të shmangshme të veprimeve ndaj Saksonisë, e braktisën “Koalicionin e Gjerë”. Kështu, koalicioni qeverisës, i dëshiruar prej Ebertit, mori fund vetëm pas pak muajsh. Në sytë e tij, partia kishte bërë një gabim trashanik me braktisjen e pushtetit politik. Ky gjykim rezultoi i saktë. SPD-ja do t’i kalonte pesë vitet e ardhshme në opozitë. Në vizionin e Ebertit, qeverisja me një koalicion, edhe nëse sillte si nevojë negocimin me një parti partnere, ishte gjithnjë më mirë sesa të liheshe plotësisht jashtë pushtetit si një parti opozitare. Në krahun tjetër, Eberti e nënvlerësoi faktin se sa shumë presion do të kishte pasur SPD-ja nëse do të kishte hyrë në një koalicion me DVP-në, e cila kishte si synim që të zhbënte të gjitha arritjet e revolucionit sikurse ishte përshebull dita tetë orarëshe e punës.

Socialdemokratët nuk e kuptonin se pse nuk u bë asgjë për të penguar makinacionet anti-republikane të ndërmarra përnjëherë prej ekstremistëve të djathtë në Bavari. Megjithëse Eberti kishte bërë thirrje për veprim në Mynih, liderët e Reichswehrut refuzuan që t'ia jepnin atij besnikërinë e tyre. Derisa Adolf Hitleri realizoi pa sukses një puç në Mynih më 9 nëntor 1923, dhe urdhëroi ndjekësit e tij që të marshonin drejt Berlinit, nuk u bë dot asnjë ndërhyrje tjetër.

Në atë kohë, Eberti emëroi Hans von Seeckt-in si komandant të përgjithshëm të ushtrisë dhe si mbajtës të autoritetit ekzekutiv, duke i garantuar atij efektivisht fuqi gati diktatoriale. Kjo ishte një lëvizje me rrezik, duke qenë se gjenerali po flirtonte me një diktaturë të përkohshme. Sidoqoftë Seeckt-i nuk arriti që ta bënte të frytshëm planin e tij, edhe pasi kancelari Stresemann u detyrua që të dorëhiqej si pasojë e një vote mosbesimi në Rajhshtag. SPD-ja e mbështeti këtë votë mosbesimi edhe pse Eberti u përpoq deri në fund që ta pengonte rënien e kancelarit. Kështu që ai i qortoi shokët e vet të partisë: “Arsyeja që ju çoi drejt rrëzimit të kancelarit do të harrohet për gjashtë muaj, por pasojat e budallëkut tuaj do të ndihen ende edhe dhjetë vite nga tani!”.

Falë presidentit, largimi i Stresemannit nuk çoi në diktaturën e gjeneralit Seeckt, sikurse prisnin shumë. Paçka fuqisë gati diktatoriale të autoritetit ekzekutiv të gjeneralit, ai varej prej Ebertit, i cili mençurisht e detyroi Seecktin që t'i qendronte besnik presidencës, duke i treguar vendin kësaj diktatorit të mundshëm sapo ai kërcënoi se do të përdorte pozitën e qeverisë për të zgjeruar fuqinë e tij. Në konfliktin midis Seecktit dhe ministrave, Eberti mbështeti gjithmonë kabinetin e ri të kancelarit Wilhelm Marks të Partisë së Qendrës. Pasi një përplasje fuqie mes Ebertit dhe Seeckt-it, pasi ky i fundit refuzoi që të përmbushte

disa kërkesa të presidentit. Përfundimisht këtë konflikt e fitoi presidenti.

Në 13 janar 1924, kur gjenerali i bëri thirrje Ebertit që ta hiqte gjendjen e emergjencës, veprimi i tij ishte ndikuar më shumë prej dorëheqjes së politikanëve opozitarë sesa besimi se kishte ardhur koha për t'u kthyer në normalitet politik. Gjendja e emergjencës kishte qenë një mjet efektiv për të tejkaluar krizën kombëtare dhe ndihmoi në shtrimin e rrugës së kthimit drejt normalitetit kushtetues. Përgjegjësit, e mbi të gjitha presidenti, ia dolën që të përkulnin ambicjet e gjera të Reichswehrut. Eberti kishte dalë fitues prej përplasjes për pushtet me Seecktin duke zhbërë përpjekjet e gjeneralit për të fituar më shumë fuqi. Përlulja e Reichswehrut vërtetoi një prej parakushteve për procesin e stabilizimit relativ të brendshëm duke filluar në vitin 1924. Republika e kaloi krizën, fillimisht falë veprimeve të vendosura të presidentit të Rajhut.

5. Përfaqësues i republikës

Eberti ia doli që ta shpëtonte Rajhun, që *qëndronte në* skaj të humnerës, vetëm duke i përdorur të gjitha pushtetet e veta. Në rrjedhën e këtyre ngjarjeve, tëhuajsimi i tij prej partisë së vet arriti kulmin. Megjithëse presidenti dhe lideri i socialdemokrat mbajtën kontakt të vazhdueshëm, Eberti nuk u dha ndonjëherë llogari për politikën e veta funksionarëve apo komiteteve socialdemokrate dhe nuk kërkoi ndonjëherë mirëkuptimin e tyre për situatën e tij të vështirë në përballje me çështje të ndryshme kushtetuese. Presidenti i Rajhut nuk ishte më një politikan partie, ai nuk e kishte parë më veten si të tillë që prej shkurtit 1919. Eberti e konsideronte veten si “presidentin e çdo gjermani”. Situata mes tij dhe pjesës tjetër të SPD-së nuk u përmirësua pasi anëtarë të socialdemokratëve të pavarur u rikthyen tek partia e

tyre origjinale, duke dëshmuar dorëzimin e USPD-së tek KPD-ja. Eberti kishte dëshiruar gjithmonë për ribashkimin e partive socialdemokrate. Sidoqoftë, kur kjo u bë realitet në vjeshtën e 1922-shit, ai nuk kishte më marrëdhënie me lidhshpirtin e partisë. SPD-ja po ndryshonte. Asokohe ajo nuk ishte më partia që kishte qenë në 1919-ën, kur Eberti kishte marrë postin e presidentit të Rajhut. Influenca e tij në SPD-në e ribashkuar, ra. Kështu, u godit edhe politika e tij në mbështetje të një koalicioni të gjerë. Në qershor 1923, Eberti i shkroi një shoku partie se ribashkimi i SPD-së “i peshoi shumë rëndë shpatullave të partisë”. Ky ishte edhe një përkrahim i saktë i ndjenjave të tij të paqeta të shkaktuar prej ribashkimit të socialdemokratëve që prej ndarjes së tyre në 1917-ën.

Me kalimin e kohës, ndarja me partinë u rrit. Prej momentit kur SPD-ja e la Koalicionin e Gjerë në vjeshtën e 1923-shit, menjëherë nisi përçarja për shkak të pozicionit kushtetues të presidentit të Rajhut dhe konceptit të Ebertit se zyra duhej përdorur në mënyrë jopartizane. Në konventën e partisë në 1924-ën, disa anëtarë të organizatave bazë të partisë parashtruan për votim përjashtimin e ish-liderit të partisë, Fridrih Ebert, prej radhëve të tyre duke qenë se ai kishte pranuar që ta impononte Urdhërin Ekzekutiv (*Reichsexekution*) të qeverisë qendrore mbi Saksoninë dhe qeverinë lokale saksone. Lidhshpirti i SPD-së e mbështeti Ebertin me gjithë zemër duke mos e lejuar fare hedhjen e mocionit të mosbesimit për votim. Sidoqoftë, kjo ngjarje nuk mund ta fshihte skizmën mes presidentit dhe Partisë Socialdemokrate. Sindikata e shalëpunuesve, e përjashtoi ndërkohë Ebertin pas dekadave të tëra anëtarësie.

Kjo sigurisht që e goditi Ebertin shumë fort. Në kontrast me diferencat mes tij dhe partisë, diferenca që e preknin herë pas here personalisht, partitë borgjeze e shihnin atë gjithnjë e më shumë respekt. Mënyra e Ebertit për dre-

jtimin e zyrës së tij ishte “promovimi i republikës”, sikurse e përcaktoi në tetor 1922 romancieri dhe më pas laureati Nobel, Thomas Mann:

“Ebertin, për shembull, e njoh. Një burrë shumë simpatik që zotëron si dinjitet ashtu edhe modesti dhe jo më pak humor; i matur, njerëzor, i dedikuar. E kam parë disa herë të shfaqet miqësisht dhe të prezantojë detyrat e zyrës së tij nëpër ceremoni; ai vjen me pallton e tij ceremoniale, me pamjen e një fatbardhi, i talentuar, një qytetar mes qytetarëve [...]. Kam përshtypje dhe dua ta ndaj me ju, që është e mundur që demokracia të jetë më gjermane, sesa opera e madhe perandorake”.

Mund të hamendësojmë se romancieri i madh gjerman ishte përfaqësues i kampit demokratik dhe borgjez në vlerësimin e tij për presidentin socialdemokrat të Rajhut. Mes presidentit të Rajhut dhe poetit laureat të republikës Gerhart Hauptmannit, i cili ishte fitues i Çmimit Nobel për letërsinë në 1912-ën, u zhvillua një marrëdhënie respekti të ndërsjellë dhe mirënjohjeje. Që të dy e vlerësonin njëri – tjetrin. Eberti e kishte fituar këtë respekt prej administratës së tij jopartizane dhe për përpjekjet e tij për t’i tejkaluar barrierat politike. Kjo ishte një e vërtetë që ndahej si bindje prej shumë njerëzve, dhe sidomos prej gjithë rangut borgjez.

Konservatorët dhe monarkistët, nga ana tjetër, e shihnin atë si asgjë më shumë sesa një shalëpunues, i cili kishte humbur rrugën dhe kishte përfunduar gabimisht në fron. Ata kultivuan snobizmin ndaj zanatçiu, i cili kishte fituar zyrën më të lartë publike në vend si përfaqësues i socialdemokracisë së përjashtuar gjatë Kajserrajhut. Intelektualët e majtë, si Kurt Tucholsky, e kritikonin Ebertin me sarkazëm si një burokrat dhe firmëtar (“*Papiermensch*”) pa gjak në fytyrë. Sipas autorit të majtë Maximilian Harden, “Friderico Ebert” ishte një borgjez patetik (“*armseliger*”).



Fridrih Eberti dhe Gerhart Hauptmanni

Spießbürger”), një revolucionar vetëm me fjalë (“*Mundrevolutionär*”) dhe i keqarsimuari shalëpunues i Rajhut (“*Reichssattler*”) me një kalibër të pamjaftueshëm intelektual, një “socialdemokrat mediokër”, “bir rrobaqepësi, shalëpunues endacak, pijanec, gazetaruc, sekretar partied dhe arkëtar”, i paaftë e i pavlefshëm për të mbajtur zyrën më të lartë publike. Këto shigjeta të helmatosura në mënyrë brilante ishin drejtuar kah kreu i shtetit, por ato gjithashtu synonin republikën dhe e përçmonin demokracinë e re të

Vajmarit duke dëmtuar reputacionin e saj. Georg Grosz, artist i mirënjohur e me lidhje të forta me partinë komuniste, e portretizonte Fridrih Ebertin ashtu sikurse e shihte presidentin e Rajhut e majta radikale: një zagat të gjorë të manjatit industrialist Hugo Stinnes. Groszi e përshkruante Ebertin si “tradhëtar të punëtorëve” dhe si një instrument të industrisë së madhe, një imazh i përhapur gjerë tek komunistët që prej ndryshimeve politike të nëntorit 1918.

Sidoqoftë, president i Rajhut ishte i paprekur prej akuza-ve dhe kritikave të tilla dhe vazhdoi të promovonte demokracinë. Koncepti i tij për shoqërinë bazohej tek ideja për një komunitet kombëtar. Të kuptuarit e tij për këtë komunitet nuk ishin asesi të ngjashme me atë autoritarist, përjashto konceptin e turbullt të “*Volksgemeinschaft*” që më pas u propagandua prej nacionalsocialistëve. Në kontrast të dukshëm me konceptin nacionalsocialist të racës kombëtare, koncepti i Fridrih Ebertit për komunitetin e popullit, për të cilin ai fliste vazhdimisht, bazohej në barazinë, lirinë dhe unitetin politik. Në tetor 1922 ai shkroi se kishte ndërmend që të “balancoje diferencat dhe të forcoje ndjenjën e bashkësisë të të gjitha shtresave sociale të atdheut”. Në 1919-ën, ai kishte paralajmëruar në letrën e Pashkëve që i drejtohej Asamblesë Kombëtare: “Mos u bëni vetëshkatërrues”. Thirrje të tilla ishin tipike për Ebertin gjatë kohës së tij në detyrë.

Eberti vazhdonte ta ndiqte maksimumin e tij të unitetit duke punuar për një bashkëpunim harmonik mes Rajhut dhe shteteve të mëvetshme. Në javët që pasuan revolucionin e nëntorit, Eberti bëri të pamundurën për të shmangur çdo diskutim mbi riorganizimin e shteteve të mëvetshme gjermane të madhësive të ndryshme. Mbi të gjitha, likujdimi dhe riorganizimi i disa shteteve përbërëse më të vogla (Kleinstaaten) dhe thyerja e dominancës shtypëse të Prusisë brenda Rajhut, po merrej në konsideratë, por jo prej Ebertit. Ai nuk ishte i

përgatitur për t'i bërë ballë rrezikut, ndaj edhe çështja territoriale mbeti e pazgjidhur. Sidoqoftë, ai i futi shtetet përbërëse në debatin për riorganizimin.

Gjatë tranzicionit nga Kajserrajhu drejt Republikës së Vajmarit, Eberti u kthye nga centrist në një federalist racional. Gjatë punimeve të qeverisë së revolucionit mbi shkrimin e kushtetutës më 14 janar 1919, kolegu i Ebertit, Otto Landsberg, favorizoi me entuziasëm shtetin qendërues. Eberti iu përgjigj se ruajtja e unitetit të Rajhut ishte e mundur vetëm mbi baza federale, duke pasur parasysh kundërshtinë e pritshme prej shteteve të jugut ndaj një shteti të qendëruar. Kur drafti original i kushtetutës, i shkruar nga sekretari i brendshëm liberal i shtetit Hugo Preuß-i, u përball me kritikën e shteteve të mëvetshme për shkak të tendencave qendëruese, Eberti e qartësoi ujin e turbullt duke i siguruar kritikët se “një Rajh i bashkuar është i mundur vetëm mbi bazën e një shteti federal”, dhe se qeveria qendrore nuk kishte as qëllimin më të vogël që të “dhunonte shtetet federale”. Eberti gjithsesi paralajmëroi që ata të mos kërkonin shtrirje të mëtejshme të drejtave të tyre shtetërore. Në hapjen e Asamblesë Kombëtare në 6 shkurt 1919, ai e dënoi theksimin e tepruar të interesave specifike të shteteve të mëvetshme. Gjermania nuk duhet të binte viktimë e “mjerimit të copëzimit dhe shtrëngimit edhe një herë tjetër”.

Si kre shteti, Eberti gjithsesi e pa veten gjithmonë si avokatin e shteteve të mëvetshme. Në udhëtimin e tij të parë nëpër Gjermani, ai mori rrugën drejt jugut në shtator 1919. Kjo kishte kuptim për dy arsye kyçe. Së pari, sepse sipas kushtetutës së re të Rajhut, Bavaria, *Württembergu dhe Saksonia* do t'i humbnin kontigjentet e veta ushtarake autonome, që do të përfshiheshin brenda Reichswehrit të ardhshëm. Për më tepër, kundërshtitë ndaj një qeverie të qendëruar në Berlin ishin më të forta në jug, ku ishte dhe shtëpia e federalistëve të thekur, që i

shihnin shtetet e tyre të mbërthyer në një morskë qendëruese të republikës së re. Kësisoj, Eberti u përball me kritikë të ashpër për kushtetutën e adoptuar së fundmi, teksa ai realizonte turin e parë si president i Rajhut. Ai kërkoi mirëkuptim për shkak të situatës katastrofike me të cilën po përballlej Gjermania për shkak të luftës dhe parashtrroi nevojën për transferimin e disa të drejtave, që tradicionalisht i zotëronin shtetet e mëvetshme, tek autoriteti i Rajhut:

“Ruajtja e identiteteve të tribuve gjermane dhe e jetës së pavarur politike të shteteve të mëvetshme, bashkimi i Rajhut dhe mbrojtja e karakteristikave të këtyre tribuve gjermane, janë qartësisht të përputhshme.”

Këto fjalë që u thanë në një mënyrë bashkëkohore, duke përdorur “tribu” dhe “karakteristika triubsh”, tregojnë për një kuptim të thellë të shqetësimeve të shteteve të mëvetshme. Megjithëse Eberti e theksoi kohë pas kohe se ai ishte një “gjerman jugor me gjithë zemrën e tij” dhe solidarizohej me kokëfortët e tij jugorë, vizita nuk qe aspak e lehtë. Retorika e Ebertit e theksimit të jetës politike të shteteve të mëvetshme dhe të rëndësisë së forcimit të Rajhut në të njëjtën kohë nuk ishte një veprim balancues. Sipas tij, republika e re duhet të shmangte çdo “copëtim dëmtues për hir të të mirës më të madhe”.

“Diversitet brenda unitetit”, ky ishte mesazhi i tij. Që me udhëtimin e tij të parë, ndryshe nga ç’ pritej prej një socialdemokrati që punonte në Berlin, Eberti nuk u shpall si përfaqësuesi i një shteti të qendëruar. Ai e prezantoi veten si një kre shteti në kërkim të kompromisit, duke i siguruar shtetet e mëvetshme se qeveria e Rajhut nuk kishte asnjë synim që t’ua hiqte identitetin kulturor rajonal apo sovranitetin e tyre politik.

Në udhëtimin e vet të parë përmes shteteve të jugut, që nuk u pasua prej një udhëtimi të dytë në pjesën tjetër të Gjer-



Kreu i shtetit me një grup fëmijësh në Berlin duke festuar prritjen e një grupi kujdestarësh amerikanë për fëmijë, në Pallatin Presidential në qershor 1924

manisë, Eberti u soll dukshëm i rezervuar në shfaqjet e veta në publik. Dukej sikur ai i nënvlerësoi edhe fuqinë e shpërfaqjes në publik, edhe shansin e mirëofruar për marrëdhënie me publikun. Në terma të politikës simbolike, kreu republikan i shtetit nuk mund të ndiqte hapat e Hohenzollernit të fundit. Eberti as donte, dhe as mund ta përballonte ngjashmërinë e dobët me Kajzerin. Shfaqjet e kaparditura në publik të Perandorit Vilhelm II nuk mund të shërbenin si një shembull për kreun demokratik të shtetit. Stili i përfaqësimit të Ebertit nuk kishte as pompozitetin dhe as rrethanat e paraardhësit të tij, që ende konsiderohej një praktikë standarde prej publikut të ish Perandorisë Gjermane.

Duke shmangur kultin e individit, Eberti u përpoq të mishëronte konceptin e republikës në ndërgjegjen publike. Ai ishte një përfaqësues i rezervuar i rendit të ri shtetëror. Personi publik i Ebertit si president nuk ishte një pasqyrë e personalitetit të tij midis miqve, ku ai shfaqej impulsiv, me humor dhe sarkazëm. Presidenti Fridrih Ebert nuk ishte më funksionari socialdemokrat me elokuencë të fuqishme

i kohës së para-luftës, që mund t'i magjepste mbështetësit e vet, ndonëse karrierën e tij brenda lëvizjes punëtore ia kishte borxh pikërisht talentit të tij si folës publik. Gjithsesi, si president, ai u shfaq si një kre shteti i ftohtë dhe shumë funksional, një shtetar i qartë dhe i kthjellët. Ai e kreu detyrën e vet pa pretencë dhe patos, pa përdorimin oportunist të fjalimeve bombastike apo veprimeve simbolike, por të fuqishme emocionalisht.

Eberti nuk ishte një regjent i mirënjohur me uniformë, të cilin subjektet e veta mund ta takonin personalisht të paktën një herë gjatë jetës së tyre. Ai përfaqësonte republikën e re borgjeze që po rritej. Entuziasmi i tepruar, shfaqja si njeri i popullit dhe bashkimi me turmën nuk ishin në natyrën e tij, ato ishin larg nga koncepti i tij politik. Ebertit i mungonte aureola. Përgjatë kohës, ai i kishte gjithnjë e më të rralla shfaqjet publike. Shpërfaqja e tij e sertë dhe e rezervuar formësoi imazhin publik të kreut të shtetit.

Qytetarët e Republikës së Vajmarit nuk e shihnin kreun e tyre të shtetit shumë shpesh. Me po të njëjtin rezervim dhe tërheqje gati të pakuptueshme, Eberti nuk zgjodhi as ndonjë mjet tjetër për marrëdhëniet me publikun. Ai nuk kishte ndonjë fotograf apo korrespondent personal që ta portretizonte atë në mënyrë që ta popullarizonte personin e tij. Nuk u bë mjaftueshëm punë për ta formësuar imazhin e presidentit në publik, përmes fotografive dhe artikujve. Revistat e ilustruara më së pari publikuan disa portrete të tij të plota ose bust, megjithëse presidenti nuk dukej asnjëherë i veshur zakonshëm apo thjeshtë.

Eberti nuk ishte ai lloj politikani që dëshironte të ishte prezent vazhdimisht në masmedia. Ai dhe stafi i tij i vogël i këshilltarëve në pallatin presidencial, nuk e shfrytëzonin mundësinë e ofruar prej përdorimit të gjerë të masmedias për të ndihmuar rritjen e popullaritetit të kreut të shtetit. Prandaj ka shumë pak regjistrime filmike të Ebertit që për-

bëhen prej thujse vetëm disa sekucencave dy minutëshe secila. Kaq. Vetëm pasi kaloi shumë kohë, por tashmë pa dobi, Eberti dhe stafi i tij më në fund nisën një fushatë për marrëdhëniet me publikun. Kjo shpjegon edhe se pse u bë kaq e famshme dhe e “suksesshme” fotografia ku ai dhe ministri i tij i mbrojtjes Gustav Noske shfaqen duke u lagur në Detin Baltik.



Fridrih Eberti, i dyti nga e djathta, me ministrin e mbrojtjes Gustav Noske, i treti nga e djathta, dhe miq të tjerë duke notuar në Detin Baltik në 1919-ën. Eberti e mbante fotografinë me vete deri në fund të ditëve të tij. Kundërshtarët e demokracisë në Gjermani e përdorën fotografinë për të zhvlerësuar Ebertin personalisht, por edhe republikën.

Fotografia pati impakt të madh. Publiku, i mësuar vetëm me pompozitetin e Gjermanisë perandorake, iu përgjigj fotografisë me habi të papritur. Autori Joseph Roth, me të drejtë deklaroi në 1923-shin se fotografia u bë “argumenti më i fortë kundër republikës pasi ishte edhe shfaqja më plebenje”. Anti-republikanët nga e djathta në të majtë e publikuan fotografinë në variante të ndryshme dhe me një mal karikaturash, duke mos marrë për këto sulme ndonjë përgjigje në media.

Pavarësisht shpërfaqjeve tendencioze, kreu i shtetit shpesh merrte iniciativën vetjake për të krijuar

ndërgjegjësimit tek i gjithë populli gjerman për republikën dhe për të promovuar identifikimin me demokracinë e re, me qëllim ndërtimin e një themeli intelektual të bazuar tek traditat demokratike. Qëllimi i Ebertit ishte të gjente pika referimi në historinë gjermane për t'i përdorur ato si një busull dhe për të krijuar simbole me të cilat të mund të identifikoheshin si shtresat shoqërore, ashtu edhe partitë politike. Që në hapjen e Asamblesë Kombëtare, Eberti i ishte referuar “shpirtit të Vajmarit”, shpirtit të poetëve të mëdhenj si Gëte dhe Shiler, si shembull për republikën, duke përafuar edhe traditat e revolucioneve të viteve 1848 dhe 1918:

“Këtu në Vajmar ne duhet të përmbushim tranzicionin prej imperializmit në idealizëm, nga një fuqi botërore në një gjigand intelektual [...] Tani, shpirti i Vajmarit, shpirti i filozofëve dhe poetëve tanë të mëdhenj, duhet të na mbarsë edhe një herë”.

Eberti i mbështeti me vendosmëri festimet e 75 vjetorit të parlamentit të parë gjerman të 1848-ës (*Paulskirchenversammlung*), të cilat u mbajtën në Frankfurt në vitin 1923. Në qytetin hesian të Römerberg-ut, ku u mbledhën për të festuar për republikën dhjetëra mijëra, Eberti përjetoi atë lloj shoqërie të njerëzve të lirë, që jetojnë në harmoni me njëri – tjetrin, përtej klasave, komunitetin republikan të popullit që ai e kishte pritur të vinte që prej fillimit, unitetin në shërbim të demokracisë - kjo ngjarje krijoi një ndjesi hareje që ishte shumë e rrallë për udhëtimet dhe shfaqjet e tij në publik.

Në Ditën e Kushtetutës 1922, Eberti e shpalli “Këngën e Gjermanëve” (*Das Lied der Deutschen*), të shkruar më 1841-shin nga Hoffmann von Fallersleben, si himn kombëtar. Ai e theksoi vargun e tretë në veçanti për shkak se “unitet dhe drejtësi dhe liri” ishin tingulli më i bukur. Në

vitet që pasuan dhe më vonë pas 1945-ës, u diskutua nëse ky varg i vetëm duhet të bëhej himni kombëtar, sikurse është në ditët e sotme. Në vazhdim të kësaj, Eberti mbësh-teste idenë për të zyrtarizuar një festë publike për nder të kushtetutës në 11 gusht, ditën që u firmos prej tij në resortin e pushimeve të qytetit Schwarzburg, në Turingi, në jug të Vajmarit më 1919-ën. Në këtë ditë, republikanët duhet të tregonin ngjyrat e tyre. Sidoqoftë, duke mbajtur ndër mend larminë brenda shoqërisë gjermane, e cila ishte e ndarë në shumë grupe kulturore dhe sociale, një pjesë e të cilave e kundërshtonin republikën, kjo nuk ngjallte ndjesinë e synuar gjithpërfshirëse. Dita e kushtetutës, si një zëvendësuese e një dite themelimi kombëtar, nuk u bë ndonjëherë një festë publike popullore që tërhiqte të gjitha klasat dhe sektorët e shoqërisë. Shumë njerëz preferonin t'i qëndronin larg kësaj ngjarjeje dhe kështu tregonin hapur distancimin e tyre prej republikës. Demokracia nuk ishte për të gjithë gjermanët sistemi politik i qeverisjes ideale.

6. Viktimë e përdhosjes së figurës

Duke përdorur veprimet simbolike, presidenti i Rajhut synonte që të krijonte vlerat e traditës, që do të promovonin një rend të ri politik. Dikush mund të hamendësojë me të drejtë se Eberti pati sukses tek njerëzit që kishin mendime të pavendosura ndaj demokracisë. Ai gjithsesi nuk mbërriti dot deri tek komunistët, të cilët ëndërronin për revolucionin botëror dhe punonin për diktaturën e proletariatit. Edhe monarkistët anti-republikanë, të cilët kishin ndjenja të forta dhe të vendosura kundër demokracisë së re, ishin gjithashtu imunë ndaj përpjekjeve të Ebertit. Për ta, republika nuk ishte asgjë tjetër veçse një sistem i neveritshëm i “kriminelëve të nëntorit”, dhe krijesë e armiqve të dikurshëm të Rajhut. Si kreu i shtetit dhe si përfaqësues i republikës më

shumë sesa cilido politikan tjetër, Eberti ishte rrufepritësi i të gjithë anti-demokratëve. E majta radikale e cilësonte atë si tradhëtar të punëtorisë pasi ai e kishte kundërshtuar themelimin e një republike të stilit sovjetik dhe kishte krijuar kësisoj një aleancë me elitat e vjetra gjatë revolucionit, në mënyrë që të shtypte lëvizjen punëtore. Nga ana tjetër, e djathta radikale, në kuadër të urrejtjen së tyre të verbër ndaj republikës, nisën një fushatë të pabesueshme përdhosjeje ndaj imazhit të presidentit të Rajhut.

Spekulimet ndaj kreut të shtetit u bënë të pranueshme shoqërisht. Kultura politike mori një kthesë të fortë gjithnjë e më shumë drejt vulgares. Shtypi radikal shkroi akuza të jashtëzakonshme ndaj Ebertit. Anti-demokratët hodhën tallje mbi figurën e tij me fjalë dhe imazhe, duke iu referuar trajektorese së tij nga Pfaffengasse në Heidelberg e drejt Wilhelmstraße në Berlin (rezidenca qeveritare në kryeqytet), nga një shalëpunues endacak dhe pronar pijetoreje në Bremen, në president të Rajhut. Thashetheme dhe zëra për korrupsion, mbipasarim, alkolizim dhe sjellje imorale, qarulluan gjithandej. Fushata për përdhosjen e figurës nuk kurseu as gruan e tij Louise, e cila u bë gjithashtu një viktimë e gjerë e talljeve të herë pas hershme.

Në fillim Eberti nuk u kushtoi fare rëndësi këtyre sulmeve. Pasi Ministri i dikurshëm i Financave Matthias Erberger (1921) dhe Ministri i Jashtëm Walther Rathenau (1922) u vranë prej ekstremistëve të djathtë, ai nisi të padiste autorëe e këtyre ofendimeve. Pas vrasjes së Rathenaut, ai i shkroi Gerhart Hauptmannit:

“E shoh këtë veprim të tmerrshëm me një shqetësim të thellë [...] është një konsideratë e hidhur se pabesi të tilla na kthejnë në monopatin me gjemba dhe shkurre që e kishim parashikuar me anë të reflektimit të qetë dhe mendimeve të qarta [...] Sidoqoftë, ne duhet të mbahemi fort deri sa ta kalojmë këtë dhe të punojmë për rikuperimin

dhe lehtësimin e popullit tonë”.

Ligji u bë mjete i tij më i shpeshtë për t’u përballur me armiqtë e republikës. Ai nisi më shumë se 200 procese gjyqësore. Sidoqoftë, paditë ndaj shpifjeve nuk rezultuan një instrument efikas në luftën për reputacionin e republikës dhe kundër gjuetisë sistematike të shtrigave.

Duke e akuzuar Ebertin për tradhëti, anti-demokratët vazhduan me mitin e tyre të “goditjes pas shpine” (Dolchstoßlegende), që në mënyrë të vazhdueshme e helmoi atmosferën politike të Republikës së Vajmarit. Ata e akuzuan lëvizjen e organizuar punëtore se kishte goditur pas shpine trupat e guximshme gjermane dhe se i kishin shkaktuar Gjermanisë humbjen përmes veprimeve të tyre revolucionare në shtëpi, gjatë kohës kur ata kishin qenë në front. Monarkistët reaksionarë, të cilët e urrenin republikën, ishin më se të lumtur që t’i instrumentalizonin akuzat e tyre. Përmes këtyre mjeteve, liderët politikë dhe ushtarakë të Kajserrajhut mund të zhvisheshin prej përgjegjësisë së humbjes së Gjermanisë dhe pasojave të kësaj humbjeje, para së gjithash, për Traktatin e Versajës, që shihej si një turpërim kombëtare. Ishte një mundësi e mirë për ta portretizuar presidentin e Rajhut si një tradhëtar në mënyrë që të fajësoheshin politikanët e rinj republikanë si armiq të Gjermanisë. Akuzat përdhosëse nisën me grevën e punëtorëve në Berlin më 1918-ën. Në atë kohë, kur qindramijëra punëtorë të industrisë së armatimeve i ulën veglat përtokë, lideri socialdemokrat Fridrih Ebert u bashkua me komitetin e grevës me qëllimin për të përfunduar mosmarrëveshjet industriale pa dëmtuar Rajhun dhe pa pasoja negative për punëtorët, megjithëse ai nuk pati dot sukses për shkak të sjelljes arrogante të qeverisë së Rajhut perandorak. Greva luajti një rol të rëndësishëm edhe gjatë kohës që ai shërbeu si president. Procesi gjyqësor më spektakolar i inskenuar prej anti-demokratëve në fushatën e tyre kundër republikës, zuri vend

në Magdeburg dhe përfundoi me një skandal më 23 dhjetor 1924. Gjyqtari arriti në konkluzionin se greva e janarit 1918 ishte në fakt një vepër tradhëtie dhe e shpalli kështu Ebertin, zyrtarisht, një tradhëtar të vendit të vet. Eberti u ofendua shumë. Që prej atij momenti e në vazhdim, çdo skeptik i demokracisë, nga intelektualët jakëbardhë e deri tek qytetarët e klasës punëtore të banakut të pijetores, mund ta emërtonin kreun republikan të shtetit si “tradhëtar” dhe të mos i ndëshkonte kërkuar. Eberti nuk kishte ndërmend që ta linte këtë akuzë të binte përtokë. Ai kërkoi apelimin për përmbysjen e gjykimit në shkallën e parë, sepse vendimi i marrë e diskretitonte të gjithë republikën duke injektuar ndjenjën e palegjtitimitetit pas çdo akuze për tradhëti. Më 24 dhjetor 1924, ai i shkruante politikanës së DVP-së Katharina von Oheimb:

“Do t’i ndjek hapat e tjerë të procesit me një ndërgjegje të pastër. Personalisht unë nuk kam nevojë për një verdikt kundër sulmeve përdhosëse; është vetëm për shkak të interesit shtetëror që unë e ndjej veten të detyruar që t’i ndërmarr këto hapa të mëtejshme. Sidoqoftë, interesi shtetëror dhe gjyqësori duken si të kithta në këtë moment”.

Përveç zhgënjimit, Eberti shpreh edhe çaste vendosmërie në letrën e tij në vigjilje të Krishtlindjeve 1924, drejtuar Oheimbit: “Rruga e jetës sime nuk ka qenë kurrë e shtruar me trëndafila. Unë nuk kërkoj asgjë tjetër për të ardhmen. Gjithsesi, unë do të ndjek vetëm rrugën time, i vëndosur dhe besimplotë, me humor të lartë dhe me ndërgjegje të pastër!” Por rruga e tij nuk do të ishte edhe shumë e gjatë. Deri sa zhvillohej gjyqi në Magdeburg, merrej si e mirëqenë që Eberti do të garonte në zgjedhjet presidenciale të pranverës 1925, aq më tepër sepse partia e tij kishte bërë paqe me të gjatë rrjedhës së fushatës përdhosëse dhe e

kishte nominuar atë si kandidatin socialdemokrat. Eberti u mirëinformua gjithashtu edhe për metodat e organizimit që kishte përdorur presidenti bashkëkohor amerikan në fushatën e vet, dhe synonte që të aplikonte të njëjtën strategji në zgjedhjet e ardhshme gjermane. Verdikti i Magdeburgut e bëri që të ndryshonte mendje. Pas disa viteve stresuese me aktivitet politik, ai preferonte më shumë që të tërhiqej në jetën private dhe të zhvendosej në Heidelberg.

Qyteti i tij i lindjes, Heidelbergu, gjithnjë kishte një vend të veçantë në zemrën e tij. Kurdo që ai shkonte për ndonjë vizitë zyrtare në jug të Gjermanisë, e shfrytëzonte rastin për të qendruar në qytetin e tij. Ai shpesh i kalonte pushimet në Freudenstadt, në Pyllin e Zi. Midis viteve 1921 dhe 1924, ai kaloi disa javë në qytetin llixhë të Bad Margentheimit në *Württemberg* për t'u lehtësuar nga dhimbjet, prej të cilave vuante që prej fillimit të luftës. Në 1916-ën kishte pasur një këputje gjatë një fjalimi dhe mezi e kishte shmangur një operim.

Në qershor 1922 iu desh që t'i ndalte pushimet e tij në Freudenstadt pasi mori lajmin e vrasjes së Ministrisë të Jashtëm Rathenau. Në po të njëjtën natë, Eberti pësoi një goditje të rëndë therëse. Në kundërshtim me këshillën e mjekut, pasi kishte mori disa injeksione morfine, ai udhëtoi me tren drejt Berlinit në mënyrë që të mbante elegjinë për ministrin e vrarë, pavarësisht dhembjes së madhe fizike. Ai pësoi një goditje tjetër në Whitsun në 1924-ën gjatë një qëndrimi të shkurtër në Schorfheide, në veri të Berlinit, ku shkonte shpesh për t'u tërhequr prej jetës së përditshme politike në një kasolle gjuetari pranë liqenit Werbellin, ku ai kishte për zakon të dilte për gjueti. Sidoqoftë, këto ishin vetëm periudha të shkurtëra në jetën e tij tejet të lodhshme dhe stresuese.

Ëndrra e tij për një pension të paqtë në qytetin e vet të lindjes në Heidelberg nuk u bë realitet. Eberti ra pre e një

fushate përdhosjeje. Pas gjykimit në Magdeburg, ai ankohej shpesh për probleme shëndetësore. Mjeku personal e kishte diagnostikuar fillimisht me *bilis colic*, në vend të apendicitit që ishte në fakt arsyeja e vërtetë e dhembjes së tij. Eberti nuk e ndoqi këshillën mjekësore për shlodhje në llixhë, për shkak se donte që ta kalonte sa më shpejtë vendimin e apelit të Magdeburgut. Më 23 shkurt, gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua rëndë. Në mbrëmje, atij iu desh që t'i nënshtruhej operimit në një klinikë në Berlin, por, sikurse rezultoi, ishte tepër vonë. Komplikimet e shkaktuara nga apendiciti dhe ndërhyrja e vonuar mjekësore bënë që në 28 shkurt 1925 rreth orës 10:05 të paradites Fridrih Eberti t'i dorëzohej pushimit të përhershëm. Nuk ka dyshim se fushata e përdhosjes së figurës ndikoi në vdekjen e tij të parakohshme në moshën 54 vjeçare.



Shërbimi përkujtimor për presidentin e rënë, në Berlin. Më shumë se një milion njerëz vërsjuan në rrugë

Sipas ditarit të mjekut të tij personal, “tronditja emocionale” e shkaktuar prej gjyqit të Magdeburgut e kishte dobësuar energjinë e pacientit aq sa ai nuk i mbijetoi dot ndërhyrjes kirurgjikale.

Berlini i dha lamtumirën Ebertit në një ceremoni përkujtimore republikane tejet prekëse më 4 mars. Një turmë e stërmadhje, e përllogaritur në një milion njerëz, e shoqëruan procesin e varrimit. Të nesërmen Eberti u la të prehej në varrezat qendrore në Heidelberg (*Bergfriedhof*). Ky ishte fundi i një politikani, qëllimi i jetës së të cilit kishte qenë implementimi i socialdemokracisë. Gjatë revolucionit, politikani socialdemokrat dhe reformues Fridrih Ebert kishte shtruar rrugën për ndërtimin e republikës, duke patur gjithnjë prioritet sistemin demokratik parlamentar. Duke qenë kreu i shtetit të republikës, ai e shihte veten si presidenti i të gjithë gjermanëve dhe jo si përfaqësues të një partie. Bazuar tek ky kuptim i detyrës, objektivi i tij kryesor ishte ruajtja e demokracisë në gjendje të mirë pune. Në këtë detyrë ai nuk ishte i pasuksesshëm.

Dy javë para se ai të vdiste, “*Vorwärts*”, gazeta zyrtare e SPD-së, i kishte rikujtuar lexuesit e vet për përvjetorin e gjashtë të zgjedhjes së Ebertit si president i Rajhut. Sipas gazetës, “shoku Ebert” ishte detyruar që në një kohë krize të mbante mbi shpatulla një barrë më të vështirë sesa gjithçka që i ishte dashur kujtudo shtetari tjetër të përgjegjshëm përpara tij. E përditshmja i përshkruante sfidat me të cilat përballlej Eberti si president i Rajhut në këtë mënyrë:

“Presioni më i madh i mundshëm nga jashtë, tronditja më e madhe nga brenda, vështirësi shoqërore, rrezik shpërbërjeje. Këto ishin rrethanat kur Eberti erdhi në detyrë. Pas kësaj erdhi vendimi për Silezinë e Veriut, ultimatumit i Londrës, shtërëngimi i Rurit, pastaj goditje majtas, goditje djathtas, vrasje në politikë, separatizmi në Perëndim dhe në Bavari, dhe së fundmi, uri, rebelime dhe inflacion.”

Kaq përmbledhtas, analiza për rrethanat dhe vështirësitë e kohës së Ebertit në detyrë nuk mund të ishte më precize. Partia tregoi respekt për arritjet e liderit të tyre të dikurshëm si kreu i republikës: “Ishte detyra e Ebertit që të parandalonte krizat duke i çuar ato në shkatërrim”. Në fakt, asnjë krizë nuk u shndërrua në shkatërrim. 1925-a, viti kur vdiq presidenti i parë i Rajhut, shfaqte për herë të parë një stabilitet relativ për Republikën e Vajmarit. Kjo, edhe për meritë të politikave të Fridrih Ebertit pas vitesh të tëra krizash dhe kundërshtish. Fridrih Eberti kishte bërë atë që një kre shteti mund të bënte, me vendosmëri dhe dedikim besimplotë ndaj idealit demokratik, duke mbajtur parasysh shoqërinë e segmentuar dhe të pabalancuar të republikës, shoqëri që mezi ishte paqësuar dhe që vuante prej një presioni të madh së jashtmi. Kur Eberti vdiq, Republika e Vajmarit humbi një prej pionierëve dhe shtyllave të saj.



Varri i Fridrih Ebertit në Bergfriedhof, varrezat qendrore, në Heidelberg.

Mbishkrimi në gurin e varrit të tij përmbledh parimin politik që ai kishte zgjedhur si më të rëndësishmin në 1919-ën: “Qëllimi i punës sime është mirëqenia e popullit.” (“*Des Volkes Æohl ist meiner Arbeit Ziel*”). Ky është një epitaf që përmban filozofinë së cilës iu përmbajt presidenti i Rajhut, paçka pengesave të shumta. Kjo e bën Ebertin shteta-

rin republikan socialdemokrat, pararendës të demokracisë gjermane. Shumë shpejt republika do ta kuptonte se çfarë humbje kishte pësuar me vdekjen e presidentit të Rajhut.



Presidenti dhe gruaja e tij duke ecur në rrugët e Berlinit për të hedhur votën gjatë zgjedhjeve parlamentare të qershorit 1920.

V Fridrih Eberti në memorjen politike dhe kërkimin shkencor në histori

Në qershor 1924, kryetari socialdemokrat Herman Müller e mbrojti presidentin e Rajhut nga kritikët e tij brenda partisë në konventën e saj:

“Kalon pa u thënë se ne si parti nuk pranojmë gjithçka për të cilën presidentit të Rajhut i duhet të marrë përgjegjësi [...] Nëse në të ardhmen do të ketë ndonjë historian, që do të përpiqet të vlerësojë periudhën e Ebertit si kre të Republikës Gjermane, atëherë ai do të zbulojë shtrirjen e mendimeve të thella dhe seriozitetit me të cilin Eberti e realizoi detyrën e tij. Partia Socialdemokrate do të jetë përjetësisht e nderuar që ka pasur në radhët e saj një burrë, i cili në rrethana jashtëzakonisht të vështira ka pasur një ndikim kaq të madh sa Eberti.”

Presidenti i parë i Rajhut vdiq vetëm një vit më pas. Vdekja tragjike dhe e parakohshme e Fridrih Ebertit e gdhendi figurën e tij në sytë e bashkëkohësve të vet dhe thellë në kohën e Republikës Federale Gjermane. Në një fjalim të mbajtur më 1950-ën, Theodor Heuss, presidenti i parë i Republikës Federale, e quajti Ebertin “Abraham Linkolnin e historisë gjermane”. Ky krahasim u bë shumë shpejt një mënyrë të thëni tejet e përhapur. Heuss e kishte përdorur për herë të parë në përkujtimin e tij ndaj Ebertit më 1925-ën, por ishte gazeta britanike “The Observer” ajo që e gdhendi shprehjen në vjeshtën e 1923-shit, kur i krahasoi përpjekjet e Ebertit për ta mbajtur bashkë Rajhun me përpjekjet e presidentit amerikan për ruajtjen e unionit të Shteteve të Bashkuara gjatë Luftës Civile Amerikane (1861 – 1865). Heuss shkroi më 1927-ën, se “historitë e së ardhmes do ta vlerësojnë një ditë siç duhet shërbimin e

Ebertit [...] që ai e udhëhoqi Gjermaninë jashtë përplas-jeve dhe kaosit revolucionar dhe përcaktoi rrugën drejt demokracisë”. Sidoqoftë, u desh shumë kohë derisa ky gjykim u pranua botërisht.

Socialdemokratët dhe përkujtimi i tyre për Republikën e Vajmarit e kthyen presidentin e parë të Rajhut në një simbol të rendit të ri demokratik në kontrast të fortë me pasuesin e tij, Paul von Hindenburg-un, gjeneralin e dikurshëm perandorak. Menjëherë pas vdekjes së Ebertit u themelua “*Friedrich-Ebert-Stiftung*”, Fondacioni Fridrih Ebert, për të mbështetur studentët nga familjet e klasës punëtore. Sidoqoftë, Eberti nuk u bë kurrë një legjendë politike jashtë partisë së tij. Pas shtënies në dorë të pushtetit në 1933-shin, nazistët u përpoqën që ta zhduknin kujtimin e Ebertit, të cilin ata e përçmonin si një prej “kriminelëve të nëntorit”. Gjithsesi emri i tij jetoi më tej përmes grupeve të rezistencës dhe gjermanëve në azil. Pas Luftës së Dytë Botërore, kujtimi i Ebertit fitoi ndërgjegjësim politik dhe historik, por pa arritur ndonjë njohje më të gjerë.

Përveç disa përpjekjeve bibliografike, historianët dhe kërkuesit shkencorë akademikë e kanë injoruar gjerësisht Fridrih Ebertin. Kjo zgjati deri në 100 vjetorin e lindjes së tij më 1971-shin, kur më në fund Peter-Christian Witt prezantoi me modesti një ese biografike të jetës dhe veprës së Ebertit, bazuar në një material me burime parësore. Megjithë disa botime të tjera, Eberti nuk u bë kurrë subjekt i një biografie të gjerë akademike.

Kjo ndodhi pjesërisht për shkak të mungesës së një rezidence të Ebertit dhe pjesërisht për shkak të personalitetit të tij. Ai nuk shfaqti asnjëherë ndonjë sjellje bombastike, ose që tërhiqte vëmendje dhe nuk pati shumë thyerje e ndryshime në karrierën e tij, ashtu sikurse disa prej bashkëkohësve të tij si Gustav Stresemanni apo Walther Rathenau, të cilët kanë gëzuar interesin e kërkuesve shkencorë në

histori. Kjo, në filozofinë politike të Ebertit, nuk ishte kur-
rë e rëndësishme. Ai nuk e kishte karizmën e një politikani
të madh, që zakonisht i intrigon historianët tek figurat his-
torike influencuese. Përveç këtyre, fakti që ka shumë pak
burime parësore të shkruara nga vetë Eberti ka ndikuar
në këtë mangësi kërkimesh historike rreth tij. Gjatë kohës
në detyrën e presidentit të Rajhut, Eberti i shkatërroi vetë
shumicën e dokumenteve të veta. Pjesa tjetër u dogj gjatë
një bombardimi ajror në 1943-shin, kur pallati i vejushës
së tij në Berlin u shkatërrua. Prandaj, edhe sot e kësaj dite
Eberti mbahet mend më shumë si një politikan i kohës së
revolucionit, sesa si president i Rajhut. Stereotipe në lidhje
me sjelljen e tij gjatë asaj kohe mbizotërojnë ende sot në
kujtesën historike për politikanin dhe shtetarin.

Përtej kërkimeve historike, ai është parë si personi që i
shtroi rrugën demokracisë gjatë revolucionit dhe që paran-
daloj “bolshevizimin” e Gjermanisë dhe shndërrimin e saj
pas Luftës së Parë Botërore në një diktaturë të ngjashme me
Rusinë Sovjetike. Vlerësime të tilla konfirmojnë ekzistencën
e historiografisë të periudhës së pas luftës, që ishte kryesisht
konservatore dhe e vlerësonte, madje e idealizonte Ebertin
në çdo aspekt. Ky interpretim gjeti vend në librat shkollorë
të historisë së Gjermanisë dhe në tekstet shkollore të Gjer-
manisë Perëndimore deri në vitet '80 të shekullit të kaluar.

Në Republikën Demokratike të Gjermanisë Lindore
(*Deutsche Demokratische Republik*; GDR), Eberti përsh-
kruhej si një “tradhëtar ndaj lëvizjes punëtore”, për shkak
të përpjekjeve të tij kundër themelimit të republikës sovje-
tike, për besimin e tij në demokracinë parlamentare dhe për
bashkëpunimin e supozuar të tij me elitat e vjetra të Kajser-
rajhut, gjë që ishte në përputhje me dënimet tradicionale të
komunistëve në kohën e tij. Kjo mbetej një konstante edhe
pse prezantimi i kësaj figure ndryshonte në intensitet. Djali
i madh i presidentit, Fridrih Ebert i Riu, ishte anëtar i nde-

ruar i SED (*Sozialistische Einheitspartei Deutschlands*: partisë së vetme të diktaturës në GDR) dhe kryetar kohëgjatë i bashkisë në Berlinin Lindor. Ai e mbështeste kritikën ndaj rolit që kishte luajtur i ati veçanërisht gjatë periudhës 1918 – 1919, por njëkohësisht e kundërshtonte fort verdiktin se babai i tij kishte qenë një “tradhëtar ndaj lëvizjes punëtore”.

Ndërkohë që pasardhësit e Ebertit në Gjermaninë Lindore nuk kishin mundësi për t’i kundërshtuar konsideratat për Ebertin që mbisundonin në GDR, të afërmit e tij të mbijetuar -vejusha Louise dhe djali i tij Karl, të cilët e kaluan pjesën tjetër të jetës në Heidelberg - nuk bënë ndonjë përpjekje për të ndikuar në trajtimin e figurës së Ebertit. Në Republikën Federale Gjermane konsiderata për Ebertin ndryshoi, kur nisën kërkimet intensive rreth periudhës revolucionare. Kryesisht, rryma historike socialdemokrate e majtë e viteve ’60 të shekullit të 20 -të, doli në përfundim se shumica e këshillave të punëtorëve dhe ushtarëve kishin pasur një orientim socialdemokrat dhe se ata e mbështesnin politikën e Ebertit drejt demokracisë parlamentare, në kontrast me konsideratat e mëparshme akademike se ato kishin qenë radikale dhe komuniste. Në axhendën e këshillave të 1918-ës dhe 19-ës nuk përmendej fare një transformim i ngjashëm me atë të Rusisë, nuk bëhej fjalë për zgjedhje mes demokracisë dhe diktaturës në terma sovjetikë. Sipas kësaj perspektive, politika e Ebertit u shfaqën në një dritë komplet tjetër. Ai e humbi aureolën e tij si shpëtimtari i demokracisë gjermane prej bolshevizmit.

Sidoqoftë, një kërkim i ri akademik, i cili hetoi për shkaqet e rënies së republikës në 1933-shin, zbuloi dështimet e qeverisë së revolucionit kur u hodhën themelet e demokracisë. Sipas këtij vështrimi, socialdemokratët dhe kryesisht figura e tyre kryesore - Eberti, e humbën mundësinë për të zbatuar masa strukturore që do ta kishin siguruar demokracinë parlamentare në periudhën midis 9 nëntorit 1918 dhe 6 shkurtit 1919 (dita e inaugurimit të Asamblesë Kombëtare), periudha

kohore që sot njihet më së shumti si “periudha e hapjes”. Konsiderohet se Eberti u mbajt fort pas konceptit të një rendi *ad absurdum* dhe se atij i mungonte imagjinata politike dhe perspektiva e nevojshme për kohën e revolucionit.

Teza më e rëndësishme e kësaj linje biografike thotë se gjatë kohës së tranzicionit u realizuan disa reforma, që mundësuan forcimin e themeleve për demokracinë e parë gjermane. Bashkëpunimi me elitat e vjetra për çështjet administrative dhe ushtarake ishte më i madh nga ç’ ishte nevoja dhe reformat strukturore të konsideruara si shumë të rëndësishme, nuk u filluan fare. Kjo linjë që thekson qasjen e “mundësive të humbura” dhe ndonjëherë idealizon lëvizjen revolucionare si një shembull të demokracisë së bazës, pretendon se këshillat e punëtorëve dhe të ushtarëve kishin në fakt një fuqi të madhe dhe Eberti si dhe qeveria e revolucionit i humbën shanset prej neglizhencës për të ribërë sistemin politik, ekonomik dhe social. Megjithëse ky interpretim shkon larg, hipotezat e tij dështojnë të shpjegojnë disa çështje kryesore. Si duhej vënë në përdorim ky potencial, i cili nuk ishte legjitimuar me asnjë mjet demokratik? Ishte vërtetë jetike për mbijetesën e republikës prezantimi i reformave të tilla sikurse socializimi i industrive të mëdha? Dhe së fundmi, a do ta kishte stabilizuar efektivisht republikën gjatë periudhës së revolucionit një politikë reformash sistemike? Ka bazë të fortë hamendësimi se një kundërrevolucion do ta kishte mbytur demokracinë e re që në lindje në rast të një ndërhyrjeje thelbësore ekonomike apo sociale. Shumica e këtij diskursi është kundërproduktive. Në përgjithësi pyetja hipotetike “po sikur?” nuk mund të marrë përgjigje.

Përtej shumë deduksioneve spekulative, kritikët, jashtë fushës së kërkimeve historike, e kanë parë dështimin e zbatimit të reformave të tilla strukturore si një gabim të Ebertit dhe të deputetëve të popullit. Për ta, kjo jo vetëm



Pfaffengasse në Heidelberg në fillim të 1920-ës, ku Eberti lindi në 1871-shin.

që dëmtoi republikën, por ishte edhe përgjegjëse për tranzicionin e saj në diktaturë në janar 1933. Një qasje e tillë, nënvlerëson gjithësi parakushtin e periudhës revolucionare dhe kuadrin e ngushtë kohor. Për më tepër, ajo injoron tërësisht parimin bazë demokratik të Ebertit për t'u ofruar të gjithë qytetarëve të drejtën për pjesëmarrje politike si dhe vizion politik: republikën parlamentare. Ky ishte objektivi i tij kryesor, dhe fakti që ai ia doli ta arrinte këtë qëllim megjithë rrethanat e pashpresa të 9 nëntorit 1918, e bën atë në vetvete një arritje të madhe.

Përtej konsideratave të ndryshme mbi politikën e Ebertit gjatë revolucionit, nuk ka pasur ndonjë *Historikerstreit* apo ndonjë mosmarrëveshje intelektuale për sa i takon trashëgimisë së Fridrih Ebertit, sikurse thoshte edhe gazeta e përjavshme socialdemokrate “*Vorwärts*” kur vlerësonte figurën e tij si president i Rajhut në përvjetorin e 70-të të zgjedhjes. Dokumentacioni për Ebertin dhe arritjet e tij është *problematik për kërkuesit. Aktualisht* nuk ka asnjë vlerësim unanim për presidentin Ebert, i cili shfaqet vetëm si hije kur gjykohen ngjarjet historike të Republikës së Vajmarit.

Në përgjithësi, studimet rreth periudhës së revolucionit përqendrohen tek politikën dhe strategjinë politike të Ebertit gjatë kohës së tij në pushtet, megjithëse nuk përfundojnë në të njëjtin gjykim. Ka pasur mjaftueshëm kërkim biografik për jetën e Ebertit përpara 1918 - 1919-ës, kur ai u bë kancelar dhe deputet i popullit. Sidoqoftë, Eberti si president i Rajhut është anashkaluar gjerësisht prej kërkimeve historike. Si rezultat i kësaj, ai është reduktuar në një simbol të republikës së socialdemokracisë së Vajmarit, duke u përpjekur dhe përfundimisht duke dështuar që t’ia dilte sfidave me të cilat e kishte përballur tranzicionit. Botimet historike shpesh e kanë portretizuar Ebertin si një shembull të përfaqësuesit mendjengushtë dhe pa imagjinatë socialdemokrat të borgjezisë së vogël, në zyrën qeveritare. Ka disa shprehje për t’u shqyrtuar që përpiqen ta karakterizojnë Ebertin si një hije që zbret dhe ngjitet në sipërfaqe: “Një Linkoln apo një Stalin për SPD-në?” ishte titulli i publikuar në “*Die Zeit*”, një e përjavshme gjermane në vitin 1975, me rastin e përvjetorit të 50-të të vdekjes së Ebertit. Këto portretizime ishin sa tërheqëse, aq edhe të gabuara. Krahasimet me figura të tjera historike nuk ndihmonin në formulimin e një tipizimi të Ebertit që mund të mbahej mend lehtë.

Deri në vitin 2006 nuk ekzistonte asnjë punim shkencor lidhur me Ebertin si president Rajhu. Në këtë vit u publikua një rrëfim biografik i zgjeruar. Biografia ishte e bazuar në burime të shumëllojshme dhe të ndryshme dhe përqendrohej tek koha e Ebertit në krye të shtetit. Ai punim ka rrëzuar shumë mite jetëgjata (*Walter Mühlhausen: Friedrich Ebert 1871–1925. Reichspräsident der Weimarer Republik, Bonn. sec. ed. 2007*). Vlerësimi i figurës së Ebertit dhe i politikave të tij mori parasysh gjithashtu edhe ndryshimet politike të kohës. Gjatë rrjedhës së riunifikimit të Gjermanisë më 1990-ën, u shfaqën disa të dhëna që tregonin për problemet pas Luftës së Parë Botërore dhe pasojat e tyre: shtrëngimet e kohës së shkurtër për vendimarrje gjatë revolucionit 1918 – 1919 dhe vitet e para të brishta të republikës pa asnjë sukses politik apo ekonomik të nevojshëm për pranimin e rendit të ri - një sukses të cilin Republika Federale e arriti pas Luftës së Dytë Botërore. Përtej qasjes së ngushtë biografike, iu dha një konsideratë e madhe veprimeve të shumicës socialdemokrate nën udhëheqjen e Ebertit në mënyrë që të kuptohej më mirë koha e Republikës së Vajmarit. Si rezultat, deputeti i popullit dhe presidenti i parë i Rajhut u shfaqën në një dritë shumë më pozitive. Ky vështrim tregonte se asokohe kishte qenë e mundur që të shtrohej rruga për demokracinë parlamentare, paçka situatës shkatërrimtare të fundit të luftës. Ai evidenton faktin se ekzistonte një shans real që republika të zhvillonte demokracinë në fund të mandatit të Ebertit si president. Shkurt, rënia e republikës në 1933-shin, nuk ishte një pasojë e pashmangshme e 1918 – 1919-ës.

Menjëherë pas rënies së Republikës Demokratike Gjermane, u inaugurua Reichspräsident-Friedrich-Ebert-Gedenkstätte (Memoriali i Presidentit të Rajhut Fridrih Ebert) , në Heidelberg. Fillesat e ndërtimit të memorialit mund të shihen se datojnë që prej viteve '60. *Në maj të*

1962-shit, Fondacioni Fridrih Ebert dhe qyteti i Heidelbergut iniciuan një ekspozitë në shtëpinë ku u lind Eberti. Në vitin 1982 u bënë përpjekje për ta zgjeruar këtë ekspozitë në një memorial kombëtar. Kjo për shkak se dukej sikur Eberti nuk u shfaq midis figurave historike të mirënjohura. Bundestagu gjerman kaloi ligjin për themelimin e Fondit Memorial të Presidentit të Rajhut Fridrih Ebert, kundër votave të Partisë së Gjelbër në vitin 1986.



Vendlindja e Frifrih Ebertit, sot hyrja për në Memorialin në Pfaffengasse

Statuti i fondacionit shkruan: “Për të ruajtur kujtimin e presidentit të parë të Rajhut gjerman Fridrih Ebert, dhe për të kontibuar në të kuptuarit e historisë gjermane në kohën e tij”. Vendndodhja e memorialit u hap më 11 shkurt 1989 në shtatëdhjetë vjetorin e zgjedhjes së Ebertit si president. Me themelimin e këtij fondi, Republika Federale, zyrtarisht dhe institucionalisht i nderoi meritat dhe kujtimin e Fridrih Ebertit. Baza e memorialit në Heidelberg është pallati i vogël ku Fridrih Eberti u lind më 1871-shin si i biri i

një rrobaqepësi. Këtu janë rrënjët e një socialdemokrati dhe shtetari të madh, themelues dhe garant i demokracisë së parë gjermane, i cili më në fund ka gjetur vendin që i takon në traditën politike dhe historike të Republikës Federale Gjermane.

18 janar 1871	Shpallja e Vilhelmit të Parë të Prusisë si Perandori gjerman në Versajë të Francës
4 shkurt 1871	Lindja e Fridrih Ebertit në Heidelberg, fëmija i shtatë nga nëntë fëmijët e Karl Ebertit (1834 – 1892), një rrobaqepës, me Katharina Eber, née Hinkel (1834 – 1897)
19 mars 1871	Pagëzimi i Ebertit në besimin Katolik Roman
22 – 27 mars 1875	Shkrimja e Shoqatës së Përgjithshme të Punëtorëve Gjermanë (<i>Allgemeiner Deutscher Arbeiterverein</i>) dhe Partisë Socialdemokrate të Punëtorëve (<i>Sozialdemokratische Arbeiterpartei</i>) nën emrin Partia Socialiste e Punëtorëve të Gjermanisë (<i>Sozialistische Arbeiterpartei Deutschlands</i>)
1877 – 1885	Vitet e shkollës fillore për Ebertin
21 tetor 1878	Shpallja e ligjit të parë anti-socialist prej Rajhshtagut me kërkesë të Kancelarit Perandorak Otto von Bismarck në mënyrë që të shtypej socialdemokracia, e cila u ripërcaktua vazhdimisht deri më 1890-ën
1885 – 1888	Eberti si nxënës shalëpunues
1888 – 1918	Sundimi i Perandorit Vilhelmi II
1889 – 1891	Rrugëtimet e Ebertit me ndalesa në Hanover, Kassel, 33esel, Quakenbruck midis të tjerash
1889	Eberti bashkohet me Partinë Socialdemokrate dhe me sindikatën e shalëpunuesve
Maj 1891	Mbërritja në Bremen. Punësimi si shalëpunues
12 – 18 tetor 1890	Konferenca e parë e partisë së socialdemokratëve pas shpalljes së ligjit anti-socialist. Emër i ri për partinë: Partia Social Demokrate e Gjermanisë
14 -18 tetor 1891	Konferenca e SPD-së në Erfurt; adoptimi i “Programit të Erfurtit”
1893 – 1894	Eberti punon si redactor i gazetës socialdemokrate “ <i>Bremer-Bürger-Zeitung</i> ”
2 mars 1894	Eberti zgjidhet kryetar i Shoqatës Social Demokrate në Bremen (deri në 1896-ën)
13 prill 1894	Eberti drejton një bar, deri në 1900-ën
9 maj 1894	Martesa me një vajzë të klasës punëtore Louise Rump (23 dhjetor 1873 – 18 janar 1955); fëmijët: Fridrih (1894 – 1979), Georg (1896 – 1917), Hajnrih (1897 – 1917), Karl (1899 – 1975) dhe Amalie (1900 – 1931)
11 – 16 tetor 1896	Eberti merr pjesë në një kongres të SPD-së në Gotha

15 dhjetor 1899	Zgjidhet si anëtar i <i>Bremer Bürgerschaft</i> (Parlamentit shtetëor të Bremenit), ku shërben deri më 1905-ën. Zgjidhet si kider i grupit parlamentar të SPD-së.
19 dhjetor 1899	Zgjedhja e Ebertit si sekretar i sindikatave, në shërbim deri në 1905-ën
14 – 20 gusht 1904	Pjesëmarrës në Kongresin Ndërkombëtar Socialist në Amsterdam
18 – 24 shtator 1904	Zgjedhja e Ebertit si një prej dy drejtuesve të konferencës së SPD-së në Bremen
24 shtator 1905	Zgjedhja si sekretar i ekzekutivit të SPD-së, duke fituar 174 prej 283 votav në kongresin e partisë në Jena
1 dhjetor 1905	Lëviz në Berlin
1905 – 1913	Anëtar i ekzekutivit të SPD-së
Dhjetor 1908	Kryetar i zyrës qendrore të Rinisë Punëtore Gjermane
28 gusht – 3 shtator 1910	Pjesëmarrës në Kongresin Ndërkombëtar Socialist në Kopenhagen
16 shtator 1911	Hugo Haase zgjidhet drejtues i SPD-së. Eberti merr 102 prej 393 votave pavarësisht dorëheqjes së tij prej kandidimit për pozicionin
25 janar 1912	Zgjedhja e Ebertit si anëtar i Rajhshtagut, duke përfaqësuar Elberfeld-Barmen (Wuppertal)
1912 – 1918	Anëtar i Rajhshtagut
20 shtator 1913	Zgjedhja e Ebertit si një prej dy drejtuesve të partisë duke fituar me 433 vota prej 473 në konventën e partisë në Jena
1913 – 1919	Mandati i Ebertit si një prej dy drejtuesve të SPD-së
1 – 3 gusht 1914	Miratimi i grupit parlamentar të SPD-së për shpenzimet e luftës dhe fillimi i politikave “ <i>Burgfrieden</i> ”
11 nëntor 1916	Zgjedhja e Ebertit si një prej tre drejtuesve të ekzekutivit të partisë në grupin parlamentar të SPD-së
14 shkurt 1917	Vdekja e djalit të Ebertit Hajnriluh në një spital ushtarak në Maqedoni
6 – 8 prill 1917	Themelimi i Partisë së Pavarur Socialdemokrate të Gjermanisë (USPD)
5 maj 1917	Vdekja e djalit të Ebertit Georg në frontin perëndimor në Francë
4 – 13 qershor 1917	Negociata të një delegacioni të socialdemokratëve nën drejtimin e Ebertit nëmënyrë që të përgatitej një konferencë ndërkombëtare për paqen e socialistëve në Stockholm

Korrik 1917	Komiteti Ndërpartiak dhe rezoluta për paqen në Rajhshtag (19 korrik)
Janar 1918	Greva e punëtorëve të armatimeve në Berlin. Eberti anëtar i komitetit të grevistëve
3 tetor 1918	Formimi i qeverisë së Rajhut me Princin Max von Baden si kancelar dhe me pjesëmarrjen e socialdemokratëve për herë të parë
28 tetor 1918	Reformat kushtetuese (parlamentarizimi)
9 nëntor 1918	Abdikimi i Kajzerit Vilhelm II. Caktimi i Ebertit si kancelar. Shpallje e Republikës Gjermane prej Filip Sheidmanit (SPD)
10 nëntor 1918	Formimi i qeverisë së revolucionit (Këshilli i Deputetëve të Popullit) me tre anëtarë të SPD-së (Fridrih Ebert, Filip Sheidman, Otto Landsberg) dhe tre nga USPD-ja (Hugo Haase, Wilhelm Dittman, Emil Barth). Marrëveshja mes Ebertit dhe gjeneralit Wilhelm Groener
11 nëntor 1918	Firmosja e traktatit me Aleatët prej Matthias Erzberger (Partia e Qendrës)
12 nëntor 1918	Shpallja e programit të reformës së qeverisë së revolucionit, përfshi prezantimin e ditës tetë orarëshe të punës dhe të drejtës së votës për femrat
16 – 20 dhjetor 1918	Kongresi i Këshillave të Punëtorëve dhe Ushtarëve të Rajhut në Berlin, vendosi për demokraci parlamentare dhe për zgjedhje të parakohshme për Asamblenë Kombëtare
29 dhjetor 1918	Tërheqja e USPD-së prej Këshillit të Deputetëve të Popullit; hyrja e Gustav Noske (SPD) dhe Rudolf Wissell (SPD) në qeveri
1 janar 1919	Themelimi i Partisë Komuniste Gjermane nën drejtimin e Rosa Luxemburg-ut dhe Karl Liebknecht-it
5 – 12 janar 1919	Kryengritja e Janarit (“Kryengritja Spartaciste”) e së majtës radikale në Berlin
15 janar 1919	Vrasja e Rosa Luxemburgut dhe Karl Liebknechtit, liderë të Partisë Komuniste
19 janar 1919	Zgjedhjet e Asamblesë Kombëtare me SPD-në që fiton 37.9 për qind të votave
6 shkurt 1919	Hapja e Asamblesë Kombëtare në Vajmar, Thuringi, prej nga ku erdhi edhe emri i republikës së re: Republika e Vajmarit

11 shkurt 1919	Zgjedhja e Fridrih Ebertit si president i Rajhut me 277 prej 379 votave të hedhura prej Asamblesë Kombëtare. Dorëheqja prej mandatit të tij në Asamblenë Kombëtare (13 shkurt)
13 shkurt 1919	Caktimi i Filip Sheidmanit (SPD) si kreu i qeverisë (<i>Reichsministerpräsident</i>) dhe realizimi i të ashtuquajturit “Koalicioni i Vajmarit” mes SPD-së, Partisë së Qendrës dhe Demokratëve Gjermanë (DDP)
23 qershor 1919	Autorizimi i pranimit të Asamblesë Kombëtare për traktatin e paqes së qeverisë së re të udhëhequr prej Gustave Baurerit (SPD)
28 qershor 1919	Firmosja e Traktatit të Paqes në Versajë prej ministrave Herman Müller (SPD) dhe Johannes Bell (Partia e Qendrës)
31 korrik 1919	Adoptimi i një kushtetute prej Asamblesë Kombëtare me 262 prej 338 votave
11 gusht 1919	Firmosja e kushtetutës së re të Rajhut prej Fridrih Ebertit në Schwarzburg, Thuringi
21 gusht 1920	Betimi i Ebertit si president në përputhje me kushtetutën e Vajmarit
10 janar 1920	Aktivizimi zyrtar i Traktatit të Versajës
13 – 18 mars 1920	Puçi Kapp – Lüttwitz; greva e përgjithshme e punëtorëve
27 mars 1920	Caktimi i Herman Müllerit (SPD) si kancelar
6 qershor 1920	Zgjedhjet e Rajhshtagut me humbje të mëdha për SPD-në. Koalicioni i Vajmarit e humbet shumicën
25 qershor 1920	Caktimi i Constantin Fehrenbachut (Partia e Qendrës) si kancelar në kabinetin e pakicës së partive borgjeze me SPD-në
4 – 7 dhjetor 1920	Braktisja e socialdemokratëve të pavarur drejt KPD-së
10 maj 1921	Caktimi i Joseph Wirthit (Partia e Qendrës) si kancelar
26 gusht 1921	Vrasja e Ministrit të mëparshëm të Financave Matthias Erzberger (Partia e Qendrës)
16 prill 1922	Përmbyllja e Traktatit të Rapallos mes Gjermanisë dhe Rusisë Sovjetike
24 qershor 1922	Vrasja e Ministrit të Jashtëm Walther Rathenau (DDP)
24 shtator 1922	Ribashkimi i SPD-së me mbetjet e USPD-së
24 tetor 1922	Vendimi i Rajhshtagut për të zgjatur mandatin e Ebertit deri për datën 30 qershor 1925 me votimin 314 me 76
21 nëntor 1922	Caktimi i Vilhelm Cuno (i pavarur) si kancelar. Formimi i të ashtuquajturit “Kabineti i Personaliteteve”

11 janar 1923	Pushtimi i Rurit prej trupave franceze dhe belge
13 janar 1923	Shpallja e politikës së rezistencës pasive
13 gusht 1923	Caktimi i Gustav Streseman (DVP) si kancelar në koalicionin e gjerë (DVP, Partia e Qendrës, DDP, SPD). Hiperinflacion masiv.
26 shtator 1923	Pezullimi i rezistencës pasive; vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme
9 nëntor 1923	Puç në Mynih nga Adolf Hitleri
15 nëntor 1923	Prezantimi i Rentenmarkës, fundi i inflacionit
30 nëntor 1923	Caktimi i Vilhelm Marx (Partia e Qendrës), si kancelar
13 mars 1924	Shpërndarja e Rajhshtagut, zgjedhjet e reja më 4 maj
20 tetor 1924	Shpërndarja e Rajhshtagut, zgjedhjet e reja më 7 dhjetor
9 dhjetor 1924	Fillimi i gjyqit të shpifjes ndaj Ebertit në Magdeburg
23 dhjetor 1924	Verdikti në Gjyqin e Magdeburgut
15 janar 1925	Caktimi i Hans Lutherit (i pavarur) si kancelar
28 shkurt 1925	Vdekja e Fridrih Ebertit në Berlin
5 mars 1925	Funerali i Fridrih Ebertit në Heidelberg
26 prill 1925	Zgjedhja e gjeneralit perandorak Paul von Hindenburg si president i Rajhut

Burimet dhe Bibliografia

Rezidenca e Fridrih Ebertit nuk ka mbijetuar. Disa prej dokumenteve ai i ka shkatërruar vetë; pjesa tjetër u dogj në një bombardim ajror gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vetëm disa dokumente kanë mbijetuar. Dokumentet e zgjeruara për kohën e tij në detyrë si president gjenden në Bundesarchiv në Berlin.

Burime nga shtypi

Ebert, Friedrich, *Schriften, Aufzeichnungen, Reden. Me reminishenca të papublikuara prej rezidencës*, 2 vëll, Dresden 1926.

Ebert, Friedrich, *Kämpfe und Ziele. Mit einem Anhang: Erinnerungen von seinen Freunden*, Dresden [1926].

Mühlhausen, Walter (ed. Në bashkëpunim me Bernd Braun), *Friedrich Ebert und seine Familie. Persönliche Briefe 1909–1924*, Munich 1992.

Bibliografi e përzgjedhur

Besson, Waldemar, *Friedrich Ebert. Verdienst und Grenze*, Göttingen 19702.

Birkenfeld, Wolfgang, *Der Rufmord am Reichspräsidenten. Zu Grenzformendes politischen Kampfes gegen die frühe Weimarer Republik 1919–1925*, in: *Archiv für Sozialgeschichte* (1965), 453–500.

Braun, Bernd/Mühlhausen, Walter, *Vom Arbeiterführer zum Reichspräsidenten. Friedrich Ebert (1871–1925). Katalog zur ständigen Ausstellung in der Reichspräsident-Friedrich-Ebert-Gedenkstätte*, Heidelberg 2012.

Buse, Dieter K., *Friedrich Ebert – Sein Weg zum Politiker von nationaler Bedeutung (1915–1918)*, Heidelberg 19942.

- Friedrich Ebert und seine Zeit. Ein Gedenkwerk über den ersten Präsidenten der deutschen Republik, Berlin-Charlottenburg (1926).
- Friedrich Ebert 1871–1925. With an introduction of Peter-Christian Witt, Bonn 1980.
- Friedrich Ebert als Reichspräsident (1919–1925). Konferenz der Friedrich-Ebert-Stiftung zum 80. Todestag, edited by the Friedrich-Ebert-Stiftung, Berlin 2005.
- Grebing, Helga, Friedrich Ebert – Von der Verantwortung für die Demokratie in Deutschland, Heidelberg 1996.
- Harmer, Harry, Friedrich Ebert (Makers of the Modern World), London 2008.
- Kolb, Eberhard/Schumann, Dirk, Die Weimarer Republik, Munich 2013.
- Kolb, Eberhard (ed.), Friedrich Ebert als Reichspräsident. Amtsführung und Amtsverständnis, Munich 1997.
- König, Rudolf/Soell, Hartmut/Weber, Hermann (eds.), Friedrich Ebert und seine Zeit. Bilanz und Perspektiven der Forschung, Munich 1992.
- Kotowski, Georg: Friedrich Ebert. Eine politische Biographie, völl. 1: Der Aufstieg eines deutschen Arbeiterführers 1871 bis 1917, Wiesbaden 1963.
- Möller, Horst, Die Weimarer Republik. Eine unvollendete Demokratie, Munich 2006.
- Mommsen, Hans, Friedrich Ebert als Reichspräsident, in: id., Arbeiterbewegung und Nationale Frage. Selected articles, Göttingen 1979, 296–317.
- Mommsen, Hans, Aufstieg und Untergang der Republik von Weimar. 1918–1933, Berlin 2004.
- Mühlhausen, Walter, Friedrich Ebert – Sein Leben, sein Werk, seine Zeit. Völlim shoqërues për ekspozitën permanente të Memorialit të Presidentit Fridrih Ebert, Heidelberg 1999.
- Mühlhausen, Walter, Die Republik in Trauer. Der Tod des

- ersten Reichspräsidenten Friedrich Ebert, Heidelberg 2005.
- Mühlhausen, Walter, Friedrich Ebert (1871–1925) in: Reinhold Weber/Ines Mayer (eds.), Politische Köpfe aus Südwestdeutschland, Stuttgart 2005, 94–105.
- Mühlhausen, Walter, Friedrich Ebert 1871–1925, in: Wilhelm von Sternburg (ed.), Die deutschen Kanzler. Von Bismarck bis Merkel, Berlin 2006, 186–209.
- Mühlhausen, Walter, Friedrich Ebert 1871–1925. Reichspräsident der Weimarer Republik, Bonn 2007.
- Mühlhausen, Walter: Der Reichspräsident zwischen Tradition und Moderne. Zur Rolle Friedrich Eberts in der Republik von Weimar, in: Ute Schneider/Lutz Raphael (eds.), Dimensionen der Moderne, Frankfurt a. M. 2008, 331–346.
- Mühlhausen, Walter, Im Visier der Fotografen – Reichspräsident Friedrich Ebert im Bild, Heidelberg 2009.
- Mühlhausen, Walter (ed.), Erinnern und Gedenken – 20 Jahre Reichspräsident-Friedrich-Ebert-Gedenkstätte, Heidelberg 2009.
- Mühlhausen, Walter, Friedrich Ebert in German Political Memory, in: Institution of Public Memory. The Legacies of German and American Politicians. Edited by Astrid M. Eckert, Washington 2007, 115–126.
- Münch, Ronald A., Von Heidelberg nach Berlin. Friedrich Ebert 1871–1905, Munich 1991.
- Peukert, Detlev J. K., Die Weimarer Republik. Krisenjahre der klassischen Moderne, Frankfurt a. M. 1987.
- Pyta, Wolfram, Die Weimarer Republik, Opladen 2004.
- Schönhoven, Klaus, Reformismus und Radikalismus. Gespaltene Arbeiterbewegung im Weimarer Sozialstaat, Munich 1989.
- Winkler, Heinrich August, Von der Revolution zur Stabilisierung. Arbeiter und Arbeiterbewegung in der Wei-

- marer Republik 1918 bis 1924, Berlin/Bonn 1984.
- Winkler, Heinrich August, Der Schein der Normalität. Arbeiter und Arbeiterbewegung in der Weimarer Republik 1924 bis 1930, Berlin/Bonn 1985.
- Winkler, Heinrich August, Weimar 1918–1933. Die Geschichte der erstendeutschen Demokratie, Munich 1992.
- Wirsching, Andreas, Die Weimarer Republik. Politik und Gesellschaft, Munich 2000.
- Witt, Peter-Christian, Friedrich Ebert. Parteiführer – Reichskanzler – Volksbeauftragter – Reichspräsident, Bonn 2004.

Fridrih Ebert (1871 - 1925), socialdemokrati dhe Presidenti i Rajhut, është një prej figurave më të rëndësishme në historinë e demokracisë gjermane. Në periudhën e revolucionit 1918-19, ai shtroi rrugën për demokracinë parlamentare, të cilën e mbroi me empati gjatë periudhës që shërbeu si president i Rajhut (1919 - 1925). Kjo biografi përshkruan ndalesat kryesore në rrugëtimin e Fridrih Ebertit prej fillesave të tij si një shalëpunues endacak e deri tek drejtimi i SPD-së, më pas në themelues të republikës së Vajmarit dhe shtetar i saj.